UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**PUNIM DIPLOME MASTER**

# TEMA: "FORMAT DHE SHKAQET E KORRUPSIONIT NË KOSOVË GJATË PERIUDHËS 2012 – 2017"


**Mentore:**

**Prof.Asoc.Dr. Besa Arifi**

**Kandidatja:**

**Agnesa Beka**


**TETOVË, 2019**

# PËRMBAJTJA

## HYRJE

1. Lënda e hulumtimit.....7

2. Qëllimet e hulumtimit.....8

3. Hipotezat.....10

4. Metodologjia e hulumtimit.....11

5. Rëndësia e punimit.....13

## Kapitulli I

1. NJOHURITË E PËRGJITHSHME MBI KORRUPSIONIN

1.1. Vështrim i përgjithshëm mbi historikun e dukurisë së korrupsionit.....14

1.2. Kuptimi mbi korrupsionin.....16

1.3. Disa elemente qenësore të dukurisë kriminale të korrupsionit.....24

## Kapitulli II

2. FORMAT E PARAQITJES SË KORRUPSIONIT

2.1. Format e korrupsionit.....26

2.1.1. Korrupsioni politik.....26

2.1.2. Korrupsioni administrativ.....27

2.1.3. Korrupsioni gjyqësor.....27

a) korrupsioni aktiv.....27

b) korrupsioni pasiv.....27

3. FORMAT MË TË SHPESHTA TË KORRUPSIONIT

3.1. Mitëdhënia dhe Mitëmarrja.....28

3.2. Shantazhi.....28

3.3. Favorizimi.....28

3.4. Marrja e dhuratave.....28

4. FORMAT E KORRUPSIONIT SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

4.1. Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar.....30

4.2.Keqpërdorimi i informatës zyrtare.....31

4.3. Konflikti i interesit.....31

4.4. Përvetësimi në detyrë.....31

4.5. Mashtrimi në detyrë.....32

4.6. Përdorimi i paautorizuar i pasurisë.....32

4.7. Marrja e ryshfetit.....33

4.8. Dhënia e ryshfetit.....33

4.9. Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj.....34

4.10. Ushtrimi i ndikimit.....34

4.11. Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore.....35

4.12. Zbulimi i fshehtësisë zyrtare.....35

4.13. Falsifikimi i dokumentit zyrtar.....36

4.14. Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme.....37

4.15. Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor.....37

4.16. Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër material ose detyrimeve financiare.....37

## Kapitulli III

3. ASPEKTI KRAHASIMOR I KORRUPSIONIT NË LEGJISLACIONET E SHTETEVE TJERA

3.1. Korrupsioni në Maqedoni.....39

3.2. Korrupsioni në Shqipëri.....43

3.3. Korrupsioni në Kroaci.....46

3.4. Rregullimi i legjislacionit për Korrupsionin në Evropë.....48

## Kapitulli IV

4. KUPTIMI DHE NDIKIMI I DISA FAKTORËVE KRIMINOGJEN NË SHFAQJEN E KORRUPSIONIT

4.1. Vështrim i përgjithshëm i faktorëve kriminogjen.....52

4.2. Ndikimi i disa faktorëve kriminogjen në paraqitjen e korrupsionit.....52

a) Kushtet e vështira të banimit.....53

b) Lufta dhe rrethanat e luftës.....54

c) Krizat ekonomike.....55

d) Migrimi i njerëzve.....56

e) Tranzicioni i shoqërisë.....57

f) Mjetet e komunikimit publik – masmedia.....58

## Kapitulli V

5. EFEKTET DHE PASOJAT E KORRUPSIONIT

5.1. Efektet në ekonominë e vendit.....61

5.2. Korrupsioni në Polici.....62

5.3. Korrupsioni në Gjyqësor.....68

5.4. Korrupsioni në Prokurori.....76

## Kapitulli VI

6. PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KORRUPSIONIT NË KOSOVË

6.1.1. Legjislacioni.....84

6.1.2. Roli i Agjencisë Kundër Korrupsionit.....89

6.1.3. Niveli profesional i kuadrit udhëheqës në lëmin e sistemit juridik.....92

6.1.4. Masat sekrete dhe ato teknike për hetim dhe syrvejim.....93

6.1.5. Bashkëpunimi ndërkombëtarë.....94

PERFUNDIMI.....98

REKOMANDIMET.....101

BIBLIOGRAFIA.....104

## 1. Lënda e hulumtimit

Lëndë shqyrtimi dhe hulumtimi në punim të magjistraturës do të jetë dukuria e korrupsionit në Republikën e Kosovës, format dhe shkaqet e paraqitjes së saj në shoqërinë kosovare gjatë periudhës kohore 2012 – 2017, si dhe masat qe duhet të ndërrmiren me qëllim të parandalimit dhe luftimit të këtij lloji të kriminalitetit.

Për këtë temë punimi jam përcaktuar nga fakti se korrupsioni në përgjithësi paraqet një dukuri të rrezikshme kriminale si për shoqërinë kosovare, ashtu edhe për çdo shoqëri tjetër. Pra, sot nuk ka asnjë shtet i cili nuk është i atakuar nga dukuria e korrupsionit, dallimi qëndron vetëm në format dhe shkaqet e paraqitjes së saj. Prandaj, tema e cila është objekt hulumtimi do të trajtohet duke u bazuar në koncepte teorike dhe praktike të zbatimit të dispozitave ligjore të fushës penale, administrative dhe të faktorëve kriminogjen që ndikojnë në shfaqjen e kësaj dukurie kriminale.

Kur kemi parasysh faktin se Republika e Kosovës është duke kaluar në fazat e saja të zhvillimit të shtetësisë, ajo si e tillë është duke u ballafaquar me të madhe me dukurinë e korrupsionit, e cila thuaja është e përhapur në të gjitha poret e jetës. Prandaj, ekziston një bindje në opinionin publik kosovar dhe tek akterët e ndryshëm në sistemin e drejtësisë (gjyqtarë, prokurorë, avokatë, struktura policore, etj.) se mjaft beteja ndaj korrupsionit “kanë humbur” dhe shumë vështirë është të fitohet lufta kundër saj, si pasojë e mos përkrahjes politike në njërën anë dhe në anën tjetër se nuk janë duke u aplikuar metodat adekuate dhe efikase për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në sistemin juridik, ekonomik dhe shoqëror në Kosovë.

## 2. Qëllimet e hulumtimit

Një qeverisje e mirë varet prej shumë faktorëve, por në themel të saj qëndrojnë dy kolona mbi të cilat mbështetet demokracia e një shteti , të cila janë: Të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit.

Korrupsioni paraqet pengesë dhe frenim të zhvillimit të sistemit juridik, ekonomik, shoqëror dhe politik të në vendi. Prandaj, forcimi i shtetit dhe i mekanizmave të saja institucionale është faktor vendimtar për parandalimin dhe luftimin me sukses të korrupsionit.

Korrupsioni si vepër kriminale është e sanksionuar me dispozita të kodeve penale të të gjitha shteteve dhe si dukuri është prezente në çdo fushë të jetës, me theks të veçantë në institucionet publike dhe shtetërore, si në: Administratën publike, sistemin gjyqësor, prokurorial, arsimor, shëndetësor , ekonomik, etj. Në thelb korrupsioni në institucione shtetërore përfshin keqpërdorim të detyrës zyrtare ( mito, përvetësimi, favorizimi, dhurata, zhvatja, mashtrimi) duke i siguruar për vete dhe palën bashkëpunuese benefite dhe privilegje të caktuara. E tërë kjo zhvillohet në kufijtë e shmangies së ligjit.

Disa nga qëllimet dhe arsyet që më kanë shtyrë të merrem me trajtimin e kësaj teme janë, se:

- Kjo temë nuk është trajtuar mjaftueshëm d.m.th. jo aq sa kërkon nevoja për forcimin e mëtejmë të shtetësisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të zvogëlimit të kësaj dukurie kriminale. Prandaj, për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit është mëse e domosdoshme studimi i kësaj dukuri kriminale në mënyrë më të gjithanshme;

- Në Kosovë në bazë të gjeturave të deritanishme, rezulton se çdo ditë e më tepër është në rritje numri i veprave penale të korrupsionit, të cilat prekin struktura të rangut të ndryshëm të kryesve të veprës së korrupsionit;

- Në Republikën e Kosovës është prezent "numri i errët" dhe "numri i përhimet" në shkallë të lartë i korrupsionit;

- Përkundër masave preventive dhe represive që janë ndërmarrë në Kosovë me qëllim të parandalimit dhe luftimit të dukurisë së korrupsionit, ende është i pamjaftueshëm suksesi i arritur në këtë drejtim, etj.

Pra, mund të themi që qëllimi i këtij punimi është hulumtimi respektivisht njohja, trajtimi dhe analizimi në baza shkencore e dukurisë së korrupsionit, kompleksitetit të saj, shtrirja dhe natyra e saj, pasojat dhe shkaqet që ndikojnë në manifestimin e korrupsionit në shoqërinë kosovare dhe në disa vende të regjionit, reformat dhe masat në fushën e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar qe duhet të ndërmerren për parandalimin dhe luftimin e saj.

Pra, mund të themi se qëllimi i këtij hulumtimi do të jetë trajtimi dhe analizimi në baza shkencore e dukurisë së korrupsionit si dhe propozimi i masave adekuate preventive dhe represive me qëllim të parandalimit dhe luftimit të këtij lloji të kriminalitetit.

## 3. Hipotezat

Më qëllim të studimi sa më përmbajtësor dhe analizimit të dukurisë së veprës penale të korrupsionit në Kosovë, kam ngritur këto hipoteza:

**Hipoteza e parë**

Në Republikën e Kosovës ekziston infrastrukturë ligjore e mjaftueshme e cila rregullon veprën penale të korrupsionit, por kërkohet zbatim konsekuent i legjislacionit në fuqi.

**Hipoteza e dytë**

Kontrolli i pamjaftueshëm institucional. Konsiderohet se një nga shkaqet e manifestimit të përmasave kaq të mëdha të dukurisë së korrupsionit në Kosovë janë pikërisht mekanizmat joefikas të kontrollit institucional.

**Hipoteza e tretë**

Mosfunksionimi i duhur dhe efikas i sistemit gjyqësor. Kolapsi gjyqësor, mungesa e stafit gjyqësorë, lëndët e grumbulluara, parashkrimi i lëndëve, proceset gjyqësore të tej zgjatura, mungesa e efikasitetit gjyqësor etj., janë disa nga shkaqet që dukuria e korrupsioni në Kosovë është evidente në shumë segmente të jetës.

Me qëllim të arritjes së rezultateve të dëshirueshme studimore, gjatë trajtimit të kësaj teme do të shtrohen këto pyetje kërkimore:

- Cilat janë faktorët të cilat ndikojnë në paraqitjen e veprës penale të korrupsionit ?

- Cilat janë format e korrupsionit në Kosovë ?

- Cilat janë motivet kryesore të kryesve të veprës penale të korrupsionit ?

- Cilat janë pasojat e korrupsionit në shoqërinë tonë ?

- Çfarë ndikimi ka korrupsioni në institucionet publike dhe private gjatë prokurimit publik ?

- Sa është i zbatueshëm në praktikë legjislacioni penal i cili rregullon veprën penale të korrupsionit?

- Në çfarë mase është e përshkallëzuar fenomeni i korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës?

- Cilat janë masat për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit?, etj.

**4. Metodologjia e hulumtimit**

Për realizimin e këtij punimi gjatë hulumtimit kam aplikuar metoda bashkëkohore që zbatohen në shkencat shoqërore. Metodologjia e tillë gjatë hulumtimit të punimit përmban metoda teknike relevante kërkimore hulumtuese. Në hulumtim kam shfrytëzuar literaturë përkatëse bashkëkohore studimore si: libra universitar, revista shkencore, punime profesionale – shkencore, shënimet nga evidencat e institucioneve administrative, gjyqësore, prokuroriale, etj. Po ashtu kam shfrytëzuar edhe burimet e hapura siç janë web - faqet e ndryshme të internetit dhe analiza e raporteve vjetore të institucioneve të ndryshme qeveritare dhe jo qeveritare në Kosovë. Vetë natyra e temës e cila është objekt studimi kërkon që të zbatohen edhe metoda të caktuara shkencore.

Metodat të cilat janë përdorur janë:

METODA HISTORIKE - gjatë hulumtimit shkencor të një fenomeni rëndësi të posaçme i kemi kushtuar metodës historike nëpërmjet së cilës kam shqyrtuar ekzistencën dhe evoluimin e

korrupsionit në aspektin historik, format dhe mënyrat e paraqitjes në periudha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë.

METODA E ANALIZËS JURIDIKE - me anë të kësaj metode kam tentuar që të arrij evidentimin nga aspekti juridik i veprës penale - korrupsionit. Përmes kësaj metode kam paraqitur: definicionin e veprave penale të kësaj kategorie, karakteristikat, pasojat dhe segmente tjera që e karakterizojnë këtë vepër penale.

METODA E ANALIZËS TEORIKE - gjatë hulumtimit kërkimor kam përdorur metoda të analizave teorike të korrupsionit si vepër penale, duke konsultuar literaturën përkatëse.

METODA KOMPARATIVE - kjo metodë është aplikuar për të hulumtuar në aspektin e krahasimit të pranisë së korrupsionit si dukuri kriminale dhe legjislacionit që rregullon çështjen e kategorisë së veprave penale të korrupsionit të vendit tonë dhe të disa vendeve të tjera të regjionit.

METODA STATISTIKORE – me anë të kësaj metode kam grumbulluar të dhëna statistikore të evidentuara, si të dhëna zyrtare për veprat penale të kryera me korrupsion, llojet e tyre, etj. Këto shënime i kam hulumtuar në regjistrat zyrtarë të Policisë, Prokurorisë, Gjykatës, Agjencinë Anti-Korrupsion, etj.

Duke pasur parasysh faktin se dukurinë e korrupsionit e kam hulumtuar po ashtu edhe nga aspekti kriminologjik, disa nga metodat që kam aplikuar me rastin e punimit të kësaj teme kanë qenë edhe metodat të cilat përdoren në shkencat kriminologjike, si: Metoda e vrojtimit – observimit indirekt, metoda e studimit të rasteve individuale, etj.

Përmes metodave të lartcekura jam munduar që ta njoh, trajtoj dhe analizoj në baza shkencore dukurinë e korrupsionit si dhe të propozoj masat adekuate preventive dhe represive me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie kriminale, e cila është e përhapur mjaftë shumë në shumicën e shteteve, e në veçantitë shteteve që janë në fazën e tranzicionit.

**5. Rëndësia e punimit**

Korrupsioni si dukuri e shoqërisë bashkëkohore, është përhapur me një ritëm të shpejtë edhe në shoqërinë kosovare. Prandaj studimi i saj nga këndvështrimi kriminologjik dhe i së drejtës penale padyshim që ka rëndësi të posaçme teorike dhe pragmatike. Prandaj studimi dhe hulumtimi i dukurive të korrupsionit në Kosovë ka rëndësi të veçantë për faktin se kjo formë e kriminalitetit është në rritje e sipër. Ky lloj i kriminalitet është duke u shprehur në forma të ndryshme si: mito, përvetësimi, favorizimi, mashtrimi, tjetërsimi, etj. Njëherit korrupsioni si dukuri ka prekur të gjitha shtresat e shoqërisë, por ajo që është shqetësuese është niveli i lartë i korrupsionit në institucionet publike - shtetërore. Prandaj, format e ndryshme të parandalimit dhe luftimit të saj janë prioritet i shtetit të Kosovës.

Parandalimi i korrupsionit kërkon ndërmarrjen e reformave institucionale me qëllim të reduktimit të hapësirave për korrupsion ndërmjet ndarjes dhe balancimit të pushtetit vendimmarrës dhe përgjegjësive të zyrtarëve në institucionet shtetërore - publike.

## KAPITULLI I

# 1. NJOHURITË E PËRGJITHSHME MBI KORRUPSIONIN

## 1.1 Vështrim i përgjithshëm mbi historikun e dukurisë së korrupsionit

Dukuritë në shoqëri lindin, zhvillohen dhe shuhen si pasoj rrethanave të caktuara historike, ekonomike dhe politike. Manifestimi i korrupsionit si fenomen shoqërorë dhe luftimi i saj është nje nga sfidat kryesore të shteteve demokratike, prandaj themi se prezenca e korrupsionit paraqet një ndër format më të rënda të kriminalitetit në përgjithësim e në vecanti atij ekonomik, si në domenin nacional ashtu dhe në atë ndërkombëtarë.

Korrupsioni si fenomen jo vetëm që rrënon bazën ekonomike të një vendi por ajo cenon bazën e sistemit juridik të tij, legjislacionin, gjyqësinë, institucionet publike-private, kulturore, shëndetësore, politikat sociale të shoqërisë e tjera. Për të njohur dhe studiuar fenomenin e korrupsionit padyshim që duhet të ndalemi dhe tek ecuria historike e zhvillimit të korrupsionit në shoqërinë njerëzore.

Është e njohur fakti se në shtetin e Athinës dukuria e korrupsioni ka qen prezentë dhe athinasit e vjetër kanë sjell rregulla për parandalimin e tyre. Edhe Romakët e vjetër kishin sjell ligjet Lex Silia[1], Lex Calpurnia, Lex Acilia dhe Lex Tullia[2], me anë të cilave sanksiononin keqpërdorimet nga ana e nëpunëseve shtetëror. Këto rregulla më vonë do të bëhen pjesë e Kodit të Justinianit. Kodifikimi i rregullave me të cilat sanksionohej korrupsioni në perandorin romake tregon seriozitetin në parandalimin e kësaj dukurie në atë periudhë. Korrupsionin si

[1]Lex Silia është sjell rreth 250 vitep.e.s., Lex Calpurnia në vitin 200 p.e.s. dhe janë sjellur kundër keqëpërdorimeve të magistrate dhe perfitimeve të paligjshme të pasurisë.

[2]Lex Tullia i sjelluar nga Ciceroni në vitin 50 p.e.s. me qëllim të parandalimit të korrupsionit. Për më tepër shih: Machiiavelli, N.,Rasprava o prvoj dekadi Tita Livija, Izabrano djelo, knj. I, Globus, Zagreb, str.184 (komentari)

fenomen e hasim edhe në Kodin e Hammurabit, në të cilën gjenden masa ndëshkimore kundër nëpunësve të korruptuar, e në veçanti sanksiononte korrupsionin në organin gjyqësor.

Në periudhën e mesjetës në shumë vende të Evropës si Franca, Anglia, Spanje, fenomeni i korrupsionit mori përmasa të mëdha, sidomos në periudhën e inkuizicionit ku pushteti klerik vendoste për jetën apo vdekjen e njeriut. Për manifestimin e korrupsionit në këtë periudhë flet edhe filozofi francez Sharl Monteskje i cili thotë se çdo pushtet është i prirë për keqpërdorime dhe mbrojta e tillë duhet të bëhet nga pushteti tjetër.[3]Kështu për herë të parë në Kodin e Napolonit të vitit 1810 u sanksionua dhënia e mitos për nëpunësit shtetëror si vepër inkriminuese.

Fenomenit të korrupsionit nuk i shpëtoi as Anglia, këto dolën në pah sidomos në fillim të shekullit XVIII me rastin e shitjes së vendeve parlamentare në Parlamentin e Anglisë me rastin e Aktit të Reformës, në vitin 1832. Kjo aferë ishte arsye që shumë teoricienët të së drejtës të shtrojnë çështjen e korrupsionit si një fenomen i cili duhet të trajtohet me kujdes të veçanet. Kështu juristi dhe filozofi anglez Fransis Bejkon korrupsionin e identifikonte me keqpërdorim të pushtetarëve dhe mitmarrje. Në fillim shekullit XIX, korrupsioni si një dukuri shoqërore e cila do të përfshij strukturat e larta politike e gjejmë edhe në SHBA. Kështu sipas politologut amerikan Tomas Xheferson korrupsioni duhet të parandalohet me kohë, pasi që natyra e njerëzve është e njëjtë në të dyja anët e Antlantikut ku ndikojnë faktorët e njëjtë, [4] Gjurmët e korrupsionit i hasim edhe në vendet skandinave në nivele dhe forma të ndryshme.

Pra, korrupsioni si ryshfet është i pranishëm gjatë tërë historisë të shtetit dhe shoqërisë. Gjithnjë është konsideruar si dukuri e pahijshme dhe e dëmshme shoqërore. Korrupsioni, sipas rregullit, posaçërisht është shprehur në periudha krize të shoqërive të caktuara, por edhe krahas me forcimin e shtetit, zhvillimin e aktiviteteve afariste, përzierjen e shtetit në ekonomi dhe me burokratizimin e shoqërisë. Korrupsioni është bërë njëri nga problemet më të rëndësishëm të shteteve të organizuara, sepse përkundër përpjekjeve të rëndësishme ligjore dhe aksioneve të rëndomta apo të kohëpaskohshme antikorrupsion, është bërë më i përhapur

[3]Monteskje, Sh., O duhu zakona, Beograd, 1989, fq. 175.
[4]Teofilovic, N., & Jelaciq, M., Sprecavanje, otkrivanje I dokazivanje krivicnih dela, korrupcije i pranje novca, Beograd, 2006, fq.8

dhe më i përforcuar. Kjo donë të thotë që korrupsioni gati nuk mund të çrrënjoset. Për këtë, në kohën e fundit, karshi kriminalitetit, është karakterizuar si një nga dukuritë më negative shoqërore. Duke i pasur parasysh vetitë e kryesve të veprave penale të marrjes dhe dhënies së ryshfetit, ndërlikueshmërinë e situatave juridiko-penale, format e ndryshme të kryerjes dhe të fshehjes të këtyre krimeve, në zbulimin e tyre paraqiten shumë pengesa dhe vështirësi. Informimi i përgjithshëm për këtë lloj të veprimtarisë kriminale është tejet i rëndësishëm për zbulimin e këtyre veprave penale. Informacionet dhe njohuritë për këto vepra penale sigurohen në mënyra të ndryshme.

Ndonjë herë këto mund të sigurohen në bazë të manifestimeve të jashtme dhe mënyrës së jetesës të personave të caktuar (shpenzimet enorme në kafene, blerja e automobilave, ndërtimi i shtëpive dhe vilave etj.).Përfoljet publike, kallëzimet e qytetarëve për kryerjen e këtyre veprave penale gjithashtu mund të jenë të dobishme në procesin e zbulimit të tyre.Madje, duke mbledhur të dhënë për vepra të tjera penale si ato të shpërdorimit të autorizimeve zyrtare, falsifikimit të dokumenteve zyrtare...mund të sigurohen të dhënat për marrjen apo dhënien e ryshfetit.[5]

### 1.2. Kuptimi mbi korrupsionin[6]

Kuptimi mbi korrupsionin daton që nga formimi i shteteve të lashta antike. Kuptimi mbi korrupsionin gjatë periudhave të ndryshme kohore ka pësuar ndryshime. Sipas Aristotelit korrupsionin e definon si devijim moral të shoqërisë. Ai ka studiuar korrupsionin e nivelit qeveritar. Sipas tij të korruptuarit kanë pushtet të pakufizuar mbi një pronë. Ai korrupsionin

[5]Latifi, V. & Beka, A., Vrasjet, Krimi i Organizuar, Terrorizmi – Zbulimi dhe të Provuarit, Prishtinë, 2013, fq. 240

[6]Sipas fjalorit të gjuhës shqipe korrupsioni i referohetsi: ryshfet, shkelligjin, vjedh, shtyj dike nëpërmjet një dhurate që të veproj kundër detyrës që ka.

politik nuk e lidh me individin por mr konceptin e përgjithshëm e cila rrjedh si pasojë e detyrës-pushtetit që ata ushtrojnë.[7]

Me korrupsion kuptohet çdo formë e keqpërdorimit të pushtetit për dobi personale ose kolektive, qoftë në sektorin publik apo privat. Korrupsioni ekziston nëse me qëllim shkelet parimi i paanshmërisë me rastin e vendimit më qëllim të përvetësimit të ndonjë të mire (favorit). Përvetësimi i favoreve, respektivisht fitimi i dobive personale për atë që merr vendimet e njëanshme, mund të ketë forma të ndryshme. E zakonshme është që me korrupsion të kuptohet përvetësimi i parave (kjo formë e korrupsionit më së shpeshti emërtohet si ryshfet), ndonëse dobia personale mund të nënkupton edhe dhuratat e shtrenjta ose bërja e ndonjë kundërshërbimi (kundërfavori).

Në Romën e vjetër nocioni korrupsion ishte sinonim i së keqes, ndikim i së keqes, keqpërdorimi i pushtetit. Ky koncept me kohë u plotësua me terminologjinë dhënie e mitos. Ata e njihnin konceptin e korrupsionit, duke sanksionuar format korruptive të pasurimit të nëpunësve të saj, me anë të Kodit të Justinianit. Ndërsa sipas Makijavelit koncepti "korrupsion" nënkupton devijim i cilësisë së pushtetit-humbja e cilësisë së pushtetit. Shtetet e zhvilluara si Angli, Franca për herë të parë filluan të përdorin konceptin e korrupsionit në fillim të shekullit të XVIII. Në Francë për herë të parë në Evropë kemi sanksionin e keqpërdorimit të detyrës nga nëpunësit shtetëror dhe mitos me Kod Penal, ndërsa në Angli nocioni për korrupsion nënkuptohej "prishje e pushtetit" dhe mito.

Tani me korrupsion nënkuptohet keqpërdorimi i pozitës shtetërore-publike dhe ndikimit për përfitime personale.Korrupsioni si fenomen është i përhapur në tërë shoqërinë njerëzore, i cili prek të gjitha kategoritë e shoqërisë, në nivele dhe forma të ndryshme. Korrupsioni është dukuri shumë evidente në sistemet në të cilat institucionet e pushtetit dhe pushtetarët e vënë në rend të parë interesin personal para interesit të përgjithshëm. Duke marrë për bazë këtë qasje, mundemi të konkludojmë se kjo formë e kriminalitetit është një dukuri e cila është në kundërshtim të plote me kodin moral dhe si e tillë ajo është shumë e dëmshme për vetë shoqërinë dhe shtetin i cili është i atakuar nga kjo formë e kriminalitetit.

[7]Aristotel, Politika, Kultura, Beograd,1960, fq.127

Korrupsioni si dukuri shoqërore negative dhe e rrezikshme, paraqet një dukuri shoqërore që manifestohet në forma të ndryshme gjatë rrjedhës se historisë njerëzore.[8] Ai vështrohet si një kërcenim i hapur për shoqërinë, ekonominë, administratën dhe rregullimin e një vendi me më shume se një mijë vjet .[9]Në kuptimin e përgjithshëm dhe të gjerë të fjalës, korrupsioni mund të përkufizohet si keqpërdorim i pushtetit/përgjegjësive të dhëna në sektorin publik dhe privat për përfitim personal.[10] Pra në realitet korrupsioni shkon përtej pagesës ose marrjes së një ryshfeti i cili përbën vetëm të një pjesë të fenomenit  të korrupsionit.[11] Kjo dukuri nënkupton diçka shumë më të madhe se bashkëpunimi sekret i personave zyrtarë me njerëzit e botës së biznesit, si mënyrë e realizimit të përfitimeve të paligjshme dhe amorale.[12]

Kur është fjala për korrupsionin, deri më tani nuk kemi unifikim të një konceptit si në rrafshin nacional ashtu dhe në atë ndërkombëtar. Në varësi të këndvështrimi kriminologjik apo kriminalistik të faktorëve që kanë sjell korrupsionin dhe format e luftimit të saj, shtetet e ndryshme kanë konceptet e tyre në lidhje me korrupsionin. Fjala korrupsion rrjedh nga fjala latine “corrumpere” që nënkupton: prish, shkatërroj, dëmtoj,  jap apo marr ryshfet, e që thelb nënkupton pjesëmarrjen e një veprimi të dy ose më shumë peronave.

Në kuptimin më të përgjithshëm, korrupsioni paraqet shpërdorim i pushtetit nga ana e nëpunësit shtetëror, për përvetësimin e paligjshëm të pasurisë për vete apo personin(fizik apo juridik) tjetër.  Shumica e autorëve korrupsionin e cilësojnë si keqpërdorim të kompetencave publike, pushtetit politik dhe ekonomik, për të përvetësuar në mënyre ilegale përfitime materiale ose jo materiale, si për vete ashtu dhe për personin tjetër.[13]

[8] Sahiti,E., Kriminaliteti si dukuri shoqërore negative dhe provimi (argumentimi) procedural i tij, Revista “E Drejta” nr.1,Prishtinë ,1995,,fq.13
[9] Vukoviq, S., Korrupcija i Vladavina Prava, Beograd. 2003 fq.9
[10]Gashi,R., Krimi i Jakës së Bardhë, Prishtinë, 2012, fq.58
[11]Banciu, D., Sociologie juridical, Bukurest, 2007, fq.244
[12]Beka, A., Krimi i Organizuar në Urbanizëm dhe Qarkullim të Pasurive të Paluajtshme, Prishtinë, 2015, fq. 161
[13] N. Teofilovic, M. Jelacic, vep.e cit. fq. 10

Disa autorë gjatë studimit të fenomenit të korrupsionit kanë dhënë mendimet e tyre, kështu Kouplend e definon si përdorim i shpërdorim të kompetencave publike për përfitime personale, këto munden të manifestohen në formë të hollash apo privilegjesh.[14]

Sipas autorit Gjonca, korrupsioni në mënyrë të veçantë përbën një kërcënim madhor për demokracitë. Shekulli i XX e ka trajtuar shpesh korrupsionin si një "krim të bardhë"[15]

Në lidhje me definicionin në kuptim të ngushtë apo të gjerë të korrupsionit, shtetet anëtare të Bashkësisë Evropiane kanë përvetësuar koncepte të ndryshme. Kështu Zvicra, Holanda, Danimarka, Italia, Britania e Madhe ka përvetësuar konceptin e gjerë të korrupsionit-korrupsionin pasiv, sipas së cilës si akter përfshin funksionarë publik, gjyqtar, anëtar të parlamentit, personalitete publike, pjesëtar të forcave të armatosura, funksionar të bankës qendrore dhe këshilltar ekonomik. Ndërsa grupi i tjetër i shteteve si Finlanda, Portugalia përkrahin idenë e definicionit në kuptim të ngushtë ku si akter pasiv të korrupsionit munden me qenë vetëm disa kategori të funksioneve publik. Në mos unifikim e definicionit mbi korrupsionin pa dyshim kontribuon edhe fakti se shumë shtete anëtare të Bashkësisë Evropiane në kodet e tyre penale nuk e kanë të sanksionuar veprën penale të korrupsionit të kryer nga zyrtarët e lart publik ndërkombëtarë. Ndërsa disa shtete si Italia, Belgjika, Franca nuk sanksionon korrupsionin në sektorin privat.[16] Të gjitha këto divergjenca kanë ndikuar që sot e kësaj dite të mos kemi një unifikim të konceptit mbi korrupsionin.

Këshilli i Evropës, në raportin e paraqitur në mbledhjen e vitit 1994, ka caktuar të ashtuquajturin definicion pune për korrupsionin."Keqpërdorimi i pozitës publike, shoqërore ose ekonomike, gjegjësisht shfrytëzimi i ndikimit real apo të supozuar në bazë të kësaj pozite me qëllim që në mënyrë të kundërligjshme, për vete ose për dikë tjetër të sigurohet ndonjë fitim material apo ndonjë përparësi politike ose ekonomike.[17]

Konventa e Kombeve të Bashkuara e luftës kundër korrupsionit e vitit 1996 ka përkufizuar në nenin 15 se çka është korrupsioni: "premtimi, ofrimi ose dhënia direkte apo indirekte, e dobisë

[14]Po aty.
[15]Gjonca, L., Korrupsioni (Veprat penale perberese, krimi i organizuar), Tirane, 2004, fq.228,229.
[16]Gjonca, L., vep.e cit. faqe 12
[17]Krasniqi, A.,Korrupsioni, Format e Shprehjes dhe Parandalimit, Prishtinë, fq. 19

së paarsyeshme funksionarit publik ose ndonjë personi apo entiteti tjetër, në mënyrë që ky funksionar të veprojë ose të përmbahen nga veprimi gjatë kryerjes së detyrës së tij zyrtare."[18] Kriminaliteti i organizuar shërbehet më së shpeshti me korrupsion ,i cili është bartës i krijimit dhe mbajtjes së lidhjeve me organet e pushtetit , organet shtetërore dhe organet tjera me ndikim, subjektet ekonomike dhe financiare,si edhe me larjen e parave, si formë e fshehjes së veprimeve kriminale.[19] Përkufizimi më shumë i njohur për korrupsionin është ai qe e jep Banka Botërore: "Korrupsioni është përdorimi i paligjshëm i burimeve publike për përfitim personal"[20]. Gjatë viteve të fundit, në forumet ndërkombëtare dhe akademike janë zhvilluar një numër i konsiderueshëmi i debateve për definimin e korrupsionit, ndër ta, edhe Grupi Multidiciplinor për Korrupsion i Këshillit të Evropës, i cili ka themeluar definicionin e përkohshëm për korrupsionin. Korrupsioni sipas GMC[21]-së, të Këshillit të Evropës është: "Mitoja dhe çfarëdo sjellje tjetër në lidhje me persona të cilëve u janë besuar përgjegjësi në sektorin publik apo privat i cili shkel detyrat të cilat rrjedhin nga statusi i tij si zyrtarë publikë, punëtor privatë, agjent të pavarur apo marrëdhënie tjera të tilla dhe kanë për qëllim që të marrin çfarëdo përparësie të paligjshme për veten apo të tjerët".[22]

Sipas Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) e gjejmë këtë përkufizim për korrupsionin: "Premtimi, ofrimi ose dhënia, direkt apo indirekt e dobisë së paarsyeshme zyrtarit publik ose ndonjë personi apo entiteti tjetër në mënyrë që ky funksionar të veprojë ose të përmbahet nga veprimi gjatë kryerjes së detyrës së tij zyrtare" ose "kërkimi ose pranimi, direkt ose indirekt i dobisë së paarsyeshme nga funksionari publik ose nga ndonjë person i etnitetit tjetër në mënyrë që ky funksionar të veprojë ose të përmbahet nga veprimi gjatë kryerjes së detyrës së tij zyrtare".[23]

[18]Konventa e Kombeve të Bashkuara e Luftës Kundër Korrupsionit ,neni 15.
[19]Succeska, M., Bazat e kriminalitetit ekonomik , Prishtinë, 2006, fq. 39
[20]Roli i Bankës Botërore', shtator 1997 Banka Ndërkombëtare e Rindërtimit dhe Zhvillimit/Banka Botërore, "Të Ndihmojmë vendet ta luftojnë korrupsionin", fq. 19.
[21]GMC – KE d.m.th.Grupi Multidiciplinor për Korrupsion i Këshillit të Evropës
[22]Bazuar në Raportin e Ministrisë së Drejtësisë të Italisë,në Konferencën e 19 të Ministrive të Drejtësisë Evropiane (të organizuar nga Këshilli I Evropës në Valletta, të Maltas, nga 14 deri 15 qershor 1994), poashtu ky material ne Dispozicion edhe ne: Criminal Laë Convention on Corruption The Treaty of Lisbon amending the Treaty on European Union and the Treaty establishing the European Community entered into force on 1 December 2009.
[23]Konventa e Kombeve të Bashkuara – Lufta kundër Korrupsionit, neni 15

Ekspertët e INTERPOLIT, korrupsionin e definojnë si çdo veprim apo mosveprim nga individë ose organizata publike ose private, duke shkelur ligjin ose besimin për përfitim ose fitim.[24]

Kodi Penal i Kosovës në nenin 315 dhe 316 ka inkriminuar marrjen dhe dhënien e ryshfetit si vepër penale me qëllim të parandalimit të kësaj forme të kriminalitetit, veçmas Kodi i Ri Penal në kapitullin XXXIV në nenet 428 deri te neni 432 ka inkriminuar veprimet korruptuese të zyrtarëve që e keqpërdorin pozitën dhe autoritetin zyrtar.[25]Ligji për Agjencinë kundër Korrupsionit[26] nr.03-L-159 në nenin 2 jep përkufizimin se me korrupsion kuptojmë çdo keqpërdorim të pushtetit apo çdo sjellje tjetër e personit zyrtar, personit përgjegjës apo personit tjetër me qëllim të arritjes së ndonjë përparësie apo përfitimi të kundërligjshëm për veten apo për personin tjetër.[27]Ky definicion është i bazuar edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër kriminalitetit të organizuar transnacional e Palermos, e nënshkruar në vitin 2000.

Sipas Ligjit kundër Korrupsionit Nr. 2004/34, me korrupsion nënkuptojmë çdo shkelje të detyrës së personave zyrtarë ose përgjegjës në subjektet juridike dhe çdo veprimtari e iniciatorëve apo përfituesve të kësaj sjelljeje, e drejtuar si përgjigje ndaj një shpërblimi që drejtpërdrejt ose indirekt është premtuar, ofruar, dhënë, kërkuar, pranuar apo është pritur për t'u marrë për veten apo për një person tjetër.[28]

Janë publikuar edhe mendimet sipas të cilëve korrupsioni përkufizohet si humbje apo transferim të mirëqenies publike. Nuk ka forma të rëndomta të korrupsionit dhe që konstatohen lehtë. Atë e hasim në forma të ndryshme, të shumta dhe të ndërlikuara.[29]

---

[24]www.interpol.int/public/corruption/igec/default.asp.

[25]Halili, R., Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq. 202

[26]Me Ligjin nr. 2004/34, në korrik të vitit 2006, u themelua në Kosovë[26] Agjencia Kundër Korrupsionit, e cila filloi nga puna në shkurt të vitit 2007. Duke e ditur arsyen parësore të themelimit të kësaj agjencie dhe po të analizohen raportet e saj, mund të konstatojmë se kjo agjenci nuk ia doli ta kryejë detyrën për të cilën u themelua. Po t'i analizojmë raportet e punës të kësaj agjencie për vitet 2008 dhe 2009, shihet se ato janë vetëm përshkruese dhe në bazë të të dhënave statistikore të paraqitura në raportin e vitit 2009, del se prej 38 informatave të procesuara në prokuroritë publike kompetente që kanë të bëjnë me rastet e korrupsionit, të parashikuara në nenin 339 të KP-së, për *shpërdorim të detyrës zyrtare dhe të kompetencave* - nuk është dënuar asnjë person.

[27]Ligji i Agjencisë kundër Korrupsionit i Kosovës, nr.03-L-159 neni 2, p. 1.1.3

[28]Ligji kundërKorrupsionit I Kosovës, Nr. 2004/34, neni 2

[29] Latifi, V., vepra e cituar, f. 1-3.

Konventa për luftë kundër korrupsionit e Kombeve të Bashkuara, e vitit 1996, në nenin 15 korrupsionin e përkufizon si: "premtim, ofrim ose dhënie të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë pasurore të paligjshme personave zyrtarë apo personave të tjerë, me qëllim që i njëjti të veprojë apo të abstenojë nga veprimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare të tij.[30] Poashtu, Banka Botërore e përkufizon korrupsionin si përdorim të paligjshëm të burimeve publike për përfitim personal.[31]

Pra, në korrupsion gërshetohen e drejta me moralin, qeverisja me burokracinë, lufta për ekzistencë me veprimtarinë kriminale, me qëllim pasurimi, sistemet e ndryshme politiko-shoqërore, diktaturat me demokracinë, dëshirat e popujve për rend demokratik dhe drejtësi humane me organizatat kriminale, krimin e shkeljen e ligjit, kërkesa për një jetesë më të mirë e qeverive dhe qeveritarëve.[32] Në përgjithësi mund të thuhet se korrupsioni ka tendencë të lulëzojë kur institucionet janë të dobëta dhe politikat ekonomike shtrembërojnë tregun në vend që ta forcojnë atë.[33] Në shoqërinë Kosovare, si koncept, korrupsionin e gjejmë si një informacion dhe shprehje me kuptim të fjalës: shkatërrim, shkaktimi i dëmit, falsifikim, dhënie dhe marrje e ryshfetit, korruptim, pjesëmarrje të pa ndershme etj.

Korrupsioni është një kërcënim serioz për të gjitha regjimet politike.Në mënyrë të veçantë, ai përbën një kërcënim madhor për demokracitë. Fenomeni i korrupsionit, po nuk u luftua në kohë, mund të kthehet, duke mposhtur shtetin, në "sistem korruptiv".

Mund të thuhet se rrjetet korruptive përbëhen nga struktura kriminale të kamufluara në administratën publike, organet shtetërore dhe institucionet e ndryshme publike. Mjerisht, shumë fakte imponojnë mendimin se shteti, duke e toleruar dhe mosluftuar korrupsionin, bëhet sistem korruptiv dhe këtë lloj krimi, jo vetëm që e "legalizon" por edhe e mbron me mekanizmat e pushtetit të krijuara dhe të parapara për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Nëse korrupsioni për një kohë të gjatë ka qenë kuptuar si një konstante e regjimeve parademokratike dhe autoritare, në vendet demokratike ai ka qenë trajtuar si një

[30] Konventa e Kombeve të Bashkuara për luftë kundër korrupsionit, 1996, neni 15
[31] "Korrupsioni" – Vështrim i Bankës Botërore dhe i Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike, botim i Bankës Botërore, Tiranë, 1998
[32] Gjonça, L., Korrupsioni, Tirane, 2004, fq.9
[33] Ndrejaj, Gjon, Mashtrimi, Korrupsioni dhe Auditimi, me parathënie nga Av, Alfred Duka, Tiranë, 2014, fq. 21

fenomen i dorës së dytë, si një disfunksionim i vogël dhe i rastësishëm. Sot, dukshmëria e tij ka kaluar nga gjendja e rastësishme, në gjendjen kronike. Korrupsioni është bërë një mjet veprimi i përgjithshëm që haset qoftë në institucionet publike, qoftë në ato private, si dhe në ndërveprimet e tyre. Trajtimet e korrupsionit në konferenca dhe simpoziume ndërkombëtare, rregullimi i tij në legjislacione penale nacionale, programimi i luftës anti-korrupsion, formimi i shërbimeve dhe organeve speciale për luftimin e këtij fenomeni të krimit të organizuar, duket sikur e "mjegullon" ose vështirëson zbulimin dhe luftimin e suksesshëm të kësaj dukurie. Problemet, pra luftimit të korrupsionit mund t'i adresohen shtetit, organeve dhe institucioneve të tij që nuk mund, nuk guxon, nuk dinë ose nuk donë t'i çrrënjos faktorët dhe shkaqet e korrupsionit dhe t'i ndëshkojë dhe parandalojë kryesit e këtyre krimeve.[34]

Korrupsioni[35] është përkufizuar si shpërdorim i kompetencave të dhëna nga organet e pushtetit, për përfitime private. Mirëpo, në një kuptim më të gjerë, korrupsioni nuk paraqet abuzim të rëndomtë të pozitës zyrtare nga ana e ndonjë personi zyrtar, por i përfshin të gjithë ata të cilët e keqpërdorin pozitën e tyre, kurdo që të jetë e mundur, për të realizuar përfitime në mënyrë sa më të lehtë. Korrupsionin nuk e hasim vetëm te autoritetet politike për të realizuar përfitime personale. Kjo dukuri nënkupton diçka shumë më të madhe se bashkëpunimi sekret i personave zyrtarë me njerëzit e botës së biznesit, si mënyrë e realizimit të përfitimeve të paligjshme dhe amorale.

Krimi i organizuar kryesisht shërbehet me korrupsionin, kështu që ai bëhet mbartës i kriminalitetit dhe i funksionimit të lidhjeve me organet e pushtetit, me organet shtetërore, me organet e tjera që kanë forcë ndikuese, me subjektet ekonomike dhe financiare, si dhe me larjen e parave, si formë e mbulimit të veprimeve kriminale.[36]

---

[34]Latifi, V. & Beka, A., Vrasjet, Krimi i Organizuar, Terrorizmi – Zbulimi dhe të Provuarit, Prishtinë, 2013, fq.245.

[35]Më gjerësisht shiko: Vukoviq, S., Korupcija i vladavina prava, Beograd, 2003; Mijatoviq, B., Korupcija od regulacije do kleptokratije, u "Sistem
i korupcija", Beograd, 2000; Vukoviq, D., Percepcija korupcije, Bosna i Hercegovina, Transparency International, 2001,f.9-10; Gjonça, L. Korrupsioni – Veprat penale përbërëse – Krimi i organizuar, Tiranë, 2004

[36] Suceska, M., Bazat e krimit ekonomik, Prishtinë, 2006, f. 39; Lidhur me këtë temë shiko: Salihu, I., "Krimi ekonomik – sfidat e sigurisë kombëtare në Shqipëri, Kosovë dhe në Maqedoni përballë këtij krimi", Shkup, 2012; Kodi doganor Nr, 03/L-109 dhe i akcizave në Kosovë, Prishtinë, 2008;Ligji Nr. 04/L-030. Për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 16, Prishtinë. Ky ligj ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

Siç shihet, korrupsioni Paraqitja e dukurisë së korrupsionit determinohet nga shumë faktorë dhe rrethana të volitshme. Sipas vlerësimeve të bëra nga organizatat ndërkombëtare, konsiderohet se mungesa e një vullneti të qartë politik për ta luftuar korrupsionin si dhe shkalla e ulët e zbatimit të masave ligjore, janë arsyet kryesore të një gjendjeje të tillë. Por, ka edhe të tillë të cilët dukurinë e korrupsionit e ndërlidhin edhe me rrogat e ulëta të funksionarëve publikë, me mungesën e kontrolleve administrative të mirëfillta, me mosefikasitetin e sistemit juridik, me problemet e trashëguara nga sistemi i kaluar, me dëshirën për t'u pasuruar shpejt, etj.[37]

### 1.3. Disa elemente qenësore të dukurisë kriminale të korrupsionit

Korrupsioni është rregull që shfaqet në periudha transitore (politike, shoqërore, kulturore, ekonomike, etj.)dhe në kriza të shoqërive të caktuara, por edhe krahas me forcimin e shtetit, zhvillimin e aktiviteteve afariste, korrupsioni shfaqet edhe me përzierjen e shtetit në ekonomi dhe me burokratizimin e shoqërisë. [38]

Karakteristikë e korrupsionit është përshtatja , kamuflimi që për nga karakteri dhe faktorët shtytës, përshtatet në shoqëri, pavarësisht prej rregullimit shoqëror.[39] Korrupsioni vështrohet si një kërcënim i hapur për shoqërinë, ekonominë, administratën dhe rregullimin shoqëror.[40] Kjo vepër penale nuk kryhet vetëm për përfitime personale për vete, por përfshin edhe përfitimet për familjen, të afërmit, shokët ose persona apo organizata me të cilët janë vendosur lidhjet e biznesit apo ato politike.[41]

Disa nga elementët qenësore të cilat e përbëjnë një akt të korrupsionit janë:

[37]Gashi, R., Krimi i organizuar, Prishtinë, 2009, Ligjërata të autorizuara; Qeveria e Kosovës, Strategjia kundër korrupsionit në Kosovë, Prishtinë 2004.
[38]Më gjerësisht shiqo: Latifi, Vesel&Elezi, Ismet, &Hysi, Vasilika: "Politika e luftimit të kriminalitetit", Prishtinë, 2012.
[39]Krasniqi, A., Korrupsioni, Format e Shprehjes dhe Parandalimit", Prishtinë, fq. 23
[40]Revistë Shkencore JURIDICA 4/2015, Botim i Kolegjit Evropian Juridica, Prishtinë, 2015, fq. 99
[41]Gashi, R., Krimi i Jakës së Bardhë, Prishtinë, 2012, fq. 58

- Në një akt korrupsioni janë gjithmonë dy palë, përkatësisht pala që ofron shpërblim apo e nxitë një raport korruptiv  dhe pala që e pranon shpërblimin.
- Korrupsioni është i lidhur gjithnjë me keqpërdorimin e detyrës, pozitës ose autoritetit zyrtar, për përfitime private - personale.
- Është ose një ofertë dhe/ose pranim apo nxitje.
- Është një përpjekje për të bërë thirrje për një ofertë apo nxitje për kryerjen e një akti zyrtar kundrejt përfitimit të një shpërblimi.
- Çdo akt nëpërmjet të cilit pasuria publike – shtetërore është përvetësuar pandershmërishtë.
- Mund të jetë edhe një përpjekje për të maskuar një veprim.
- Korrupsioni gjithashtu përfshinë shkeljen e besimit.[42]

[42]Ndrejaj, Gj., "Mashtrimi, Korrupsioni dhe Auditimi", Me parathënie nga Av, Alfred Duka, Tiranë, 2014, fq. 33-34

## KAPITULLI II

## 2. FORMAT E PARAQITJES SË KORRUPSIONIT

### 2.1. Format e korrupsionit

Format e korrupsionit përcaktohen varësisht nga ajo se në cilat organe bëhet keqpërdorimi i detyrës zyrtare, si rrjedhim i kësaj mund të jetë:

- korrupsioni politik,
- korrupsioni administrative dhe
- gjyqësor.[43]

Duhet theksuar se forma më e përhapur e korrupsionit është ai në procesin e prokurorimit.[44]

**2.1.1 - Korrupsioni politik** – Korrupsioni politik është karakteristikë e vecantë e cila ka qenë prezentë edhe në periudhat më të hershme të organizimit të shoqërisë njerëzore.[45]Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë Peter Blomeyer, ka shprehur shqetësimin e tij se gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it kanë raportuar presionin e ushtruar mbi gjykatës dhe prokurorët vendorë (Kosovar) nga politikanët apo nga njerëzit e fuqishëm. Ky lloj presioni është raportuar edhe nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Zyrtarët e kësaj agjencie kanë marrë thirrje telefonike, e-mail privat, letra, madje edhe vizita në zyre gjoja për të marrë informacione në lidhje me disa raste

[43]Warren, M., Korrupsioni si përjashtim mashtrues, www.revista polis.
[44]Beka, A.,Krimi i Organizuar në Urbanizëm dhe Qarkullim të Pasurive të Paluajtshme", Prishtinë, 2005, fq. 163
[45]Gjinovci, A., Krimi Ekonomik dhe Etika nëOrganizatat Bashkohore",Prishtinë, 2016, fq. 105

nën hetime. Kjo është konsideruar nga Agjencia si presion dhe një tendencë të frikësimit ndaj zyrtarëve dhe punës së tyre dhe ka bërë thirrje që veprimet e tilla të ndalojnë.[46]

**2.1.2 - Korrupsioni administrativ** – Korrupsioni në organet e administratës përhapet dhe ka të bëjë me nëpunësit e administratës shtetërore, të cilët, për të realizuar përfitime material, personave të caktuar u lëshojnë në mënyrë të paligjshme aktvendime dhe vërtetime që ata të realizojnë ndonjë "të drejtë" të caktuar në lëmin e qarkullimit të pasurive të paluajtshme.[47]

**2.1.3 - Korrupsioni gjyqësor** – Korrupsioni në organet e gjyqësisë në lëmin e qarkullimit të pasurive të paluajtshme mund të kryhet duke i marrë dhe duke I dhënë ryshfet personit të gjykatës, në mënyrë që ai të ndërmarrë veprim juridik të caktuar për të nxjerrë ndonjë aktgjykim që ndonjë personi të caktuar ti njihet e drejta e pronësisë mbi ndonjë paluajtshmëri.[48]

Shumica e ligjeve ndëshkuese, nga aspekti juridik, i dallojnë dy lloje të sjelljeve korruptive: korrupsionin aktiv dhe korrupsionin pasiv.[49]

a) **Korrupsioni aktiv** nënkupton vepra penale që realizohet me anë të premtimit, propozimit ose dhënies së drejtpërdrejtëose tërthorazi të çdo lloj përfitimi, funksionarit publik apo privat për të kryer ose jo një veprim në kundërshtim me detyrën apo funksionin e tij.[50]
b) **Korrupsioni pasiv** nënkupton veprën penale që realizohet me anë të kërkimit , marrjes të çdo lloj përfitimi të parregullt ose pranimi i një oferte a premtimi nga funksionari publik apo privat për të kryer ose jo, një veprim në kundërshtimi më detyrën apo funksionin e tij.[51]

[46]OJQ - KIPRED, Hetimi i korrupsionitnëKosovë: (Mos) bashkëpunimi në mes të policies dhe prokurorisë, NR. 1/14, Prishtine, 2014, fq.11.
[47]Latifi, V. & Beka, A., Vrasjet, Krimi i Organizuar, Terrorizmi – Zbulimi dhe të Provuarit, Prishtinë, 2013, fq. 134

[48]Beka, A., Krimi i Organizuar nëUrbanizëm dhe Qarkullim të Pasurive tëPaluajtshme", Prishtinë, 2015, fq. 170
[49] M. Suceska, vep.cit. fq.137
[50]https://www.botasot.info/kultura/994904/ceshte-korrupsioni/
[51]https://www.botasot.info/kultura/994904/ceshte-korrupsioni/

**3. Format më të shpeshta të korrupsionit janë:**

- Mitosja apo dhënia e mitos,
- Shfrytëzimi i shantazhit, (publikimi i të dhënave të caktuara, etj), si dhe
- Tregtia me informacione sekrete, siç janë informacionet shtetërore, ekonomike e ushtarake.[52]

**3.1. Mitëdhënia dhe Mitëmarrja**: ajo përfshin dy individë, atë që premton ose ofron një aset ose përfitim tjetër dhe atë që e kërkon ose e merr atë në shkëmbim të kryerjes së ligjshme ose të paligjshme të një veprimi që është pjesë e përshkrimit të detyrës së dikujt; nuk ka rëndësi se kush e inicon aktin e korrupsionit.[53]

**3.2. Shantazhi:** përbën marrjen e përfitimeve me anë të presionit ose forces (p.sh. një individ mund të kërcënohet me armë, ndëshkime administrative ose ndjekje penale në qoftë se ai ose ajo nuk adopton sjelljen e dëshiruar). [54]

**3.3. Favorizimi:** i referohet tendencës normale njerëzore për të preferuar të njohurit, miqtë dhe familjen në krahasim me të panjohurit në shpërndarjen e burimeve dhe pozicioneve publike, pavarësisht kualifikimeve të tyre objektive. [55]

**3.4. Marrja e dhuratave** : përfshin marrjen e përfitimeve duke ushtruar detyrën, që jo domosdoshmërisht ka synimin për të shtrembëruar trajtimin e atij procesi, por që mund të lehtësojë vendosjen e marrëdhënieve joetike.[56]

[52]Gjinovci, A., Krimi Ekonomik dhe Etika në Organizatat Bashkohore, Prishtinë, 2016, fq. 98
[53]Mita është pjesë e kategorive tëmotivimit të punjonësve.Në lidhje efektet e saj, një mite është një formë shërblimi. Shih Eugen Burdus, Gheorghita Caprarescu, motivimi, në 'bazat e menaxhimit organizativ' Peditura Economica, Bukuresh, 1999, fq. 486
[54]Danilet, Cristi, "Korrupsioni dhe Antikorrupsioni në Sistemin e Drejtësisë", Tiranë, 2011, fq. 55
[55]http://www.arkivalajmeve.com/Korrupsioni-Koncepte-dhe-terminologji.137973/
[56]Gjinovci, A.,Krimi Ekonomik dhe Etika në Organizatat Bashkohore,,Prishtinë, 2016, fq. 98

## 4. Format e Korrupsionit sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Veprat penale kundër detyrës zyrtare janë të parapara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082. Para këtij Kodi Penal këto vepra penale janë sanksionuar sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, i rregulluar nga UNMIK -u. Ndërsa për herë të parë korrupsioni është sanksionuar si vepër penale në vitin 1974 me Ligjin Penal të ish Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës korrupsioni si vepër penale është e paraparë në kapitullin XXXIV: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare. Sipas kësaj kaptine është e paraparë se dukuria e keqpërdorimit të pozitës dhe autorizimeve zyrtare, me theks të posaçëm korrupsioni janë të inkriminuara që herët në fushën e së drejtës penale. Veprat penale që janë të përfshira në këtë kaptinë përbëjnë sjellje të kundërligjshme të drejtuara kundër funksionimit të rregullt të shërbimeve publike, e të cilat I kryejnë personat zyrtarë që kanë autorizime të veçanta për kryerjen e detyrës zyrtare. Veprimet e tilla kriminale atakojnë rëndë vlerat më të çmuara të shoqërisë. Nga vetë emërtimi i këtyre veprave penale nënkuptohet se si element parësor I këtyre veprave penale është cenimi I detyrës zyrtare nga ana e personave që janë zyrtarë, të cilët kundërligjshëm, duke keqpërdorur autorizimet e tyre zyrtare dhe pozitën e tyre zyrtare përfitojnë kundërligjshëm.[57]

Veprat penale kundër detyrës zyrtare klasifikohen në:

- **Vepra penale të drejta** – Këto vepra penale kryhen vetëm nga personi zyrtar cili në mënyrë të kundërligjshme ka përfituar dobi pasurore p.sh. me anë të marrjes së ryfshetit, shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit, etj.[58]

[57] Salihu, I. – Zhitija, H. – Hasani, F., Kodi Penal I Republikës së Kosovës – Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq.1203.
[58] Salihu, I., E drejta penale – Pjesa e posacme, Prishtinë, 2014, fq. 652

- **Vepra penale jo të drejta** – Këto vepra penale nuk kryhen vetëm nga personat zyrtar por edhe personat tjerë. Në rast se vepra penale kryhet nga personi zyrtar atëherë kemi të bëjmë me një formë të rëndë të veprës penale, , p.sh. privimi i kundërligjshëm i lirisë, etj.[59]

- **Vepra penale të përgjithshme** -Veprat penale të përgjithshme kundër detyrës zyrtare janë ato vepra të cilat kryhen nga cdo person zyrtar gjatë ushtrimit të cdo detyre. Vepra të tilla konsiderohen marrja e ryshfetit, keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autorizimit, etj. [60]

- **Vepra penale të posaçme** – Veprat penale të posaçme janë ato vepra të cilat i kryejnë vetëm personat e caktuar zyrtar gjatë ushtrimit të detyrave të caktuara zyrtare. Vepër penale e posaçme mund të konsiderohet lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria.[61]

### 4.1. **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**

Kjo vepër penale kryhet kur personi zyrtar ose përgjegjës në mënyrë të kundërligjshme përdor autorizimet e tij me qëllim që të përfitoj për vete apo për personin tjetër dhe po i njëjti bën keqpërdorim të detyrës zyrtare duke i shkaktuar dëm personit tjetër apo shkel seriozisht të drejtat e personit tjetër. Kjo vepër penale në krahasim me veprat tjera ka karakter subsidiar, kryhet me dashje të drejtpërdrejtë dhe dënohet me burgim nga gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.[62]

[59] Po aty, fq. 652
[60] Po aty, fq. 652
[61] Po aty, fq. 652
[62] Salihu, I. & Zhitija H.& Hasani F., Komentar - Kodi Penal I Republikës sëKosovës, Botimi 1, Prishtinë,2014, fq. 1208

4.2. **Keqpërdorimi i informatës zyrtare**

Sipas nenit 423 të Komentarit të Kodit Penal, kjo vepër penale kryhet në ato raste kur personi zyrtar me dashje keqpërdor një informatë të rëndësishme të karakterit zyrtar me qëllim përfitimi për vete apo personin tjetër. Kjo lloj vepre penale kundër detyrës zyrtare dënohet me gjobë dhe burgim prej gjashtë deri në pesë vjet. dhe kryhet me dashje. Sipas këtij neni, në rast se informata zyrtare ka pasur të bëj me ankand publik apo veprim të prokurimit atëherë kryesi do të dënohet me gjobë dhe burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet. Në rast se vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore apo humbje në vlerën që tejkalon pesëmijë (5000) euro, kryesi i veprës do të dënohet me gjobë dhe me burgim prej një 1 deri në tetë (8) vjet ndërsa në rastet kur rezulton me humbje e cila e kalon vlerën pesëdhjetë mijë (50.000) euro, kryesi do dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet. [63]

4.3. **Konflikti i Interesit**

Kjo vepër penale kryhet kur një person zyrtar duke shfrytëzuar autoritetin e tij ndikon në ndonjë çështje përmes vendimit, miratimit, rekomandimit, mosmiratimit apo përmes ndonjë mënyre tjetër e cila çështje prek interesat financiare apo personale të zyrtarit apo personit tjetër. Kryesi i kësaj vepre dënohet prej një (1) deri në tre (3) vjet. Ndërsa në rastet kur çështja është veprim I prokurimit apo ankand publik, kryesi dënohet me brugim prej një (1) deri në pesë vjet.[64]

4.4. **Përvetësimi në detyrë**

Sipas nenit 425 të Komentarit të Kodit Penal, personi zyrtar i cili me qëllim të përvetësimit të pasurisë (paratë, letrat me vlerë apo sendet tjera të luajtshme) për vete apo personin tjetër ,në

[63] Po aty, fq. 1222
[64] Po aty,,fq. 1224

mënyrë të kundërligjshme e keqpërdorë detyrën e tij zyrtare e cila i ishte besuar në punë në kuadër të organit publik. Kjo vepër penale dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muaj (6) deri në pesë (5) vjet. Sipas këtij neni në rast se vepra penale rezulton me dobi pasurore apo humbje me vlerë që tejkalon pesëmijë (5000) euro, kryeso do të dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. Ndërsa në rast se dobia pasurore nga kjo vepër penale apo humbja në vlerë kalon pesëdhjetë mijë (50.000) euro , kryesi do dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet. [65]

### 4.5. **Mashtrimi në detyrë**

Kjo vepër penale kryhet me dashje direkte nga personi zyrtar dhe personi përgjegjës, të cilët me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore kryejnë veprime të kundërligjshme duke e vënë në lajthitje personin i cili kryen një pagesë të kundërligjshme. Personi që vihet në lajthitje duhet të jetë i autorizuar që të lejojë apo kryejë pagesën. Kjo vepër penale dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon pesëmijë (5000) euro, kryesi do të dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. Ndërsa nëse vepra penale e cila rezulton me dobi pasurore ka tejkaluar vlerën prej pesëdhjetë mije (50.000) euro, kryesi do të dënohet me gjobë dhe burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet. [66]

### 4.6. **Përdorimi i paautorizuar i pasurisë**

Sipas Nenit 427 të Komentarit të Kodit Penal, këtë vepër penale e kryen kushdo që në vendin e tij të punës ka përdorur pa autorizim paratë, letrat me vlerë apo sendet tjera të luajtshme. Kjo vepër penale është kryer me dashje dhe qëllimi i kryesit ka qenë që sendet e përvetësuara të merren për një kohë të përkohshme për vete apo që dikush tjetër ti shfrytëzoj ato përkohësisht

[65] Salihu, I.& Zhitija H.& Hasani F., veper e cituar, fq.1225-1226
[66] Salihu, I.& Zhitija H.& Hasani F., veper e cituar, fq.1233-1234-1235

dhe më pas ti kthej përsëri. Kryesi mund të jetë vetëm personi në detyrë apo punë dhe po i njëjti dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.[67]

### 4.7. **Marrja e ryshfetit**

Kjo vepër penale kryhet në ato raste kur personi zyrtar në mënyrë të drejtë apo të tërthortë me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo tjetrin, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë, ofertë apo premtim dhe po i njëjti në këmbim të ryshfetit do të veprojë ose mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare dhe i cili do të dënohet me gjobë dhe burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Ndërsa në rastin tjetër kur personi zyrtar në mënyrë të drejtë apo të tërthortë me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo tjetrin, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë, ofertë apo premtim dhe po i njëjti në këmbim të ryshfetit do të veprojë apo mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare do të dënohet me gjobë dhe burgim prej prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet. Nëse vepra penale e paraparë sipas paragrafit 1 të këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro, kryesi do të dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

### 4.8. **Dhënia e ryshfetit**

Dhënie e ryshfetit konsiderohet kur një person në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i jep ndonjë dhuratë, ofertë apo premtim personit zyrtar i cili duhet të veprojë apo mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare. Kryesi i veprës penale do dënohet me gjobë ose burgim deri në tre (3) vjet. Në rastin tjetër kur një person në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i jep ndonjë dhuratë, ofertë apo premtim personit zyrtar i cili duhet të veprojë apo mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, kryesi i veprës penale do dënohet me gjobë ose burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. Nëse kryesi I veprës penale nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni e ka dhënë ryshfetin me kërkesë të personit përgjegjës apo atij zyrtar dhe e lajmëron veprën para

[67] Po aty,fq. 1237-1238

se ajo të jetë zbuluar ose para se të ketë kuptuar se vepra penale është zbuluar, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.[68]

4.9. **Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj**

Kjo vepër penale është e ngjashme nga përshkrimin ligjor të veprës penale, dhënie e ryshfetit (neni 429). Dallimi qëndron tek personi të cilit i jepet ryshfeti që në këtë rast, dhënia e dhuratës apo premtimit në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë i jepet zyrtarit publik të huaj i cili mund të veprojë apo mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dhe shkalla e dënimit te kjo vepër penale për kryerësin është më e rëndë dhe dënohet me gjobë e burgim deri në pesë (5) vjet. Ndërsa në rastet kur zyrtari publik i huaj ose personi tjetër vepron ose nuk vepron në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro, kryesi do të dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. Dhurata apo përfitimi i pranuar apo i ofruar në shkelje të këtij neni do të konfiskohet.[69]

4.10. **Ushtrimi i ndikimit** - Sipas Nenit 431 të Komentarit të Kodit Penal, këtë vepër penale e kryen kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë ofertë, dhuratë, premtim apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër në mënyrë që të ushtrojë ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personit zyrtar apo zyrtarit publik të huaj, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tetë (8) vjet. Ndërsa kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë i jep ndonjë dhuratë, premtim apo përfitim tjetër personit tjetër, në mënyrë që ky person të ushtrojë ndikim të papërshtatshëm mbi vendimmarrjen e personit zyrtar apo zyrtarit publik të huaj, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar, dënohet me

[68]Salihu, I.&Zhitija H.&Hasani F., veper e cituar, fq.1251
[69]Salihu, I.&Zhitija H.&Hasani F., veper e cituar, fq.1256

gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet. Dhurata apo përfitimi i pranuar apo i ofruar në shkelje të këtij neni konfiskohet.[70]

4.11. **Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore –** Kjo vepër penale ndodh në ato raste kur gjykatësi, gjykatësi për kundërvajtje apo edhe gjykatësi laik me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete apo personin tjetër ose për ti shkaktuar dëm, nxjerr vendim i cili është në kundërshtim me ligjin. Kjo vepër penale kryhet me dashje. Kjo vepër penale kryhet me veprim dhe me mosveprim. Me veprim kryhet duke u marrë një vendim, aktvendim, urdhëresë apo akt tjetër i kundërligjshëm, p.sh. vendosja me vetëdije e fakteve të paqena në procesverbalin e shqyrtimit kryesor të cilat do të ndikonin në marrjen e një vendimi të kundërligjshëm ndërsa me mosveprim vepra penale kryhet në rastet kur gjyqtari nuk i ka futur në procesverbal faktet e rëndësishme nga të cilat do te varej ekzistimi apo mosekzistimi I përgjegjësisë penale të të akuzuarit. Në këtë rast kemi të bëjmë me dëmin material (pagimi i një shume të caktuar të hollash për shkak të vendimit të kundërligjshëm) dhe atë jo material (cenimi i nderit apo autoritetit). Ky person dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Gjyqtarët si individë duhet të jenë të paanshëm dhe të lirë në marrjen e vendimit pa pasur asnjë presion, kërcënim, ndikime nga jashtë apo brenda pavarësisht shkakun. [71]

4.12. **Zbulimi i fshehtësisë zyrtare**

Personi zyrtar i cili pa autorizim kumton, dërgon ose në ndonjë mënyrë tjetër i vë në dispozicion personit tjetër informatën që përbën fshehtësi zyrtare ose siguron informatën e tillë me qëllim që t'ia përcjellë ndonjë personi të paautorizuar, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet për përfitim personal ose me qëllim të publikimit apo shfrytëzimit të informacionit jashtë Republikës së Kosovës, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet. Nëse vepra penale nga

[70]Po aty, fq. 1256-1257
[71]Salihu, I.&Zhitija H.&Hasani F., veper e cituar, fq. 1261-1262

paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. Dispozitat e këtij neni zbatohen ndaj personit i cili zbulon fshehtësinë zyrtare edhe pasi që të ketë pushuar statusi i tij zyrtar. Për qëllime të këtij neni, shprehja "fshehtësi zyrtare" nënkupton informatat ose dokumentet të shpallura si fshehtësi zyrtare me ligj, dispozita të tjera ose me vendim të organit kompetent të nxjerrë në bazë të ligjit dhe zbulimi i të cilave ka shkaktuar ose mund të shkaktojë pasoja të dëmshme. Sidoqoftë, informatat të cilat nuk konsiderohen fshehtësi zyrtare janë: informatat apo dokumentet të cilat janë të drejtuara në cenimin e rëndë të të drejtave themelore të njeriut ose mos zbulimi i të cilave do të mund të rrezikonte rendin kushtetues apo sigurinë e Republikës së Kosovës ose informatat dhe dokumentet të cilat kanë për qëllim fshehjen e kryesit të veprës penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim. [72]

### 4.13. **Falsifikimi i dokumentit zyrtar**

Kjo vepër penale është një lloj i falsifikimit intelektual ku kemi të bëjmë me falsifikimin e dokumenteve zyrtare ose afariste, të regjistrave a shkresave zyrtare në të cilat shënohen të dhëna të rreme ose nuk shënohen të dhënat e duhura, ku dokumenti nga aspekti material është i saktë si vula zyrtare, nënshkrimi i personit zyrtar si dhe dokumenti është përpiluar në kohën e detyrës zyrtare po kontestuese është përmbajtja e pasaktë e atij dokumenti. Ky person dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Ndërsa personi zyrtar i cili shfrytëzon dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare të rreme si të vërtetë në veprimtarinë e tij afariste ose i cili asgjëson, fsheh, dëmton apo në ndonjë mënyrë tjetër e bën të papërdorshëm dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare, dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.[73]

[72] Po aty, fq. 1263-1264.
[73] Salihu, I.&Zhitija H.&Hasani F., veper e cituar, fq.1267

### 4.14. **Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme**

Sipas nenit 435 të Komentarit të Kodit Penal,kjo vepër kryhet në ato raste kur dëmtohet pasuria e dikujt për shkak se personi zyrtar apo ai përgjegjës kanë detyruar personin që të paguaj diqka që ai nuk ka qenë i detyruar të paguajë apo në rastin tjetër të paguaj më shumë për shërbimin sesa që ka qenë i detyruar të paguajë apo kur personi përgjegjës apo ai zyrtar me rastin e arkëtimit a dorëzimit të ndonjë sendi, dorëzon më pak se që është dashur. Kjo vepër penale dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. Nëse vlera e pagesës apo dërgesës tejkalon shumën prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro, kryesi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet. Tentativa për ta kryer këtë vepër penale është e dënueshme.[74]

### 4.15. **Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor**

Kur personi zyrtar gjatë bastisjes së ndonjë lokali apo gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor, merr sendin e luajtshëm me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore duke keqpërdorur pozitën e tij zyrtare. Kjo vepër penale kryhet me dashje direkte dhe gjithashtu edhe vetë tentativa për ta kryer këtë vepër penale është e dënueshme dhe ekziston kur marrja ka filluar, mirëpo sendi nuk konsiderohet i marrë domethënë kryesi nuk ka mundur që të sigurojë pushtetin mbi sendin. Kryes i kësaj vepre mund të jetë vetëm personi zyrtar.[75]

### 4.16. **Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër material ose detyrimeve financiare**

Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.Çdo person, i cili falsifikon ose nuk

[74]Po aty, fq. 1271
[75]Salihu, I.& Zhitija H.&Hasani F., veper e cituar, fq. 1273-1274

paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Vlera e padeklaruar e pasurisë, të të ardhurave ose të dobisë tjetër pasurore, e cila është fituar në mënyrë joligjore konfiskohet. Kjo vepër penale konsumohet kur personi i cili sipas Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, nuk e deklaron fare pasurinë e tillë ose e deklaron pas afatit të skadimit të afatit ligjor për deklarim. Kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, me dijeni të kryesit.[76]

[76]Po aty, fq. 1275-1276

## KAPITULLI III

## 3. ASPEKTI KRAHASIMOR I KORRUPSIONIT NË LEGJISLACIONET E SHTETEVE TJERA

Dukuria e korrupsionit në shumicën e shteteve të regjionit por edhe tërë hapësirës evropiane është mjaft i përhapur, ky fenomen nuk ka prekur vetëm vendet e varfëra, apo vendet në tranzicion por edhe vendet të cilat cilësohen në rangun e shteteve të zhvilluara dhe me ndikim në politikën globale të zhvillimit ekonomik. Veprat penali si keqpërdorimi i detyrës zyrtare, ushtrimi I ndikimit, dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj dhënia e ryshfetit, marrja e ryshfetit, mashtrimi në detyrë, konflikti interesi, të tëra këto do të sanksionohen sipas ligjeve dhe kodeve penale në fuqi të vendit të caktuar. Secili vend ka specifikat e veta si ekonomike, sociale, kulturore, e nga ky këndvështrim edhe fenomeni i korrupsionit në shtete të ndryshme ka karakteristikat e saja të veçanta. Prandaj në këtë kapitull do të trajtohet koncepti i korrupsionit sipas të drejtës së shteteve të caktuar.

### 3.1**. Korrupsioni në Maqedoni**

Maqedonia si dhe shumica e vendeve të regjionit ka kaluar në faza të caktuara tranzicioni si në aspektin shoqëroro-ekonomik ashtu dhe legjislativ. Fenomeni i korrupsionit si problem global i shteteve, në dy dekadat e fundit nuk ka kursyer as shtetin maqedon. Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit shteti maqedon ka punuar në drejtim të sjelljes së ligjeve lidhur me korrupsionin. Ndër më të rëndësishmet janë : Kodi penal, Ligji për parandalimin e korrupsionit, Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Ligji për informatorë (viti 2017), Ligji për donacione dhe sponzorizime në veprimtaritë politike dhe ligji për lobim. Gjithashtu me qëllim të luftimit të korrupsionit, Republika e Maqedonisë ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit dhe Konventën civile për parandalimin e korrupsionit, të cilat janë pjesë e legjislacionit të brendshëm.

Kodi penal i shtetit Maqedon  është aprovuar në vitin 1996[77]. Në kapitullin e tridhjetë, në grupin e veprave penale kundër detyrës zyrtare janë të përfshira disa vepra penale të korrupsionit, por tani do të trajtohen këto, si:  Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar(neni 353); Marrja e ryshfetit (neni357); Dhënia e ryshfetit(neni 358);

Vepra penale Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar konsiston në veprën penale të kryer nga personi zyrtar i cili abuzon me pozitën dhe autorizimet e veta zyrtare për përfitime personale apo dobi për tjetrin ose tjetër kujt do ti shkaktoj dëm. Në këtë vepër veprimi i kryerjes konsiston në :a) keqpërdorimin e pozitës zyrtare; b) tejkalimi i autorizimeve të veta; c) moskryerja e detyrave zyrtare;[78]

Sipas kësaj forme të veprës penale është paraparë dënimi nga tre muaj deri në tri vjet. Kjo forme e sanksionimit tek kjo vepër penale është forma tradicionale e cila ka qen  karakteristike për legjislacionin e ish Jugosllavisë. Kjo dispozitë ligjore rregullon edhe format më të rënda të kësaj vepre penale, nëse kryesi i veprës përfiton dobi të mëdha materiale ose shkakton dëme të mëdha materiale. Në të gjitha këto raste gjykata është ajo që konstaton një gjendje të tillë. Sanksionet penale janë nga një deri në dhjetë vite.

Kjo dispozitë ligjore nuk ka pësuar plotësime dhe ndryshime për tridhjetë vite dhe në periudhën e tanishme ekzistojnë mendime se ky nen duhet të rishqyrtohet. Lidhur  me vlefshmin e nenin 353 të Kodit  Penal të Republikës së Maqedonisë në të drejtën maqedone janë hapur diskutime të shumta në nivele profesionale dhe akademike. Në Gjykatën Kushtetuese është formuluar dhe hapur çështje pas reagimeve ndaj këtij neni, i cili u tërhoq në finalizimin e ndryshimit të Kodit penal në procedurën parlamentare[79]

Marrja e ryshfetit[80] sipas Kodit të Maqedonisë është vepër penale e korrupsionit e cila manifestohet në marrjen apo pranim e dhuratës apo të ndonjë dobie tjetër nga ana e personit

[77]Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonise, nr.37/96
[78] Zejneli, I., E drejta penale, Pjesa e posacme,2007, faqe 151
[79]http://time.ikub.al/18-12-29-Gjykata-Kushtetuese-e-Maqedonise-do-te-vendos-per-nenin-353-/Gjykata-Kushtetuese-e-Maqedonise-do-te-vendos-per-nenin-353-.aspx
[80] Neni 357 Kodi Penal i Republikës së Maqedonis

zyrtar që në kuadër të autorizimeve të veta të kryej veprimin zyrtar të cilin nuk do të kishte të drejt te kryente, në kërkim apo pranim të dhuratës apo të ndonjë dobie tjetër.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në: duke kërkuar dhuratë apo profit tjetër; b) duke pranuar dhuratë apo përfitim tjetër dhe c) duke pranuar premtim për ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër.[81] Vepra e ryshfetit apo mitoja pasive paraqitet në tri forma apo trajta: mitoja e drejtpërdrejt pasive; mitoja e tërthortë pasive dhe mitoja e mëvonshme. Te kjo vepër penale e korrupsionit kryesi i veprës duhet të është person zyrtar dhe të ekzistoj elementi i fajësisë-dashja. Sipas Kodit Penal kjo vepër penale sanksionohet prej një deri në dhjetë vjet.

Dhënia e ryshfetit[82] si vepër korruptive, manifestohet në dhënien ose premtimin e dhuratës apo të ndonjë dobie tjetër personit zyrtar, i cili në kuadër të autorizimeve të tij ishte dashur të kryej apo mos të kryej një veprimin, apo ai që ka ndërmjetësuar në këtë. Kryes i veprës penale mund të jetë çdo person. Vepra e dhënies së mitos aktive paraqitet në tri forma: mito e drejtpërdrejt aktive; mito e tërthorët aktive dhe ndërmjetësimi në dhënien e mitos. Për këtë vepër penale parashihet sanksioni penal prej 6 muaj deri në 5 vite.

Për këtë vepër penale është paraparë mundësia e lirimit me kusht e kryesit të veprës penale me kusht që: dhurata të jetë dhënë me kërkesë të personit zyrtar apo personit përgjegjës dhe që dhënësi i dhuratës ka paraqitur veprën penale para se ajo të zbulohet. Nëse personi është liruar nga dënimi objektet e dhuratave ose vlera mund ti kthehen.

Kuadri ligjor i Maqedonisë përfshin një numër të caktuar ligjesh të sjella këto vite te fundit si: Ligji për parandalimin e korrupsionit, Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, Ligji për informatorë (viti 2017), Ligji për donacione dhe sponzorizime në veprimtarit politike dhe Ligji për lobim. Së fundi, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me qëllim të parandalimit të korrupsionit dhe forcimit të kornizës ligjore propozoj Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, të sillet me procedurë të përshpejtuar. Ky veprim i Qeverisë ka për

[81] Zejneli, I.,vep. e cit., faqe 153
[82] Neni 358 Kodi Penal I Republikës sëMaqedonise

qëllim të përforcohet efikasitetin dhe pavarësia e Komisionit Shtetëror për parandalimin e korrupsionit dhe të Komisionit Anti-korrupsion në luftë kundër korrupsionit.[83]

Pavarësisht këtyre ligjeve korrupsioni në Maqedoni është ende shumë i lart. Këtë e tregon edhe Raporti i fundit i korrupsionit në Maqedoni për vitin 2017 të punuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar(QMBN). Sipas analizës së QMBN-ës rezulton se krahasuar me vitin 2016 ekziston përkeqësim të gjendjes, si dhe ekziston "shpërndarje e gjerë e korrupsionit".Pas anketimit të personave në terren, të kryera në mesë të periudhës prej 27 janari deri më 7 shkurt të vitit 2018, rezultatet e hulumtimit tregonin se korrupsioni ka depërtuar në të gjitha profesionet dhe segmentet e shtetit, atij gjyqësor, ekzekutiv dhe legjislativ. Sipas sektorëve ku korrupsioni është më së shumti i shpërndarë, sipas Raportit rankohen: gjykatat, prokuroria dhe shëndetësia. Një nga konkluzionet në Raport është se "korrupsioni mbetet i pa sanksionuar në Maqedoni".[84]

Ndërsa në bazë të Raportit për Vlerësimin e korrupsionit në Maqedoni për vitin 2018 të Bashkimit Evropian, përmes Indeksit për Perceptim të korrupsionit të kryer nga International Tranparency , rezulton me rritje të korrupsionit. Sipas këtij raporti si më të korruptuar rezulton të jenë gjyqtarët dhe prokurorët publik. Korrupsioni mbete i përhapur në shumë fusha dhe kapaciteti institucional për të luftuar korrupsionin paraqet mangësi strukturore dhe operative, citohet në raportin e Komisionit Evropian në raportin e fundit për përparimin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2018.[85]

[83]https://telegrafi.com/qeveria-e-maqedonise-ligji-per-luftimin-e-korrupsionit-procedure-te-shkurtuar/, shikuar me datë 30.01. 2019

[84](http://vertetmates.mk/hulumtimi-i-qmbn-se-gjykatat-prokuroria-dhe-shendetesia-sektoret-me-te-korruptuar) shikuar me datë 30.01.2019

[85]https://portalb.mk/576683-lufta-kunder-korrupsionit-ne-maqedoni-kemi-ligje-na-nevojiten-njerez-qe-do-ti-zbatojne/

### 3.2. Korrupsioni në Shqipëri

Ndryshimet shoqërore-ekonomike në shtetin shqiptar, sollën ndryshime edhe në kuadrin ligjor të tij. Këto ndryshime rezultuan në vitin 1995 kur hyri në fuqi Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i cili në grupin e veprave penale kundër aktivitetit të organeve shtetërore të pushtetit publik neni 260 njihte korrupsionin pasiv të funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhur vendor. Sipas këtij neni veprën penale kryhet nga personi i cili kryen funksionin shtetëror, shërbime publike, i cili kërkon ose merr, drejtpërdrejt ose tërthorazi dhuratë, shpërblim apo dobi tjetër që lidhet me detyrën a funksionin e tij. Për këtë vepër është paraparë dënimi me heqje lirie prej 3 deri 10 vite.

Reformat ligjore të viteve 2001-2017 sollën teknika të reja ligjore, kështu në vitin 2004 bazuar në Konventën Penale për korrupsion të Këshillit të Evropës , me ligjin nr.9275 u bë unifikimi dispozitave ligjore me atë të Konventës, ku terminologjia marrje-dhënia e mitos u zëvendësua me korrupsion aktiv dhe pasiv. Risia e këtij ligji ishte se për herë të parë në legjislacionin shqiptar u penalizuan veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv nga personat që ushtrojnë funksione në sektorin privat, publikë, korrupsioni i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor, korrupsioni aktiv e pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve.

Tendencat e shtetit shqiptar për të qenë anëtare e Bashkësisë Evropiane dhe përafrimi me legjislacionit evropian ishin shtytësit kryesor që Kodi penal të plotësohet në lidhje me korrupsionin. Këto ndryshime penalizonin veprat penale të korrupsionit të kryera nga zyrtarë vendas dhe të huaj, funksionar të lart shtetërorë vendas apo të huaj. Kryesit e veprës penale të korrupsionit sanksionohen me heqje lire, apo dënimin me gjobë, në varësi nga natyra juridike e veprës. Sipas kodit të ri penal përgjegjësia penale shtrihej jo vetëm për personat që japin dhe marrin mito, por edhe për personat të cilët gjatë ushtrimit të funksioneve publike në mënyrë të paligjshme gjatë vendimmarrjes i siguron tjetrit të mira materiale apo jo materiale. Përgjegjësia penale shtrihet si tek personat fizik dhe juridik.

Luftimi i veprimeve korruptive sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë rregullohen me disa nga këto dispozita ligjore:[86]

- Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike.
- Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publik.
- Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor.
- Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike.
- Korrupsioni pasiv i personave  që ushtrojnë funksione publike.
- Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publik.
- Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurve vendorë.
- Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit.
- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve tjerë të drejtësisë.
- Korrupsioni aktiv i gjyqtarit dhe i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare
- Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj
- Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve tjerë të organeve të drejtësisë
- Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare
- Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj

Sipas Kodit penal vepra penale e Shpërdorimit të detyrës çdo herën është në korrelacion me veprën penale të korrupsionit pasiv. Vepra penale e shpërdorimit të detyrës goditë direkt veprimtarinë e rregullt të institucioneve, sipërmarrjeve ekonomike, organizatat joqeveritare. Krimi i shpërdorimit të detyrës kryhet me veprime aktive të kundërligjshme ose moskryerjen e veprimeve - mospërmbushjen e rregullt të detyrës. Motivet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës mund të jenë të ndryshme: miqësia, interesi, hakmarrja etj. Sipas kësaj rezulton që personi i cili ushtron funksione publike, personit tjetër përfitime materiale ose jo materiale të

[86]Për më tepër shih: Elezi, Ismet, E drejta Penale,Pjesa e posacme,Tiranë,2018

padrejta. Ky përkufizim thuajse e barazon veprën penale të shpërdorimit të detyrës me korrupsionin pasiv.[87]

Edhe pse Kodi penal rregullon gamë të gjerë të figurave të veprës penale të korrupsionit, mund të themi se Shqipëria ende ka nivel të lart të korrupsionit në të gjitha fushat e jetës. Pavarësisht sjelljes së Ligjit Antikorrupsion, nënshkrimit të shumë Konventave kundër korrupsioni, tentativave të qeveris në miratimin e planeve strategjike kudër Korrupsionit dhe formimit të Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion, Shqipëria mbetet një ndër shtetet më me nivel të lart të korrupsionit në regjion. Një gjë të tillë e konfirmon edhe Raporti i Organizatës Transparency International, mbi shkallën e korrupsionit në botë, ku Shqipëria radhitet në vendin e 99-ët, ndryshe nga një vit më parë ku ajo radhitej e 91-ta. Ky raport përfshin 180 vende të botës.[88]

Sipas shënimeve zyrtare të publikuara nga Instituti Statistikor I Shqipërisë INSTAT në Raporti statistikor te vitit 2017 rezulton se numri i veprave penale kundër korrupsionit të evidentuara nga Drejtorati i Përgjithëmi Policisë [89] janë si në tabelën nr.1

Tabela 1. Veprat penale të evidentuara sipas INSTAT.

| Veprat penale | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|---|---|---|---|---|
| Vrasje | 124 | 104 | 98 | 54 | 71 |
| Vrasje e mbetur në tentativë | 220 | 206 | 156 | 137 | 132 |
| Plagosje e lehtë me dashje | 1.375 | 1.340 | 1.463 | 1.312 | 1.122 |
| Krime seksuale | 44 | 87 | 97 | 137 | 113 |
| Vjedhje pasurie | 6.244 | 6.064 | 8.635 | 7.168 | 5.655 |
| Fallsifikime | 683 | 533 | 553 | 643 | 807 |
| Mashtrime | 465 | 563 | 546 | 393 | 569 |
| Vepra për qëllime terroriste | 10 | 22 | 39 | 12 | 13 |
| Krime kundër korrupsionit | 432 | 458 | 691 | 99 | 305 |

Burimi:INSTAT –Raporti 2017

[87]Po aty, fq. 412
[88]http://www.kohajone.com/2019/01/29/transparency-international-shuplake-qeverise-perkeqesim-ne-luften-kunder-korrupsionit-2/, shikuar me datë 2.02.2018
[89]http://www.instat.gov.al/media/3655/vjetari-statistikor-2017.pdf, faqe 15, shikuar 13.02.2019

Sipas Raportit Vjetor 2017 të INSTAT-it evidentohen të dhënat mbi autorët e dyshuar në kryerjen e një vepre penale të siguruara nga Drejtoria e përgjithshme e policisë. Tabela 2 paraqet autorët për disa vepra penale për vitet 2012-2016. Në kategorinë e këtyre veprave keni dhe të dhëna statistikore të autorëve të veprës penale të korrupsionit, të cilët nga viti 2012 – 2016 shënojnë rritje të lartë ku në fund të viti 2016 arrin numri në 1.434 persona.[90]

Tabela2. Autorët sipas veprave.

| Veprat penale | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|---|---|---|---|---|
| Vrasje | 162 | 123 | 110 | 81 | 80 |
| Vrasje e mbetur në tentativë | 272 | 244 | 196 | 190 | 164 |
| Plagosje e lehtë me dashje | 1.647 | 1.623 | 1.802 | 1.711 | 1.488 |
| Krime seksuale | 49 | 89 | 101 | 145 | 119 |
| Vjedhje pasurie | 4.591 | 3.832 | 5.423 | 5.591 | 4.537 |
| Fallsifikime | 703 | 561 | 572 | 697 | 946 |
| Mashtrime | 446 | 557 | 589 | 455 | 650 |
| Krime kundër korrupsionit | 664 | 709 | 1.141 | 1.335 | 1.434 |

Burimi: INSTAT-Raporti vjetor 2017

### 3.3. Korrupsioni në Kroaci

Kroaci si një shtete i dalë nga lufta, pavarësisht problemeve ekonomike dhe shoqërore ka arritur që brenda një kohe të shkurtër të konsolidoj sistemin ekonomik dhe juridik të saj. Qeveria Kroate brenda një kohe të shkurtër arriti të bëjë ndryshime rrënjësore edhe në fushën e legjislacionit. Kodi penal i Republikës Kroate i sjell në vitin 1997 ishte azhurnuar disa herë, Kështu në kreun XXV në grupin e veprave penale kundër detyrës zyrtare parashihet: pranimi i

[90]http://www.instat.gov.al/media/3655/vjetari-statistikor-2017.pdffaqe 20.

mitos, e cila manifestohet me kërkimin ose pranimin e mitos (dhuratës) apo të ndonjë dobie tjetër ose të pranimit të dhuratës, a të një dobie tjetër nga ana e personit zyrtar apo përgjegjës që në suaza të autorizimit të vet të kryejë veprimin zyrtar të cilën nuk do të guxonte të kryente, ose të mos e kryejë veprimin zyrtarë të cilin do të duhej ta kryente, si dhe kërkesës të pranimit të dhuratës ose të ndonjë dobie tjetër pas kryerjes, a moskryerjes së ndonjë pune zyrtare në lidhje me të.[91]Kjo vepër penale sanksionohet me heqje lirie prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Vepra tjetër penale e korrupsionit emërtohet me Dhënien e mitos e paraparë sipas nenit 348 të Kodit Penal. Vepra ka të bëjë me dhënien apo pranimit të dhuratës apo ndonjë dobie tjetër e personit zyrtarë, të kryej apo të mos kryej ndonjë veprim zyrtar brenda autorizimeve të cilat dalin nga pushteti i tij, si dhe në ndërmjetësimin gjatë mitos në cilëndo nga këto vepra apo trajta. Figura e veprës penale dhënia e mitos aktive paraqitet në tri forma: mito e drejtpërdrejt aktive; mitoja e tërthorët aktive dhe ndërmjetësimi në dhënien e mitos. Te kjo formë e veprës penale zbatohen sanksione me heqjen e lirisë tre muaj deri në tri vjet. Dhurata dhe përfitimet materiale sekuestrohen. Ligji parasheh lirimin nga dënimi nëse: dhurata është dhënë me kërkesë të zyrtarit, kryesi të paraqes veprën para zbulimit.

Neni 337 e Kodit Penal të Kroacisë parasheh figurën e veprës penale të  shpërdorimit të detyrës zyrtare. Sanksionet penale për këtë vepër parashihet dënimi me heqje lirie nga tre muaj deri në pesë vjet. Ndërsa në rastet më të rënda është paraparë dënimi deri në dhjetë vite.[92]

Shteti Kroat gjatë periudhës së integrimit në Bashkësinë Evropiane arriti me sukses që brenda një periudhe të shkurtër të bëjë harmonizimin e ligjeve të saja me ato të  BE, duke përfshirë këtu edhe legjislacioni penal në luftë kundër korrupsionit. Qeveria Kroate në vitin 2001 themeloi Zyrën për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin e organizuar. Rasti i gjykimit të ish kryeministrit të Kroacisë Ivo Sanader për korrupsion shënoj kthesë në politikën e luftimit të korrupsionit në qarqe të larta shtetërore. Ai u dënua me dhjet vjet burg për akuza korrupsioni,

[91]Hetemi, M. &Jashari, N., Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit - me komentim, Prishtinë, 2013, fq. 316

[92]Jovasevic,D., Zloupotreba sluzbenog polozaja I korrupcije, Beograd, 2005, fq. 125

duke përfshirë marrjen e ryshfetit prej 5 milion € nga grupi hungarez i energjisë MOL në këmbim të sigurimit të drejtës së kontrollit në kompaninë shtetërore të naftës INA të Kroacisë[93]

Kuadri ligjor I cili rregullon korrupsionin përbëhet prej shumë ligjeve të cilat janë në funksion të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit në Kroaci. Ligjet të cilat janë në funksion të luftimit të korrupsionit janë këto:

-Ligji për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar

-Ligji për konfiskimin e pasurisë e fituar si pasoj e veprave penale.

Pavarsishtë ligjeve të korrupsionit dhe formimit të organizmave për luftimin e korrupsionit, shteti kroatë ballafaqohet me këtë dukuri në të gjitha segmentet e jetës, kështu në vit 2016 në Raportin vjetor të Agjencisë për Sigurinë Kombëtare të Kroacisë u raportua për rrezikim të sigurisë kombëtare për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit në institucionet shtetërore. Fjala ishte për një numër të gjyqtarëve në lidhur me rastin e ish kryeministrin Ivo Sanader.[94]

### 3.4. Rregullimi i legjislacionit për Korrupsionin në Evropë

Shtetet e ndryshme në botë të shqetësuara për seriozitetin e rreziqeve të cilat dalin nga korrupsioni, duke dëmtuar institucionet, jetën e qytetarëve dhe vetë sistemin ligjore të shtetit, vendosën të ndërmarrin hapa në drejtim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Instrumenti me i rëndësishëm që do të trajtoj korrupsionin në fushën ndërkombëtare është Konventa e OKB-ës kundër korrupsionit. Kjo konventë ka për qëllim të rregullojë aspektet preventive të korrupsionit me anë të bashkëpunimit ndërkombëtar, konfiskimit dhe marrjen e pasurisë dhe kthimin e saj në shtetin përkatës. Konventa është akti i parë juridik i obligueshëm

[93]https://www.nytimes.com/2012/11/21/world/europe/former-premier-of-croatia-ivo-sanader-is-sentenced-for-graft.html, shikuar me datë 1.02.2019
[94] http://balkans.aljazeera.net/vijesti/korupcija-u-pravosudu-izazov-za-hrvatsku

ndërkombëtar, ku shtetet janë të obliguara të veprojnë në fazën paradeliktore, me qëllim të parandalohen pasojat e korrupsionit.

Veprimi i shteteve anëtare të BE-së në luftimin e korrupsionit ishte Konventa për Luftën kundër Korrupsionit që ka të bëjë me zyrtarët e Komuniteteve Evropiane ose zyrtarët e Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian, të miratuar nga Këshilli i Bashkimit Europian në vitin 1997. Kjo konventë është paraparë si formë klasike e parandalimit të korrupsionit, e cila përcakton standardet e sjelljes etike të nëpunësve  në kryerjen e detyrave , obligimeve ndaj publikut, monitorimi i nëpunësve publik nga qytetarët e qarkut ku ofrohen shërbimet. [95]Pas kësaj pasojën Konventa e së Drejtës Penale mbi Korrupsionin si dhe Konventa e së Drejtës Civile mbi Korrupsionin.

Me qëllim të parandalimit të korrupsionit Këshilli i Evropës themeloi Grupin e Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO) organizëm i cili do të bëjë mbikëqyrjen e shteteve anëtare në përmbushjen e standardeve anti - korrupsionit të organizatës. Objektivi i GREGO është të përmirësoj kapacitetin e anëtarëve  të saj për të luftuar korrupsionin duke identifikuar mangësitë në politikat kombëtare të anti - korrupsionit, duke nxitur reformat e nevojshme legjislative, institucionale dhe praktike, duke ofruar një platformë për ndarjen e praktikave më të mira në parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit.[96]

[95]Po aty, fq. 269
[96]https://www.coe.int/en/ëeb/greco/about-greco, shikuar me datë 06.02.2019

## KAPITULLI IV

## 4. KUPTIMI DHE NDIKIMI I DISA FAKTORËVE KRIMINOGJEN NË SHFAQJEN E KORRUPSIONIT

Korrupsioni është rrjedhojë e shumë faktorëve që kushtëzojnë lindjen, zhvillimin apo dinamikën e tij, ku përfshihen edhe problemet socio-ekonomike dhe politike që kalon një vend i caktuar në një kohë të caktuar. [97] Korrupsioni është në rritje si rezultat i faktorëve të brendshëm si:[98]

- Rezultat i tranzicionit të gjatë në të gjitha sferat e jetës shoqërore;
- Mungesës së ardhmërisë dhe perspektives;
- Kriza ekonomike në vazhdimësi;
- Mungesa e strategjive konkrete për punësimin e rinisë (për çdo vit në tregun e Kosovës kemi rreth 30.000 të rinj të cilët kanë nevojë për punë);
- Shpenzimet e tepërta institucionale lokale dhe qendrore të shtetit.
- Ulja e investimeve kapitale dhe rritja e shpenzimeve kanë ndikim në stimulimin e korrupsionit.

Në mënyrë indirekte korrupsioni është në rritje si rezultat i faktorëve të jashtëm si:

- Mungesa e përkrahjes nga institucionet ndërkombëtare;
- Mos liberalizimi;
- Ndërhyrja e vazhdueshme në politikat e vendit;

[97] Salihu,I., Krimi Ekonomik – Sfidat e sigurisë kombëtare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, përballë krimit ekonomik, Shkup, 2012, fq. 70

[98] Gjinovci, A.,Krimi Ekonomik dhe Etika në Organizatat Bashkohore, Prishtinë, 2016, fq. 100-101

- Mos veprimi i organeve të drejtësisë të udhëhequra nga institucionet ndërkombëtaret (UNMIK, tani EULEX);
- Ndikimet në përkrahjen e caktuar të krahëve politike nga institucionet ndërkombëtare me të vetmin qëllim arritjen e objektivave të tyre;
- Përkrahja financiare më e dobët në raporte me vendet e tjera të rajonit.

Faktorët kriminogjen konsiderohen si rrethana të natyrës objektive dhe subjektive që ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit, të cilat shpjegojnë lidhjet dhe ndikimet me aktivitetet kriminale.[99]

Disa nga faktorët kriminogjen të cilët kanë ndikuar në përhapjen e korrupsionit në Kosovë janë:

- Motivi material – pasurorë;
- Mungesa e zbatueshmërisë së ligjeve;
- Mungesa e transparencës;
- Mungesa e llogaridhënies;
- Tranzicioni i shoqërisë;
- Mjetet e komunikimit publik – masmedia;
- Lufta dhe rrethanat e luftës;
- Kushtet e vështira ekonomike - sociale, etj.

[99] Dr. Halili, Ragip, "Kriminologjia", Prishtinë, 2016, fq. 236

## 4.1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I FAKTORËVE KRIMINOGJEN

Në shkencën e kriminologjisë shpeshherë hasim në përdorimin e nocionit "faktor kriminogjen" në kuptimin e përcaktimit të shkaqeve që ndikojnë në shfaqjen e kriminalitetit dhe që kanë një rëndësi etiologjike.

Sot, të gjithë kriminologët që merren me studimin e etiologjisë së kriminalitetit janë të pajtimit se shfaqja e formave të veçanta të kriminalitetit është pasojë e ndikimit të faktorëve të caktuar kriminogjenë.

Në shfaqjen e korrupsionit, ndikim të madh kanë faktorët e natyrës objektive dhe subjektive, të cilët janë në lidhshmëri reciproke njëra me tjetrin. Pra, studimi i faktorëve të tillë kanë një rol të rëndësishëm për përcaktimin e manifestimit dhe shfaqjes e kësaj dukurie. Në hulumtimin e kësaj teme, përveç tjerash, janë trajtuar dhe analizuar disa nga faktorët kriminogjen, që ndikojnë në paraqitjen e korrupsionit.

## 4.2. NDIKIMI I DISA FAKTORËVE KRIMINOGJEN NË PARAQITJEN E KORRUPSIONIT

Faktorët kriminogjen janë të gjitha ato shkaqe, kushte dhe rrethana që ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit dhe sjelljeve të ndryshme kriminale në një shoqëri, d.m.th., faktorët kriminogjen paraqesin, dukuritë, shkaqet që kanë ndikim në kriminalitet.[100]

Në shfaqjen e dukurisë së korrupsionit ndikojnë shumë faktorë kriminogjen të natyrës subjektive dhe objektive, por ne do t'i analizojmë vetëm disa faktorë kryesor të cilat ndikojnë në shfaqjen korrupsionit në Kosovë, si:

a) Kushtet e vështira të banimit;

[100]Halili, R., vep. e cit. fq.106.

b) Lufta dhe rrethanat e luftës;

c) Krizat ekonomike;

d) Migrimi i njerëzve;

e) Tranzicioni i shoqërisë;

f) Mjetet e komunikimit publik, etj,

## a) Kushtet e vështira të banimit

Kushtet e vështira të banimit si faktorë kriminogjenë zënë vend të rëndësishëm në trajtimet dhe kërkimet empirike të etiologjisë kriminale. Problemi i banimit e sidomos mungesa e zgjedhjes së banimit adekuat janë të lidhura me procesin e migrimit të popullsisë, përqendrimin e saj nëpër qendra dhe qytete, lëvizjet masovike prej viseve fshatare kah viset urbane dhe industriale. Për shkak të lëvizjeve të mëdha të popullsisë dhe ardhjes stihike në për qendra urbane dhe industriale krijohet situatë e mungesës së hapësirës banesore.[101]

Nga kërkimet dhe hulumtimet kriminologjike të këtij faktori vërehet se nëpër banesa dhe dhoma joadekuate vendosen disa familje me shumë anëtarë, kështu që qëndrimi dhe jetesa në to është shumë e vështirësuar. Kjo situatë ndikon që të miturit dhe të rinjtë, shpeshherë për shkak të kushteve të vështira të banimit të braktisin familjen, të kërkojnë zgjidhje tjera duke u marrë me sjellje dhe veprime të ndryshme kriminale,[102] duke përfshirë edhe veprimet e ndryshme korruptive, e sidomos ato në proceset e ndryshme të prokurimit publik, ku këta janë pjesë e procesit të tillë publik – shtetëror.

[101]Halili, R., vep. e cit. fq. 116.
[102]Horvatić, Ž.,Elementarnakriminologija, Rijekë, 1981, fq. 116-117, cituar sipas Halili, R., vep.e cit. fq. 116.

## b) Lufta dhe rrethanat e luftës

Një ndër faktorët objektivë që ndikon në shfaqjen e korrupsionit është edhe lufta dhe rrethanat e luftës. Kështu, ndikimi i rrethanave të luftës në manifestimet e ndryshme kriminale mund të shikohet në tri faza të aktiviteteve luftarake. Flitet për ndikimin e rrethanave në fazën e përgatitjes së luftës, në fazën e zhvillimit të luftës dhe në fazën e pasluftës.[103]

Në periudhën e hulumtuar të korrupsionit 2012 -2017, Kosova e përjetoi dy fazat e cekura më lart (para luftës dhe pas luftës). Në fazën e parë, atë të përgatitjes për luftë, e tërë Kosova ishte e okupuar nga forcat ushtarake, policore dhe administrata e korruptuar serbe, e cila kishte vendosur dhunshëm pushtetin e saj në të gjitha segmente e jetës në Kosovë.

Në bazë të kërkimeve të bëra në evidencat e Gjykatave të Kosovës, nuk kemi arritur që të gjejmë ndonjë rast të dënimit të ndonjë zyrtari të lartë për korrupsion. Kjo, nënkupton se "numri i errët dhe i përhimë" i korrupsionit ka qenë në shkallë tejet të lartë gjatë kësaj periudhe kohore.

Lufta në Kosovë ka paraqitur një ndër katastrofat më të rënda për popullatën e atakuar shqiptare. Në Kosovë, gjatë periudhës së luftës (1998-1999) u shkatërruan dhe u dogjën mbi 100.000 objekte banimi dhe afariste nga forcat okupatore serbe, u vranë mbi 13.000 njerëz, pleq, gra, fëmijë, të pafajshëm, etj. Kjo periudhë karakterizohet pandërprerë me luftë dhe rrethanat e luftës, prandaj përkundër asaj se edhe në këto rrethana kanë ekzistuar aktet e ndryshme kriminale, duke përfshirë edhe të korrupsionit, institucionet e tanishme kosovare nuk posedojnë ndonjë evidence për aferat e tilla korruptive, të kësaj periudhe kohore, si pasoj se regjistrat publik të gjykatave dhe prokurorive janë marrur me vete nga pushteti serb, gjatë largimit nga Kosova (1999) pas hyrjes së forcave aleate perëndimore në Kosovë.

Nga e tërë kjo, mund të përfundojmë se lufta dhe rrethanat e luftës janë faktor kriminogjen, me ndikim të madh në shfaqjen e korrupsionit.

[103]Halili, R., Kriminologji me Penologji, Prishtinë, 1995, fq.121.

## c) Krizat ekonomike

Krizat ekonomike paraqesin një ndër faktorët kryesorë që ndikon në paraqitjen e kriminalitetit në përgjithësi Kosova ka pasur edhe ngritët dhe rëniet e saja në fushën ekonomike. Periudha më e vështirë ekonomike në Kosovë ka dominuar nga periudha e suprimimit të autonomisë së Kosovës 28 Mars 1989 e tutje, deri në vitin 1999.

Kjo ishte periudha e mbijetesës ekonomike të popullit shqiptar në Kosovë, sepse asaj i ishte suprimuar autonomia e saj me ndryshimet kushtetuese të 23.03.1989[104] që i bëri pushteti i dhunshëm serb, me qëllim që ta nënshtronte popullin shqiptar sidomos në aspektin ekonomik dhe politik. Kjo gjendje e vështirë ekonomike i shtyri një numër të madh të qytetarëve, përkundër dëshirës që të hyjnë në raporte korruptive, shumica absolute për shkak të imponimit të një raporti të tillë korruptiv nga vetë pushteti ekzistues serb.

Për ta dëshmuar ndikimin e institucioneve shtetërore serbe në kriminalizimin e jetës ekonomike, në Kosovë, nuk kemi arritur të gjejmë në Gjykatat e Qarkut të Kosovës ndonjë dëshmi me peshë për shkencën kriminologjike. Ky, nuk është fakt se nuk ka pasur raste të tilla, por është një dëshmi e cila tregon se pushteti serb me qëllim iu ka shmangur evidentimit gjyqësor të rasteve të tilla, duke pasur parasysh se një ndër interesat vitale të pushtetit të dhunshëm serb në Kosovë ishte zbatimi i parimit: "Shkatërro (kriminalizo) çdo pore të jetës, por mos le asnjë gjurmë!"[105]

Gjendja e vështirë ekonomike në Kosovë vazhdoi edhe në periudhën e pasluftës (pas vitit 1999), kur Kosova ishte në fazën e ndihmës emergjente, e më vonë edhe të rindërtimit dhe zhvillimit. Kjo etapë gjithashtu karakterizohet me një shkallë të lartë të krizës ekonomike, ku shumica e fabrikave ishin jashtë funksionit të tyre, si pasojë e shkatërrimeve dhe e plaçkitjes së tyre nga pushteti serb i instaluar dhunshëm në Kosovë gjatë periudhës 1989-1999.[106]

[104]Më datën 23.03.1989 Serbia ia suprimoi Kosovës autonominë, që e kishte me Kushtetutën e vitit 1974.
[105]Më gjerësisht shih Beka, A., Abuzimet në lemin e qarkullimit të pronës së paluajtshme në Kosovë – Aspekti kriminologjik, Prishtinë, 2007.
[106]Po aty.

Kjo fazë karakterizohet me rifillimin e aferave të shumta korruptive në Kosovë, e sidomos gjatë periudhës së ndihmave dhe investimeve nga subjektet e jashtme që ndihmon rimëkëmbjen e Kosovës dhe zhvillimin e saj. Kjo periudhë karakterizohet edhe me shumë afera korruptive q ë kanë ndodhur në Kosovë, ky kryes na paraqiten edhe persona në pozita të larta zyrtare – shtetërore, si psh. Afera korruptive e pasaportave, Afera e Hotel Grandit, aferat e shumta korruptive në KEK (Korporata Elektroenergjetike e Kosovës), PTK (Post Telekomi I Kosovës), aferat korruptive gjatë shitjes së paluajtshmërive në pronësi shoqërore nga AKM - AKP (Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit – Agjencioni Kosovar i Privatizimit), etj.

### d) Migrimi i njerëzve

Dukuria e migrimit është faktor i cili ka ndikim të madh në psikologjinë e jetës së personave të migruar. Këtë dukuri e ndihmon në një masë të madhe edhe integrimi i vështirë i tyre në shoqërinë dhe rrethin e ri.

Kosova karakterizohet me një shkallë të lartë të dendësisë dhe shtimit të popullsisë. Më 1989 ajo kishte 1.941.937 banorë, me një sipërfaqe territoriale prej 10.906 $km^2$.[107]Prandaj, kushtet ekonomiko-shoqërore në Kosovë kanë shkaktuar zvogëlimin e fondit të sipërfaqes së tokës së punueshme si pasojë e ndërtimeve të objekteve të shumta, të banimit, objekteve afariste, etj. Kjo situatë ka krijuar probleme të shumta të natyrës sociale dhe ekonomike, e sidomos është evidente fuqia e madhe punëtore, e paangazhuar në jetën ekonomike dhe shoqërore. Prandaj, në Kosovë të gjitha statistikat tregojnë se nuk ekziston ndonjë evidencë zyrtare lidhur me shkallën e migrimit të njerëzve në relacionin fshat-qytet për periudhën kohore 2012 – 2017.[108] Por, heqja dorë nga jeta në fshat dhe migrimi në qytet (në ambientin e ri), duke u pozicionuar në pozita të ndryshme në institucionet publike – shtetërore dhe kompani private, ka krijuar

[107]Vjetori Statistikor i ish-KSA të Kosovës, Prishtinë, 1988.

[108]Sipas disa shënimeve statistikore (jozyrtare) numri i banorëve të Prishtinës është dyfishuar në raport mes periudhës së paraluftës (para 1999) dhe pas luftës, nga 250.000 në 500.000 banorë.

hapësirë të mjaftueshme për disa persona nga kjo kategori që të hyjnë në raporte korruptive, sidomos në fushën e prokurimit publik, por edhe të shërbimeve tjera publike.

## e) Tranzicioni i shoqërisë

Kosova në vitin 1999 u çlirua nga okupatori serb. Përkundër kësaj, periudha e pasluftës paraqet një etapë të rëndë si në fushën politike, shoqërore, ekonomike për Kosovën dhe popullin e saj. Kjo ishte periudha kur është menduar se Kosova do të avancoj shpejt në të gjitha etapat e zhvillimit të saj.

Në vitin 2008 Kosova e shpalli pavarësinë e saj. Kjo e forcoi bindjen se Kosova është në rrugë të drejtë për ta tejkaluar periudhën e tranzicionit. Pas 19 vitesh nga përfundimi i luftës Kosova ende është në faza të ndryshme tranzicioni, e cila do të zgjasë, si pasoj e krizës së përgjithshme që ekziston: Krizës ekonomike, shoqërore, politike, sociale, morale etj. që ka atakuar shoqërinë kosovare.

Kjo periudhë karakterizohet me ndryshime të theksuara të sistemit politik, me transformime të mëdha të pronësisë shoqërore në pronësi private (gjatë procesit të privatizimit, transformimit të ndërmarrjeve shoqërore në ndërmarrje publiko – private, etj), por të atakuar nga dukuria e korrupsionit gjatë transformimeve të tilla të kryera.

Pasojat e veprimeve të tilla në Kosovë shihen edhe sot e kësaj dite. Kjo dhe shumë keqpërdorime tjera e kanë ngadalësuar fazën e tranzicionit të shoqërisë kosovare.

Nga kjo mund të konstatojmë se "Kosova, po kalon një tranzicion të vështirë drejt një ekonomie të tregut të lirë. Kjo gjendje ekonomike ndikon në kryerjen e veprimeve kriminale dhe cenimin e sigurisë në përgjithësi".[109]

## f) Mjetet e komunikimit publik-masmedia

Qytetarët shpeshherë bëhen viktimë e dukurisë së korrupsionit me anë të, mashtrimit dhe lajthimit që ndaj tyre realizohet përmes mjeteve të informimit: televizionit, radios, portaleve të ndryshme etj. Kjo është karakteristikë në kohë të fundit në mjetet e informimit publik në Kosovë, për shembull: në televizionet dhe portalet e ndryshme të internetit, reklamohen subjekte të ndryshme fizike dhe juridike që kanë përfituar miliona euro nga proceset e "tenderomanisë" (prokurimit publik), të cilat subjekte përnjëherë rrisin standardin e jetesës, deri në nivele enorme (vetura luksoze,garderobë të shtrenjtë, ndërtojnë objekte të mëdha komerciale dhe kolektive për banim, shpenzojnë pa kontroll në manifestime të ndryshme, etj).

Reklamat e tilla shtyjnë qytetarët që ta rrisin dëshirën e përfitimit të madh dhe të shpejtë të kapitalit financiar, e cila mundet të bëhet parimisht përmes keqpërdorimeve dhe proceseve të ndryshme korruptive në një shoqëri të tillë.

Për këtë shkak masmediat dhe kriminaliteti janë në qendër të diskutimeve të kriminologëve, penalistëve dhe sociologëve, të cilët e pranojnë ekzistencën e një lidhjeje të drejtë të medias me kriminalitetin. Kur flasim për median, kemi parasysh jo vetëm median elektronike, por dhe median e shkruar, si: gazetat, revistat, botimet e ndryshme.[110]

[109]Latifi,V.,Problematika e krimit tëorganizuar në Kosovë, bashkëpunimi në nivel kombëtar,rajonal dhe ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar, Revista "E drejta", nr.4, 2002, fq. 30.
[110]Hysi,V., vep.e cit. fq. 84.

Në këtë aspekt do të theksonim domosdoshmërinë e krijimit dhe mbështetjen e gjithanshme të sjelljeve kundër-kriminale e para së gjithash edukimin e publikut me qëllim që të qëndrojë larg krimit dhe që ta raportojë atë. Prandaj, për ta realizuar këtë edukim një rol të veçantë luajnë mjetet e informimit publik-masmedia elektronike dhe ajo e shkruar.[111]

[111]Hysi,V., vep.e cit. fq. 66.

## KAPITULLI V

## 5. EFEKTET DHE PASOJAT E KORRUPSIONIT

Si pasojë e korrupsionit, vendi fillon të zhytet në varfëri dhe në krizë ekonomike, në administratën publike është shumë prezent jo efikasiteti, në gjyqësi po ashtu mungojnë aktgjykimet nga ana e gjyqësorit, mungon legjislacioni përkatës, po ashtu qytetarët fillojnë ta humbin besimin në institucionet e veta.[112]

Hetimet e korrupsionit të rasteve të profilit të lartë nga ana e prokurorëve vendorë dhe Policisë së Kosovës janë peng i ndërhyrjeve politike dhe mungesës të pavarësisë së këtyre institucioneve, e cila në fakt është pranuar gjerësisht nga zyrtarët vendor, prania diplomatike në Kosovë dhe raportet vjetore të Komisionit të Bashkimit Evropian (BE-së). Mungesa eefikasitetit dhe pavarësisë së institucioneve të sundimit të ligjit për t'u marrë me korrupsionin e bën zgjatjen e mandatit të EULEX-it të nevojshme dhe të pashmangshme.[113]

Korrupsioni ndikon edhe në mënyrë indirekte në njerëzit e varfër, sepse pengon rritjen ekonomike, fuqizon pabarazinë, shtrembëron alokimin e mjeteve apo shpenzimeve publike, prandaj të gjitha këto janë pengesa për zbutjen e varfërisë.[114]

[112]Revistë Shkenore "Juridica" 4/2015, Prishtinë, 2015, fq. 103
[113] OJQ - KIPRED, Hetimi i korrupsionitnëKosovë: (Mos) bashkëpunimi në mes të policies dhe prokurorisë, Nr. 1/14, Prishtine, 2014, fq.4
[114] Po aty, 104

### 5.1. Efektet në ekonominë e vendit

Disa nga pasojat e korrupsionit në sferën ekonomike e sociale janë:[115]

- Korrupsioni ndikon në mospërdorimin me efektivitet të burimeve ekzistuese të një shteti, duke përfshirë edhe ato të karakterit natyror;
- Korrupsioni shkatërron ekonominë. Synimi i tij është penetrimi në strukturat drejtuese të ekonomisë dhe kur ai të sistemohet, krijon situata të vështira për këto struktura të infektuara dhe për popullatën, pasi do të pasojë rritja e pajustifikuar e kostos së mallrave dhe të shërbimeve mbi vlerat reale normale të tyre.
- Sjell rritjen marramendëse të borxheve shtetërore. Kjo dukuri është karakteristike, sidomos për vendet me prapambetje relative ekonomike apo edhe ato në zhvillim siç është edhe vendi ynë.
- Dëmton sferën e investimeve, sidomos atyre me kapital të huaj, për të cilat dihet roli që luajnë për ekonominë e çdo vendi. Ndikimi i korrupsionit në sferën e investimeve shfaqet në dy rrafshe: së pari, krijon barrierën e parë dhe shpeshherë të pakalueshme për këto investime, dhe së dyti ndikon në rritjen e kostos së projekteve investuese, që në fund të fundit do të sjellë mosrealizimin e tyre.
- Krijimi dhe zgjerimi i ekonomisë informate, sjell rritjen e dukshme të veprave kriminale në lëmin e tatim-taksave dhe mosinkasimin e përdorimit të tyre, që dobëson buxhetin e shtetit. Në këto kushte, shteti privohet nga mekanizmi kryesor për drejtimin e ekonomisë dhe çrregullimet e kësaj natyre gjithmonë ashpërsojnë problemet sociale, për shkak të mosplotësimit të kërkesave të parashikuara, fillimisht në buxhetin shtetëror.
- Godet të drejtën dhe diskrediton sistemin e drejtësisë, që është sistem kryesor për rregullimin e marrëdhënieve të shoqërisë dhe shtetit.
- Krijon gjendje pasigurie dhe frikë në ndërgjegjen shoqërore ndaj krimit, kriminelëve dhe njerëzve të veshur me petkun e pushtetit.

[115]Salihu,I., vepër e cituar, fq. 92-93

- Zhvleftëson rolin dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile.

### 5.2. Korrupsioni në polici

Sistemi policor në Kosovë është garantim për një mjedis të sigurt për shoqërinë i cili do t'i siguronte qytetarëve te saj një jetë të qet dhe të dinjitetshme larg dhunës dhe krimit. Përgjegjësit e saja janë: të mbrojë jetën e qytetarëve, sigurinë dhe pronën e tyre personale, të hetoj dhe zbuloj veprat penale, të mbrojë rendin dhe sigurinë kombëtare, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe trajtimi në mënyrë të barabartë i të gjithë qytetarëve pa dalim race, ngjyre, religjioni, gjinie dhe moshe. Përkundër misionit që ka, as sistemi policor i Kosovës nuk i ka shpëtuar tundimit të kohës-korrupsionit, si një kërcënim i vazhdueshëm për integritetin e policisë. Korrupsioni në rradhët e punonjësve të policisë nënkupton: abuzim me postin dhe abuzim me të qenurit zyrtar i policisë. Sipas Strategjisë Anti Korrupsion të Policisë Kufitare të Qeveris së Kosovës[116], korrupsioni është përcaktuar si një keqpërdorim i detyrës për përfitime personale. Korrupsioni nuk është I përhapur njësoj në të gjitha strukturat e policisë. Përfshirja e punonjësit të policisë në korrupsion mund të ishte: individuale, strukturore dhe institutucionale. Faktorët që ndikojnë në paraqitjen e korrupsionit janë: pagat e pamjaftueshme, mungesa e mbikëqyrjes, mungesa e kulturës profesionale,etike të oficerëve policor, pasurimi I shpejt personal dhe qëndrimi i gjatë në detyrë të njehët.[117] . Në vitin 2011 është raportuar se Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës për shkak të dyshimeve se zyrtarë të lartë të policisë janë të lidhur me struktura të ndryshme ilegale në Kosovë, bëri disa ndryshime në strukturën e Policisë së Kosovës.[118]Sipas shënimeve44 zyrtarë policorë po hetohen për përfshirje në vepra të ndryshme penale, katër (4) prej tyre dyshohen për vepra penale me elemente korruptive, ndërsa dyzet (40) po hetohen për vepra të tjera. Sa u përket kallëzimeve penale, ndaj dymbëdhjetë (12) zyrtarëve policorë është ngritur kallëzim penal kundër disa policëve lëndët e te cilëve janë dërguar në prokuroritë kompetente nga Inspektorati Policor i Kosovës. Ndërsa në vitin e kaluar rreth 80 zyrtarë policorë janë larguar nga

[116]Për më tepër shiko Strategjia Anti Korrupsion, Policia Kufitare,Qeveria e Kosovës, Janar 2009
[117]Po aty, faqe 4.
[118] Shih Raportin e KIPRED – it, Pandëshkueshmëria në Kosovë: Pasuria e pajustifikueshme, fq.14, Prishtine, 2013

Policia e Kosovës. Prej tyre njëqindedyzet (140) ankesa janë dërguar në Departamentin e Hetimeve - IPK për hetim penal, kurse 183 ankesa që janë klasifikuar si shkelje disiplinore janë përcjellë për t'u trajtuar në Drejtorinë e Standardeve Profesionale në Policinë e Kosovës, një (1) ankesë është dërguar në një institucion tjetër dhe dy ankesa (2) janë mbyllur në IPK. Ndërsa të dhënat e Policisë së Kosovës tregojnë se 79 zyrtarë policorë janë larguar nga puna vitin e kaluar. Por, njohësit e çështjeve të drejtësisë thonë se ulja e numrit të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar brenda Policisë së Kosovës do të bëhej nëse do të bëhej ngritja e pagave për policët. Ndonëse janë të thirrur për ta mbrojtur ligjin, është i madh numri i zyrtarëve policorë të cilët vetë janë të përfshirë në vepra penale. Rreth 330 ankesa kundër zyrtarëve policorë janë adresuar në Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) vetëm në tre muajt e parë të këtij viti.[119]

Në vitin 2018 Policia e Kosovës numëronte 8.750 punonjës. Në kuadër të sistemit institucionet e Kosovës kanë Inspektoratit Policor të Kosovës si institucion I pavarur I cili si objektiv ka paranandalimin, zbulimin, hetimin e veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës. Bazuar nga kompetencat e dala nga ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, IPK-ja pranon dhe shqyrton të gjitha ankesat e qytetarëve të cilat I referohen Policisë së Kosovës. Ankesat mund të parashtrohen: dorëzimit në formë fizike(dorëzim fizik ose me postë); dorëzimi në formë elektronike; deklarimi me anë të telefonit; dhënies së deklaratës personale, përmes kutive të ankesave etj.

Inspektorati Policor I Kosovës gjatë Raportit vjetor të vitit 2017 ka hetuar këto ankesa më të shpeshta me të veprës penale: keqpërdorim I detyrës apo autoritetit zyrtar 107 raste; lëndim trupor 60; manipulim me prova material 55; aksident trafiku me lëndime 54; keqtrajtim gjatë ushtrimit te detyrës zyrtare 45; [120]

Në tabelën nr.3 janë paraqitur veprat më të shpeshta të cilat janë më së shpeshti të hetuara nga IPK-ja.

[119]Gazeta ditore ZERI, e dates: 24 Prill 2018
[120]http://ipk.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2015/02/Raporti-vjetor-2017-IPK.pdf, shikuar 8.02.2109




| | Rrezikim i trafikut publik | Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar | Lëndim i lehtë trupor | Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare | Kanosje |
|---|---|---|---|---|---|
| 2015 | 44 | 39 | 27 | 12 | 8 |
| 2016 | 45 | 39 | 31 | 14 | 7 |
| 2017 | 54 | 32 | 20 | 15 | 10 |

Tabela nr. 3. Veprat penale më të shpeshta të hetuara nga IPK-ja

Burimi: Raporti Vjetor për vitin 2017 Inspektorati Policorë I Kosovës

Rëndësi të veçantë IPK-ja I ka kushtuar veprave me element të" Korrupsionit zyrtar" dhe "Kundër detyrës zyrtare". Këtë vit, IPK-ja ka hetuar 36 raste me 'Vepra penale kundër detyrës zyrtare", ndër të cilat më të shpeshtat kanë qenë: 32 vepra të "Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar", gjashtë (6)vepra të"Marrjes së ryshfetit", tre (3) vepra të "Ushtrimit të ndikimit", dy (2) vepra të "Zbulimit të fshehtësisë zyrtare" dhe një (1) vepër të "Përvetësimit në detyrë"[121]

Gjatë vitit 2016, IPK-ja ka hetuar 55 raste nën dyshimin se janë kryer vepra penale me elemente të korrupsionit dhe veprave tjera kundër detyrës zyrtare ndër të cilat më të shpeshtat kanë qenë: 39 vepra të keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, 13 vepra të marrjes së ryshfetit, 2 vepra zbulim i fshehtësisë zyrtare, 1 vepër të përvetësimit në detyrë dhe 0 vepër të konfliktit të interesit.[122]

[121]http://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/02/Raporti-vjetor-2017-IPK.pdf, shikuar 8.02.2109
[122]http://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/02/Raporti-vjetor-2016.pdf, shikuar 8.02.2019

Gjatë vitit 2015 IPK-ja ka hetuar 62 vepra penale me elemente të korrupsioni: 39 vepra të keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, 4 vepra falsifikim i dokumentit zyrtar, 11 vepra të marrjes së ryshfetit, 1 vepër të ushtrimit të ndikimit, 2 vepra zbulim i fshehtësisë zyrtare, 1 vepër të dhënies së ryshfetit, 2 vepër të përvetësimit në detyrë, 2 vepra të mashtrimit dhe 0 vepër të konfliktit të interesit.[123] Të gjitha këto janë të evidentuara në tabelën nr.4




| | Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar | Falsifikimi i dokumentit zyrtar | Marrja e ryshfetit | Ushtrimi i ndikimit | Zbulimi i fshehtësisë zyrtare | Dhënia e ryshfetit | Përvetësimi në detyrë | Konflikt interesi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2015 | 39 | 4 | 11 | 1 | 2 | 1 | 2 | 1 |
| 2016 | 39 | 0 | 13 | 0 | 2 | 0 | 1 | 0 |
| 2017 | 32 | 2 | 6 | 3 | 2 | 0 | 0 | 0 |

Tabela nr.4 Veprat penale me element të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare 20015-2017.

Burimi:Raporti Vjetor IPK-ës 2017

Në vitin 2014, IPK-ja ka hetuar 83 vepra penale me elemente të korrupsionit dhe veprave tjera kundër detyrës zyrtare ndër të cilat më të shpeshtat kanë qenë: 48 vepra të keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, 12 vepra falsifikim i dokumentit zyrtar, 10 vepra të marrjes së ryshfetit, 4 vepra të ushtrimit të ndikimit, 4 vepra zbulim i fshehtësisë zyrtare, 2 vepra të dhënies së ryshfetit, 1 vepër të përvetësimit në detyrë, 1 vepër të mashtrimit dhe 1 vepër të konfliktit të interesit.[124]

[123] http://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/02/Raporti-Vjetor-20151.pdf,shikuar 10.02.2019
[124] http://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/02/Raporti-vjetor-2014.pdf,shikuar 10.02.2019

Në vitin 2013 IPK-ja ka pranuar dhe hetuar 51 raste të veprave penale me elemente të korrupsionit  dhe veprave tjera kundër detyrës zyrtare ndër të cilat më të shpeshtat kanë qenë: 35 raste të keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, 9 raste marrje ryshfeti, 2 raste të përvetësimit në detyrë, 2 raste të përdorimit të paautorizuar të pasurisë, 2 raste falsifikim i dokumentit zyrtar dhe 1 rast i zbulimit të fshehtësisë zyrtare.[125] Ndërsa gjatë vitit 2012 IPK-ja ka hetuar Shpërdorim i detyrës zyrtare apo autorizimit (neni 339 i KPK-së) 42, Marrja e ryshfetit (neni 343 i KPK-së) 10




| | Lëndim i lehtë trupor | Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare | Shpërdorim i detyrës zyrtare apo autorizimit | Rrezikim i trafikut publik | Kanosje |
|---|---|---|---|---|---|
| 2012 | 52 | 45 | 42 | 40 | 30 |
| 2013 | 38 | 30 | 35 | 43 | 20 |
| 2014 | 31 | 25 | 48 | 49 | 17 |

Tabela 5. Vepra penale e shpërdorimit I detyrës zyrtare 2012-2013-2014

Burim: Raporti IPK 2014

[125]http://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/02/Raporti-vjetor-2013.pdf, shikuar 10.02.2019.




Tabela 5. Numri i punonjësve të hetuar të Policisë së Kosovës.

Burimi: Raporti Vjetor 2016 IPK

Sipas Raportit të IPK të vitit 2016 numri i punonjësve të policisë së Kosovës të hetuar ishte:

- Në vitin 2016 me 241;
- Në vitin 2015 me 220 persona;
- Ne vitin 2014 me 305 persona;
- Ne vitin 2013 me 328 persona;
- Ne vitin 2012 me 361 persona.

Sipas diagramit si më lart rezulton se numri I punonjësve të hetuar nga IPK-ja gjatë vitit 2016 ka shënuar rënie.

### 5.3. Korrupsioni në Gjyqësor

Sjelljet korruptive të disa gjyqtarëve, prokurorëve dhe disa avokatëve kanë bllokuar funksionalizimin e gjyqësorit në Kosovë. Kjo situatë e krijuar ka shkaktuar shumë dëme prandaj gjykatat, prokuroria dhe avokaturat kanë për detyrë kryerjen e punës në mënyrë sa më profesionale, të pavarur dhe pa asnjë lloj presioni, respektimin e ligjit dhe kontributin e tyre në luftimin e korrupsionit dhe dukurive tjera negative dhe të rrezikshme për shoqërinë tonë duke mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Politikat dhe kornizat ligjore kanë rregulluar në masë të madhe hapësirën e cila lufton korrupsionin. Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial kanë miratuar strategjitë e planit të veprimit për trajtimin e rasteve të korrupsionit me prioritet absolut. Por kjo nuk ka ndikuar që bartësit e sistemit gjyqësorë të zbatojnë me përpikëri të gjitha udhëzimet e dala nga këto politika për luftim të korrupsionit. Si pasoj kemi një joefikasitet të gjyqësorit duke mos ofruar rezultate të pritura. Gjykimi i rasteve të korrupsionit vazhdon të zhvillohet kryesisht ndaj profilit të ulët dhe të mesën. Plofilet e larta ndiqen shumë rrallë, e në të shumtën e rasteve dështojnë në fazën fillestare në gjykatë.

Sipas hulumtimit të bërë ndaj shumë raporteve të organizatave të ndryshme joqeveritare në thekës të veçantë Raporteve vjetore te publikuara nga Instituti i Kosovës për Demokraci[126] rezulton se gjatë monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit nga gjykatat dhe prokurorit duke përfshi të gjitha fazat e procedurës penale, lidhur me trajtimin e një lënde të korrupsionit, nga momenti i inicimit të procedurës penale e gjer në shpalljen e aktgjykimi evidentohen parregullsi të shumta ligjore si shtyrje esencave për shkak të mungesës së të akuzuarve, për shkak të mungesës së prokurorit dhe për shkak të mungesës së gjykatësve[127]

[126] https://kli-ks.org/category/publikime/
[127] https://kli-ks.org/lufte-persekutim-apo-amnisti-ne-emer-te-luftes-kunder-korrupsionit/

Sipas të dhënave zyrtare statistikore të publikuara nga Raporti Vjetor i Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional të publikuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, në vitin 2017 Gjykatat kanë marrë vendime për 169 persona të akuzuar për veprat penale të korrupsionit, prej të cilave[128]:

-Për 23 të akuzuar është hedhur aktakuza para shqyrtimit gjyqësor apo 11.52%;

- 88 të akuzuar janë shpallur fajtor apo 55.16%;

- 38 të akuzuar janë liruar apo 23.64%;

- Për 20 të akuzuar është refuzuar Aktakuza apo 9.70%.

Ne tabelën nr.3 janë të paraqitura numri i personave për të cilat gjykata ka marrë vendim lidhur me aktet akuzuese.

Tabela 3.

| | PROKURORIA | Aktakuza të ndryshuara sipas Nenit 252 të KPP | Numri Personave për të cilët Gjykata ka marrë vendim përkitazi me Aktet akuzuese | Është hudhur Aktakuza para Shqyrtimit Gjyqësor | I akuzuari është shpallur FAJTOR | I akuzuari është LIRUAR | Është REFUZUAR Aktakuza |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SPECIALE | | **3** | 3 | | | |
| 2 | PRISHTINË | **13** | **89** | 10 | 42 | 23 | 14 |
| 3 | PRIZREN | | **15** | | 8 | 7 | |
| 4 | PEJË | | **24** | 5 | 18 | 1 | |
| 5 | GJILAN | | **3** | 2 | 1 | | |
| 6 | MITROVICË | | **10** | 1 | 5 | 4 | |
| 7 | FERIZAJ | | **16** | | 9 | 1 | 6 |
| 8 | GJAKOVË | | **9** | 2 | 5 | 2 | |
| | *GJITHSEJ:* | **13** | **169** | **23** | **88** | **38** | **20** |

Burimi: Raporti i KPK për vitin 2017

[128]http://www.kpkrks.org/assets/cms/uploads/files/publikimet/7%20RAPORTI%20VJETOR%20%20I%20MEKANIZMIT%20PERCJELLES%20NDERINSTITUCIONAL%202017.pdfshikuar 10.02.2019

Lidhur me këto vendime të sjella , gjatë vitit 2017 prokurorët kanë parashtruar 68 ankesa ndaj vendimeve të Gjykatave ,mbi dënimin

- 61 ankesa ndaj vendimit mbi dënimin apo 89.71% të ankesave, dhe 7 ankesa për arsye tjera përveç dënimit apo 10.29% të ankesave.

Tabela 4. Ankesat e ushtruara kundër vendimeve të gjykatës.

| | PROKURORITË | Numri ankesave | Ankesat e Prokurorit ndaj: | | Ankesat e Aprovuara nga Gjykata e Apelit | Përgjigjja e Prokurorit në ankesën e parashtruar nga pala e akuzuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Vendimit mbi dënimin (lartësinë e denimit) | Arsyet tjera (përveç vendimit mbi dënimin) | | |
| 1 | SPECIALE | | | | | |
| 2 | PRISHTINË | **41** | 37 | 4 | | |
| 3 | PRIZREN | **13** | 10 | 3 | | |
| 4 | PEJË | **6** | 6 | | | |
| 5 | GJILAN | **2** | 2 | | | |
| 6 | MITROVICË | **2** | 2 | | | |
| 7 | FERIZAJ | **1** | 1 | | | |
| 8 | GJAKOVË | **3** | 3 | | | |
| | *GJITHSEJ:* | **68** | **61** | **7** | | |

Burimi: Raporti i KPK për vitin 2017

Në vitin 2016 sipas Raportit, Gjykatat gjatë vitit 2016 kanë marrë vendime për 310 persona të akuzuar në aktet akuzuese të prokurorëve për veprat penale të Korrupsionit, prej të cilave[129]:

- 31 aktakuza janë hudhur para shqyrtimit gjyqësor apo 10%;

- 140 të akuzuar janë shpallur fajtor apo 45.16%;

- 78 të akuzuar janë liruar apo 25.16%;

[129]http://kpkrks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Raporte%20Vjetore/Raporti%20vjetor%202016%20i%20Mekanizmit%20p%C3%ABrcjell%C3%ABs%20nd%C3%ABrinstitucional.pdf

- 61 aktakuzë është refuzuar apo 19.67%

Tabela nr.4

| | PROKURORITË | Numri Personave për të cilët Gjykata ka marrë vendim | Aktakuza është hudhur para Shqyrtimit Gjyqësor | I akuzuari është shpallur FAJTOR | I akuzuari është LIRUAR | Është REFUZUAR Aktakuza |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SPECIALE | 3 | | 3 | | |
| 2 | PRISHTINË | 123 | 23 | 44 | 19 | 37 |
| 3 | PRIZREN | 60 | 1 | 25 | 25 | 9 |
| 4 | PEJË | 22 | | 13 | 9 | |
| 5 | GJILAN | 1 | | 1 | | |
| 6 | MITROVICË | 26 | 6 | 15 | 3 | 2 |
| 7 | FERIZAJ | 48 | 1 | 30 | 11 | 6 |
| 8 | GJAKOVË | 27 | | 9 | 11 | 7 |
| | Gjithsej | **310** | **31** | **140** | **78** | **61** |

Burimi: Burimi: Raporti i KPK për vitin 2016

Kundër vendimeve të gjykatës në vitin 2016, Prokurorët kanë parashtruar në Gjykatën e Apelit 94 ankesa ndaj vendimeve të Gjykatave mbi dënimin dhe për arsye tjera përveç vendimit mbi dënimin (shih tabelën 6), respektivisht:

- 31 ankesa ndaj vendimit mbi dënimin apo 32.97%;

- 63 ankesa për arsye tjera përveç dënimit apo 67.02%.

Nga 94 ankesat e prokurorëve, Gjykatat kanë aprovuar 6 kërkesa apo 6.38%[130]

[130]http://kpkrks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Raporte%20Vjetore/Raporti%20vjetor%202016%20i%20Mekanizmit%20p%C3%ABrcjell%C3%ABs%20nd%C3%ABrinstitucional.pdf

Tabela nr.6

| | PROKURORITË | Numri ankesave | Ankesat e Prokurorit ndaj: | | Ankesat e Aprovuara nga Gjykata e Apelit | Përgjigjja e Prokurorit në ankesën e parashtruar nga pala e akuzuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Vendimit mbi dënimin (lartësinë e denimit) | Arsyet tjera (përveç vendimit mbi dënimin) | | |
| 1 | SPECIALE | | | | | |
| 2 | PRISHTINË | 25 | 12 | 13 | 6 | |
| 3 | PRIZREN | 31 | 7 | 24 | | |
| 4 | PEJË | 10 | 2 | 8 | | |
| 5 | GJILAN | | | | | |
| 6 | MITROVICË | 9 | 4 | 5 | | |
| 7 | FERIZAJ | 14 | 5 | 9 | | |
| 8 | GJAKOVË | 5 | 1 | 4 | | |
| | Gjithsej | **94** | **31** | **63** | **6** | |

Burimi: Raporti i KPK për vitin 2016

Sipas Raporti vjetor (2015) i Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për harmonizimin e raporteve statistikore Gjykatat gjatë vitit 2015 kanë marrë vendime për 160 persona të akuzuar në Aktet akuzuese të Prokurorëve për veprën penale të Korrupsionit. Gjykatat kanë hudhur 12 aktakuza para shqyrtimit gjyqësor; 80 persona kanë shpallur fajtor; 46 persona janë liruar dhe ndaj 22 personave është refuzuar aktakuza. Vendimet gjyqësore të kategorizuara sipas prokurorive pasqyrohen në tabelën në vazhdim (shih tabelën 7 ), ndërsa vendimet e Gjykatës sipas përqindjes pasqyrohen në Figurën në vazhdim.[131]

[131]http://kpkrks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Raporte%20Vjetore/Raporti%20Vjetor%202015%20Nr.491.2016%20%20p%C3%ABr%20Mekanizmin%20p%C3%ABrcjell%C3%ABs%20nd%C3%ABrinstitucional%20p%C3%ABr%20harmonizimin%20e%20statistikave%20p%C3%ABr%20veprat%20penale%20karakteristike.pdf, Shikuar 10.02.2019

Tabela nr.7

| | Prokuroritë | Është hudhur Aktakuza para Shqyrtimit Gjyqësor | I akuzuari është shpallur FAJTOR | I akuzuari është LIRUAR | Është REFUZUAR Aktakuza | Numri Personave për të cilët Gjykata ka marrë vendim përkitazi me Aktet akuzuese |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | PSRK | 7 | | | 5 | 12 |
| 2 | PTh. Prishtinë | | 1 | | 1 | 2 |
| 3 | PTh. Prizren | | 23 | 26 | 8 | 57 |
| 4 | PTh. Pejë | | 11 | 3 | | 14 |
| 5 | PTh. Gjilan | | 11 | 3 | | 14 |
| 6 | PTh. Mitrovicë | 4 | 5 | 1 | | 10 |
| 7 | PTh. Ferizaj | 1 | 25 | 5 | 6 | 37 |
| 8 | PTh. Gjakovë | | 4 | 8 | 2 | 14 |
| | Gjithsej | **12** | **80** | **46** | **22** | **160** |

Burim: Raporti i KPK për vitin 2015

Figura nr.1 Vendimet e gjykatës të shprehura në përqindje.




Burim: Raporti i KPK për vitin 2015

Prokurorët në vitin 2014 kanë proceduar në Gjykatë aktet akuzuese për 103 persona sipas kallëzimit penal dhe sipas llojit të veprave penale të ricilësuara gjatë procedurës për veprat penale të grupit të Korrupsionit. Gjykata lidhur me 103 aktet akuzuese të proceduara nga prokuroria ka marrë këto vendime:

- Për 5 të akuzuar (ose 4.85%) ka hudhur aktakuzën para shqyrtimit gjyqësor;
- 67 të akuzuar (ose 65.05%) i ka shpallur fajtor;
- 18 të akuzuar (ose 17.48%) janë liruar dhe
- Për 13 të akuzuar (ose 12.62%) ka refuzuar aktakuzën.[132]

[132]http://kpkrks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Raporte%20Vjetore/Raporti%20vjetor_2014_MEKANIZMI_PERCJELLES.PDF

| Vjetor 2014 | | Persona për të cilët Gjykata ka marr vendim përkitazi me Aktetakuzuese (kol.3+4+5+6) | Është hudhur Aktakuza para Shqyrtimit Gjyqësor | ose % | I akuzuari është shpallur FAJTOR | ose % | I akuzuari është LIRUAR | ose % | Për të akuzuarin është Refuzuar Aktakuza | ose % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| a | b | 2 | 3 | | 4 | | 5 | | 6 | |
| 1 | Prokuroria Speciale | 10 | | | 9 | *90,00* | | | 1 | *10,00* |
| 2 | PTh në Prishtinë | 9 | | | 7 | *77,78* | | | 2 | *22,22* |
| 3 | PTh në Prizren | 41 | 2 | *4,88* | 21 | *51,22* | 8 | *19,51* | 10 | *24,39* |
| 4 | PTh në Pejë | 17 | 1 | *5,88* | 12 | *70,59* | 4 | *23,53* | | |
| 5 | PTh në Gjilan | 4 | | | 4 | *100,00* | | | | |
| 6 | PTh në Mitrovicë | 1 | | | 1 | *100,00* | | | | |
| 7 | PTh në Ferizaj | 7 | | | 7 | *100,00* | | | | |
| 8 | PTh në Gjakovë | 14 | 2 | *14,29* | 6 | *42,86* | 6 | *42,86* | | |
| | **Gjithsej** | **103** | **5** | *4,85* | **67** | *65,05* | **18** | *17,48* | **13** | *12,62* |

Tabela 8. Burim: Raporti KPK për vitin 2014

Në vitin 2014 janë parashtruar 36 ankesa për persona ndaj vendimeve të Gjykatës, 13 ankesa për vendimin mbi dënimin(lartësinë e dënimit) 18 ankesa për arsye tjera, ndërsa 5 ankesa të prokurorve janë aprovuar nga Gjykata e Apelit[133]

[133]Po aty, faqe 58

### 5.4. Korrupsioni në Prokurori

Korrupsioni si dukuri vazhdon të sfidoj shumë hallka të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Në vitin 2013 me miratimin e Planit Strategjik dhe Planin e Veprimit për ngritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, duke përfshirë Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme, Këshilli Prokurorial I Kosovës ka caktuar këto prioritete : rritja e efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve të reja, rritja e kapaciteteve përmes trajnimeve, bashkëpunimi me institucione përkatëse, llogaridhënia dhe transparenca.

Pavarësisht  proriteteve të caktuara, rritjes së numrit të prokurorëve kohëve të fundit, sistemi prokurorial i Kosovës vazhdon të ballafaqohet me problemin e numrit të madh të lëndëve të pazgjidhura të korrupsionit, si dhe numri I madh I lëndëve të pazgjedhura të trashëguara nga vitet paraprake. Si parashtrues të kallëzimeve penale nga sfera e korrupcionit edhe më tutje mbesin organet e Policisë së Kosovës, palët e dëmtuara dhe qytetarët. Sfidë e sistemit prokurorial në lidhje me lëndët e pazgjidhura të korrupsionit janë afatet ligjore të parashkrimit të ndjekjes penale, ku shpesh për shkak të menaxhimit jo të mirë të lëndëve nga prokurorët janë të detyruar të mbyllin rastin. Kështu sipas Raportit të Institutit për Drejtësi të Kosovës rezulton se numri I lëndëve të pazgjidhura në lidhje me korrupsionin të viti 2013, 2014 dhe 2015 ka vazhduar të është i larte.[134]

[134] www //Korrupsioni-në-Kosovë-6-20.11.2015%20(1).pdf

Tabela 10. Gjendja e rasteve të korrupsionit për secilën prokurori prej hyrjes në fuqi të Planit të Veprimit më 4 nëntor 2013 deri më 30 qershor 2015.[135]

| RASTET E KORRUPSIONIT NË PROKURORITË SË KOSOVËS (04.11.2013 - 30.06.2015) | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prokurori i Shtetit | Prokurori i Shtetit | | | | | | |
| | Të pazgjidhura në fillim (04.11.2014) | Të pranuara (04.11.2013 deri më 30.06.2015) | Të zgjidhura prej 04.11.2013 deri më 30.06.2015 | Mënyra e zgjidhjes | | | Të pazgjidhura në fund (30.06.2015) |
| | | | | Hudhje | Pushim | Aktakuzë | |
| PSRK | 232 | 159 | 186 | 31 | 98 | 72 | 233 |
| Prishtinë | 777 | 562 | 366 | 85 | 84 | 197 | 1073 |
| Prizren | 175 | 162 | 264 | 72 | 78 | 114 | 68 |
| Pejë | 86 | 132 | 173 | 33 | 87 | 53 | 56 |
| Gjilan | 81 | 105 | 178 | 57 | 43 | 78 | 19 |
| Mitrovicë | 141 | 128 | 138 | 47 | 7 | 84 | 145 |
| Ferizaj | 126 | 107 | 157 | 30 | 14 | 113 | 75 |
| Gjakovë | 64 | 86 | 121 | 28 | 24 | 69 | 37 |
| Total: | 1682 | 1441 | 1598 | 383 | 435 | 780 | 1,706 |

Si rezultat i mos trajtimit të duhur të rasteve të korrupsionet në sistemin prokurorial të Kosovës do të rezultojnë me parashkrim të tyre. Fenomeni i parashkrimit mbetet jashtëzakonisht shqetësues dhe i paadresuar nga prokuroritë. Në grafikonin më poshtë janë paraqitur rastet e korrupsionit të parashkruara në të gjitha prokuroritë që përfshijnë rastet prej hyrjes në fuqi të planit të veprimit deri më 10 shtator 2015.

[135]Burimi: Instituti i Kosovës për drejtësi 2015

Figura nr.2 Rastet e parashkruara të korrupsionit[136].




Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, prokurorit të shtetit i ofron diskrecion lidhur me fillimin e hetimit apo ndjekjes së veprës penale. Prokurori mund të mos filloj ndjekjen penale nëse sipas vlerësimit të tij konstaton se nuk ka prova të mjaftueshme për të ngritur aktakuzën. Ligji nuk lejon ankesën ndaj vendimit të prokurorit në rastin e hudhjes së kallëzimit penal apo pushimit të procedurës. Kodi I procedurës penale nuk lejon padinë private e as padinë supsidiare, pasi që Kodi penal nuk parasheh asnjë vepër penale e cila ndiqet sipas padisë penale. Një përkufizim I till I Kodit penal dhe procedurës penale lë hapësirë për shfaqjen e korrupsionit në sistemin prokurorial të Kosovës.

Sipas hulumtimeve të bëra nga Instituti i Kosovës për Drejtësi[137] gjatë procesit të monitorimit të rasteve të korrupsionit ka gjetur se numri më I madh I rasteve të raportua qoftë në polici apo në prokurori I takojnë fazës parapenale apo fazës së hetimit në procedurën penale mbyllen nga prokurori pa kontroll gjyqësore. Ndaj vendimit të prokurorit të shtetit, nuk lejohet ankesë qoftë nga ana e parashtruesit të kallëzimit penal apo të dëmtuarit nga vepra penale[138]

[136]Burimi: Raporti i IDK, 2015

[137] https://kli-ks.org/lufte-persekutim-apo-amnisti-ne-emer-te-luftes-kunder-korrupsionit/
[138]Po aty.

| PP - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të vjetra sipas prokurorive për periudhën 4 nëntor 2013 - 30 qershor 2015 | *Totali i personave të pazgjidhura më 4 nëntor 2013* | *Përqindja e përmbushjes së Planit të Veprimit* | Total | Hudhje | | Pushim | | Aktakuzë UN | | Aktakuza të drejtpërdrejta | | Aktakuza pas hetimeve | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Persona | Përqindja | Persona | Përqindja | Persona | Përqindja | Persona | Përqindja | Persona | Përqindja |
| **PSRK** | *232* | *53%* | **123** | 10 | 8% | 84 | 68% | | | | | 29 | 23% |
| **Prishtinë** | *777* | *28%* | **218** | 68 | 31% | 55 | 25% | | | 9 | 4% | 86 | 39% |
| **Prizren** | *175* | *90%* | **159** | 38 | 23% | 50 | 31% | | | 3 | 1% | 68 | 42% |
| **Pejë** | *86* | *100%* | **92** | 6 | 6% | 64 | 69% | | | | | 22 | 23% |
| **Gjilan** | *81* | *100%* | **81** | 18 | 22% | 27 | 33% | | | 20 | 24% | 16 | 19% |
| **Mitrovicë** | *141* | *80%* | **114** | 46 | 40% | 7 | 6% | | | 10 | 8% | 51 | 44% |
| **Ferizaj** | *126* | *75%* | **95** | 13 | 13% | 6 | 6% | 35 | 37% | 2 | 2% | 39 | 41% |
| **Gjakovë** | *64* | *85%* | **55** | 7 | 12% | 5 | 9% | | | | | 43 | 78% |
| Total | *1,632* | *57%* | **937** | **206** | **21%** | **298** | **31%** | **35** | **3%** | **44** | **4%** | **354** | **37%** |

Tabela11. Mënyra e zgjidhjes së rasteve sipas prokurorive për periudhën 4 nëntor 2013 – 30 qershor 2015

Gjatë vitit 2015, në procedurën parapenale nga 550 janë mbyllur 151 raste, në vitin 2016 nga 974 janë mbyllur 274, ndërsa në vitin 2017 nga 1059 raste janë mbyllur 464 raste. Respektivisht nga viti 2015 deri në fund të vitit 2017, prokuroria dhe policia ka mbyllur 889 raste ndaj 1553 personave. Shih tabelën 12.

| Rastet e korrupsionit PPN - Prokurori i Shtetit | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Viti** | Gjithsej raste | | Raste të mbyllura | | Raste të mbetura të pambyllura | |
| | R | P | R | P | R | P |
| **2015** | 550 | 1187 | 151 | 336 | 399 | 851 |
| **2016** | 974 | 1658 | 274 | 457 | 700 | 1201 |
| **2017** | 1059 | 1844 | 464 | 760 | 595 | 1084 |
| **Total** | | | 889 | 1553 | | |

Tabela 12. Rastet e e mbyllura për vitin 2015-2017 të korrupsionit në fazën parapenale[139].

[139]Burimi: IDK-se, 2015

Gjendje përafërsisht e njëjtë paraqitet edhe tek hudhja e kallëzimeve penale dhe pushimi i hetimeve nga ana e Prokurorit të Shtetit. Nga viti 2015 deri në fund të vitit 2017, Prokurori i Shtetit ka mbyllur rastet ndaj 1794 personave që janë raportuar lidhur me dyshimet për vepra penale të korrupsionit. Ndaj 1006 personave, kallëzimet penale janë hudhur kurse ndaj 788 personave janë pushuar hetimet.[140]

| Rastet e korrupsionit PP - Prokurori i Shtetit | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Viti** | Persona te zgjidhura | Hudhje e Kallëzimit penal | Pushimi hetimit | Totali i rasteve të mbyllura | Aktakuza | Mënyrë tjetër |
| **2015** | 919 | 191 | 281 | 472 | 443 | 4 |
| **2016** | 1164 | 480 | 257 | 737 | 426 | 1 |
| **2017** | 902 | 335 | 250 | 585 | 314 | 3 |
| **Total** | 2985 | 1006 | 788 | 1794 | 1183 | 8 |

Tabela 13. Hudhja dhe pushimi i kallëzimeve penale nga Prokuroria e shtetit.[141]

Sipas Raportit Vjetor (2017) të Këshillit Prokurorial të Kosovës- i Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për harmonizimin e raporteve statistikore, që rezulton se prokuroritë në vitin 2017 kishin në punë gjithsej 793 kallëzime penale me 1765 persona për veprat penale të Korrupsionit. Gjatë vitit 2017 Prokuroritë kanë proceduar (kryer/zgjidhur) 412 kallëzime penale ndaj 902 personave, ndërsa kanë dërguar në kompetencë 80 kallëzime penale me 148 persona dhe në fund të vitit kanë mbetur të paprocedura (pakryera/pazgjidhura) 301 kallëzime penale me 715 persona për veprat penale të Korrupsionit .Shih tabelën.

Tabela 14. Kallëzimet penale të korrupsionit për vitin 2017.

[140] kli-ks.org/wp-content/uploads/2015/11/Korrupsioni-në-Kosovë-6-20.11.2015.pdf, shikuar 11.02.2019

[141] Burim: Raporti i IDK -2017

| PROKURORIA: | | Rastet e bartura nga periudha paraprake (01 janar 2017) A | | Rastet e reja, të pranuara gjatë vitit 2017 B | | Gjithsej raste në vitin 2017 C (a+b) | | Raste të proceduara *(kryera/zgjidhura)* gjatë vitit 2017 Ç | | Rastet e dërguara në kompetencë D | | Raste të mbetura të paprocedu ara, në fund të vitit 2017 DH (C-Ç-D) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *R* | *P* | *R* | *P* | *R* | *P* | *R* | *P* | | | *R* | *P* |
| 1 | SPECIALE | 30 | 130 | 4 | 17 | 34 | 147 | 14 | 55 | 1 | 4 | 19 | 88 |
| 2 | PRISHTINË | 209 | 622 | 208 | 319 | 417 | 941 | 210 | 476 | 70 | 113 | 137 | 352 |
| 3 | PRIZREN | 4 | 9 | 13 | 25 | 17 | 34 | 11 | 22 | 1 | 2 | 5 | 10 |
| 4 | PEJË | 17 | 25 | 38 | 57 | 55 | 82 | 45 | 68 | 1 | 3 | 9 | 11 |
| 5 | GJILAN | 17 | 43 | 47 | 80 | 64 | 123 | 48 | 80 | 4 | 18 | 12 | 25 |
| 6 | MITROVICË | 79 | 190 | 35 | 51 | 114 | 241 | 29 | 82 | 3 | 8 | 82 | 151 |
| 7 | FERIZAJ | 17 | 48 | 26 | 75 | 43 | 123 | 21 | 66 | | | 22 | 57 |
| 8 | GJAKOVË | 18 | 30 | 31 | 44 | 49 | 74 | 34 | 53 | | | 15 | 21 |
| | *GJITHSEJ:* | **391** | **1097** | **402** | **668** | **793** | **1765** | **412** | **902** | **80** | **148** | **301** | **715** |

Tabela 15. Ushtrimi I kallëzimeve penale të korrupsionit nga institucionet.

Burimi:Raporti I KPK-2017

Gjatë vitit 2017 subjektet e caktuara institucionale kanë parashtuar nëpër prokurori 402 kallëzime penale me 668 persona, për veprat penale të grupit të Korrupsionit. Shih tabelën.

| SUBJEKTET PARASHTRUESE | | SPECIALE | | PRISHTINË | | PRIZREN | | PEJË | | GJILAN | | MITROVICË | | FERIZAJ | | GJAKOVË | | GJITHSEJ: | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | R | P | R | P | R | P | R | P | R | P | R | P | R | P | R | P | R | P |
| 1 | AKK | | | 81 | 87 | | | | | | | 1 | 1 | | | 6 | 6 | 88 | 94 |
| 2 | AKP | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 3 | APJ | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 4 | ATK | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 5 | DG | | | | | | | | | | | 1 | 2 | | | | | 1 | 2 |
| 6 | E | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 7 | ID | | | 42 | 75 | 2 | 4 | | | 18 | 32 | | | 3 | 4 | 8 | 17 | 73 | 132 |
| 8 | IPK | | | 3 | 3 | | | | | 1 | 4 | 1 | 2 | 2 | 2 | 1 | 2 | 8 | 13 |
| 9 | EPK | 2 | 11 | 23 | 46 | | | 8 | 12 | 11 | 18 | 12 | 16 | 2 | 10 | | | 58 | 113 |
| 10 | NJIF | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 11 | OAK | | | 2 | 3 | | | 1 | 3 | | | | | | | | | 3 | 6 |
| 12 | PK | 1 | 2 | 44 | 80 | 11 | 21 | 21 | 27 | 11 | 15 | 16 | 25 | 14 | 54 | 13 | 14 | 131 | 238 |
| 13 | PV | | | 4 | 7 | | | | | | | | | 2 | 2 | 1 | 2 | 7 | 11 |
| 14 | Q | 1 | 4 | 8 | 16 | | | 7 | 14 | 6 | 11 | 4 | 5 | | | 2 | 3 | 28 | 53 |
| 15 | TP | | | 1 | 2 | | | 1 | 1 | | | | | | | | | 2 | 3 |
| 16 | AGJ | | | | | | | | | | | | | 3 | 3 | | | 3 | 3 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***AKK*** | *Agjencioni Kundër Korrupsionit* | ***OAK*** | *Organi i administratës komunale* | ***E*** | *EULEX-i* | ***EPK*** | *E pranuar në kompetencë* |
| ***AKP*** | *Agjencioni Kosovar i Pronës* | ***TP*** | *Titullari i pronës - OP të dëmtuar* | ***PK*** | *Policia e Kosovës* | ***APJ*** | *Autoriteti Pujor i Kosovës* |
| ***ATK*** | *Administrata Tatimore Kosovës* | ***IPK*** | *Inspektorati Policor i Kosovës* | ***D*** | *Dogana e Kosovës* | ***PV*** | *Prokurori me vetiniciativë* |
| ***Q*** | *Të tjera (qytetari,)* | ***NJIF*** | *Njësia për Inteligjencë Financiare* | ***ID*** | *I Dëmtuari* | ***AGJ*** | *Auditori Gjeneral* |

Tabela 15. Ushtrimi I kallëzimeve penale të korrupsionit nga institucionet.

Burimi: KPK-2017

**Gjatë vitit 2017 Prokuroritë kanë proceduar 902 raste për persona, të përfshirë në veprat penale të grupit të Korrupsionit [142]:**

- Për 335 persona janë hudhur kallëzimet penale apo 37.14%; - Për 3 persona është bashkuar procedura apo 0.33%;

- Për 250 persona janë pushuar hetimet apo 27.72%;

- Për 2 person është ngritur aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor apo 0.22%;

- Për 30 persona janë ngritur aktakuza të drejtpërdrejta apo 3.33%; -

Për 282 persona janë ngritur aktakuza pas zhvillimit të hetimeve apo 31.26%.

| | PROKURORIA | Numri personave | Hudhje e Kallëzimit penal | Mënyrë tjetër (Bashkim i procedurës) | Pushimi hetimit | Aktakuzë për dhënien e urdhërit ndëshkimor | Aktakuzë e drejtpërdrejtë | Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SPECIALE | **55** | 2 | | 35 | | | 18 |
| 2 | PRISHTINË | **476** | 232 | | 122 | 1 | 5 | 116 |
| 3 | PRIZREN | **22** | 1 | 1 | 12 | | 2 | 6 |
| 4 | PEJË | **68** | 33 | | 10 | | 10 | 15 |
| 5 | GJILAN | **80** | 30 | | 17 | | | 33 |
| 6 | MTROVICË | **82** | 15 | | 7 | | 5 | 55 |
| 7 | FERIZAJ | **66** | 2 | 2 | 33 | 1 | 6 | 22 |
| 8 | GJAKOVË | **53** | 20 | | 14 | | 2 | 17 |
| | GJITHSEJ: | **902** | **335** | **3** | **250** | **2** | **30** | **282** |

Tabela 16. Vepra penale e korrupsionit sipas numrit të personave.

Burimi: Raporti i KPK 2017

[142] http://www.kpkrks.org/assets/cms/uploads/files/publikimet/7%20RAPORTI%20VJETOR%20%20I%20MEKANIZMIT%20PERCJELLES%20NDERINSTITUCIONAL%202017.pdf shikuar 12.02.2019

Nëse këto paraqiten në përqindje atëherë rezulton se 27.72 % kemi pushim të procedurës, 37.14 % kemi hudhje të kallëzimit penal dje 34.81 % kemi ngritje të aktakuzës. Shih figurën nr.3




Figura nr.3 Paraqitja në mënurë grafike e ecurisë së veprës së korupsionit në përqindje.

Burimi: Raporti I KPK 2017

Gjatë vitit 2017 Prokuroritë kanë ndërmarrë 828 veprime/vendime për zgjidhjen e rasteve për persona, të përfshirë në kallëzime penale për veprën penale të Korrupsionit, të cilat sipas llojit të veprim/vendimit rezultojnë , si në vazhdim[143]:

- 24 urdhëresa për ndalim apo 2.90%; - 346 kërkesa për informata shtesë apo 41.79%; - 5 urdhëresë për masa të fshehta apo 0.60%;

- 402 aktvendime për fillim të hetimeve apo 48.55%; - 24 kërkesa për caktimin e paraburgimit apo 2.905 % (Gjykatat kanë aprovuar 3 kërkesa)

- 5 ankesa ndaj vendimit të Gjykatës për refuzimin e kërkesës për paraburgim apo 0.60%;

- 11 aktvendime për zgjerimin e hetimeve apo 1.33%;

[143]http://www.kpkrks.org/assets/cms/uploads/files/publikimet/7%20RAPORTI%20VJETOR%20%20I%20MEKANIZMIT%20PERCJELLES%20NDERINSTITUCIONAL%202017.pdf , shikuar 12.02.2019

- 8 pezullime të procedurës apo 0.97%;

- 3 vendime për rifillimin e procedurës pas pezullimit të hetimeve apo 0.36%

Nga 24 kërkesat e prokurorive për caktimin e paraburgimit gjatë vitit 2017 Gjykatat kanë aprovuar 3 kërkesa apo 12.50%

Figura 4. Paraqitja grafike e vendimeve gjyqësore mbi veprimet e prokurorëve.

Burimi: Raporti i KPK 2017

## KAPITULLI VI

# 6. PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KORRUPSIONIT NË KOSOVË

Sipas Raportit të Progresit të Komisionit të BE-së te vitit 2013 për Kosovën, ndërhyrjet politike në punën e institucioneve gjyqësore mbetet një shqetësim mjaftë serioz.[144] Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit është detyrë parësore e saj si dhe e shteteve të tjera të rajonit, të cilat ende ndodhen në fazën e tranzicionit.

Përqindja e madhe e popullsisë në moshë të re,[145] papunësia  që arrin rreth 45%, si dhe "mbyllja hermetike" e kufijve të Bashkimit Evropian për shkak të mosliberalizimit të vizave, ndikojnë me të madhe në paraqitjen e kriminalitetit në Kosovë.

Për parandalimin dhe për luftimin e suksesshëm të korrupsionit në Kosovë, nevojitet që institucionet përkatëse t'i posedojnë të gjitha kapacitetet kadrovike, teknike dhe teknologjike. Një rol të veçantë në parandalimin dhe në luftimin e korrupsionit në Kosovë e kanë:

- Legjislacioni;
- Niveli profesional i kuadrit udhëheqës në lëmin e sistemit juridik;
- Masat teknike dhe teknologjike të vëzhgimit;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar, etj.

### 6.1.1. Legjislacioni

Një rol të rëndësishëm në luftën për parandalimin e korrupsionit e kanë institucionet shtetërore, siç janë policia, shërbimi i zbulimit, gjyqësia, prokuroria, etj. të cilat duhet t'i kryejnë detyrimet që i kanë në përputhje me ligjin dhe kushtetutën.

[144] Këshilli Evropian, Raporti i Progresit  pervitin 2013, fq 12.

[145] Sipas të dhënave zyrtare të Entit të statistikës të Kosovës si dhe të shoqërisë civile, papunësia në Kosovë arrin rreth 45%; 50% e popullsisë janë më të rinj se 25% vjeç, ndërsa 70% e popullsisë janë më të rinj se 35 vjeç.

Duhet theksuar se luftimi dhe parandalimi i korrupsionit në Kosovë është i lidhur ngushtësisht me sistemin juridik, si një ndër hallkat më të rëndësishmet dhe më specifiket në këtë fushë. Për këtë arsye, hapin e parë në luftën kundër korrupsionit duhet bërë në sistemin gjyqësor të Kosovës, për arsye se ky sistem nuk është imun ndaj formave të caktuara të kriminalitetit, posaçërisht ndaj korrupsionit që për fat të keq është mjaft i përhapur.

Kjo çështje e rëndësishme është trajtuar në aktet juridike si:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- Ligji për Procedurë Penale i Republikës së Kosovës;
- Ligji për mbrojtjen e informuesve;
- Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale;
- Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë;[146]
- Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;[147]
- Ligji për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale[148]
- Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Ligji për prokurorinë shtetërore;
- Ligji për gjykatat;
- Ligji për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar;
- Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit;
- Ligji për prokurorinë speciale të Republikës së Kosovës;
- Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë;
- Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave;
- Ligji kundër korrupsionit;

[146] Ky ligj është miratuar më 02.03.2010 dhe është botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës", nr. 66, Prishtinë, 2010.

[147] Shiko: Ligji Nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 37, Prishtinë, 2008.

[148] Shiko: Ligji Nr. 04/L-30, për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 16, Prishtinë, 2011. Ky ligj ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

- Ligji për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe të financimit të terrorizmit,[149] etj.

Parashikimi në dispozitat penale të krimeve të ndryshme që mund të klasifikohen në termin "korrupsion" është edhe një masë e mirë parandaluese për kryerjen e krimeve të tilla. Zbatimi i legjislacionit ekzistues si dhe nxjerrja e normave të reja antikorrupsion ndodhet para një sfide të madhe në çdo shtet. Kjo rrethanë mund të konsiderohet si pengesë e luftimit të korrupsionit. Por, si faktor me ndikim të fuqishëm në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie, është kryerja e funksioneve të plota dhe të drejta të mekanizmave shtetëror dhe administrative të shtetit. Ligji dhe dënimi penal luajnë rol të rëndësishëm parandalues jo vetëm tek subjekti konkret, por edhe tek të tretët që bëhen bartës të gjendjeve të tilla.

Korrupsioni është një problem që ekziston në të gjitha vendet, prandaj për këtë arsye të gjitha vendet duhet që ti forcojnë dhe përmirësojnë politikat, strategjitë, institucionet, kuadrin ligjor dhe përpjekjet konkrete të qëndrueshme për ta parandaluar dhe për ta luftuar atë.[150]

Zgjidhja dhe tejkalimi i problemeve të paraqitura si pengesë në zbulimin dhe luftimit e korrupsionit në veçanti arrihet me trajtim kompleks shtetëror dhe shoqëror duke përfshirë:[151]

- Analizën e gjendjes ekzistuese të kësaj dukurie;
- Detyrimet e veprimtarisë politike dhe synimeve të përgjithshme në këtë fushë;
- Masat specifike kundër korrupsionit;
- Formimi i institucioneve të specializuara anti-korrupsion;
- Bashkëpunimi i plotë i organeve të zbulimit, hetimit dhe gjykimit;
- Rregullimi legjislativ i autorizimeve të posaçme të organeve dhe organizatave të caktuara në zbulimin dhe luftimin e korrupsionit;
- Zbatimi i efektshëm i ligjit dhe masave në kontrollin e institucioneve;
- Preventimi i programuar sistemor i korrupsionit;

[149] Shiko: Ligji Nr. 03/L-196 për parandalimin e larjes së parave dhe të financimit të terrorzimit, botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës", nr. 85, Prishtinë, 2010.
[150] Edukimi kundër Korrupsionit, Manual për Mësuesit, Tiranë, 2012
[151] Latifi,V., "Kriminalistika"- ZbulimidhetëProvuarit e Krimit, Prishtinë, 2014, fq. 285

- Qeverisja e mirë, administrimi dhe ligjshmëria e plotë në kryerjen e funksionit të organeve të drejtësisë, policisë, doganave, inspekcioneve, organeve qeveritare të komunave;
- Qasja shkencore e profesionale e zbulimit dhe luftimit të korrupsionit, edukimi i opinionit dhe mobilizimi i mediave në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Me qëllim të luftimit të korrupsionit si dukuri negative dhe e rrezikshme në shoqëri tonë, institucionet e vendit tone kanë hartuar ligje të veçanta si dhe akte juridike ndërkombëtare, të cilat kanë për qëllim parandalimin e kësaj dukurie.

- **Ligji Kundër Korrupsionit**[152] - Është miratuar në vitin 2004 dhe ka hyrë në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës, nënshkrimit të Kryetarit të Kuvendit dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe përmban gjithsej 53 nene. Me ligjin kundër korrupsionit është themeluar edhe Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit, si organ i pavarur, qëllimi i të cilës është luftimi dhe parandalimi i korrupsionit në Kosovë.

- **Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit**[153] - Ka hyrë në fuqi në vitin 2009 dhe përmban 26 nene. Ky ligj jep përkufizimin për agjencinë, komisionin, korrupsionin, personin zyrtar dhe personin përgjegjës, përcakton kompetencat, planin e veprimit, procedurat si dhe raportimet e agjencisë në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

- **Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik**[154]

[152] Ligji Nr. 2004/34 KundërKorrupsionit, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nr. 10, Prishtinë, 2017
[153] Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit Nr. 03/L-159
[154] Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr. 06/L-011

Është miratuar në vitin 2018 dhe përmban 26 nene.Ky ligj rregullon procedurat për detyrimet e raportimit, masat për parandalimin, identifikimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik dhe private të zyrtarit gjatë dhe pas ushtrimit të detyrës publike si dhe detyrat e përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse. [155]

- **Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë**[156]

  Ky ligj është miratuar në vitin 2011 dhe përmban 20 nene. Sipas nenit 1, qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i detyrimeve të zyrtarëve të lartë publikë për ta deklaruar pasurinë, të hyrat dhe prejardhjen, detyrën e Agjencisë për ta kontrolluar deklarimin dhe kontrollin e pasurisë si dhe detyrimet e të gjithë personave zyrtarë për të deklaruar dhuratat dhe prejardhjen e tyre. Deklarimi i pasurisë nga zyrtarët e lartë i paraqitet Agjencisë nga vetë zyrtari i lartë publik apo nga personat e autorizuar nga ai dhe këto deklarime mund të jenë:[157]

  1. Deklarimi me marrjen e detyrës;
  2. Deklarimi i rregullt vjetor;
  3. Deklarimi sipas kërkesë së Agjencisë;
  4. Deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni;
  5. Deklarimi i dhuratave për personat zyrtarë publik;

[155] Po aty, neni 2
[156] Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050
[157] Po aty, neni 6

Sipas nenit 12 pika 7 dhe 8, në ato raste kur agjencia konstaton se personi zyrtar ka bërë shkelje, informon institucionin ku ai punon dhe institucioni duhet që të ndërrmarë ndaj tij masat disiplinore dhe më pas ka për detyrë që ta njoftoj edhe agjencinë në lidhje me masat disiplinore që ka shqiptuar ndaj atij personi zyrtar. Ndërsa kur agjencia dyshon se ekziston vepër penale, pas hetimeve që kryen kallëzimin penal ia paraqet prokurorisë kompetente e cila merret më tutje me rastin.

### 6.1.2. Roli i Agjencisë Kundër Korrupsionit

Agjencia kundër korrupsionit është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë.[158]

Agjencia kundër Korrupsionit sipas nenit 5 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit ka këto kompetenca:[159]

- Inicion dhe zhvillon procedurën e zbulimit dhe hetimit paraprak të korrupsionit dhe përcjellë kallëzime penale për rastet e dyshimit për korrupsion në prokurorinë publike kompetente, nëse për të njëjtin rast nuk zhvillohet procedurë penale;
- Bashkëpunon me institucionet vendore, të huaja dhe ndërkombëtare që kanë për mision parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
- Në bashkëpunim me Komisionin, Qeverinë, institucionet e tjera dhe me organizatat joqeveritare, harton strategjinë kundër korrupsionit dhe planin e veprimit;
- monitoron dhe mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë kundër Korrupsionit dhe planin e veprimit;
- mbikëqyr dhe parandalon rastet e konfliktit të interesit dhe ndërmerr masat e parapara me ligj të veçantë;

[158] Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit Nr. 03/L-159, neni 3
[159] Po aty, neni 5

- mbikëqyr pasuritë e zyrtarëve të lartë publik dhe personave të tjerë, siç parashihet me ligj të veçantë;
- mbikëqyr pranimin e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmerr masat e parapara me ligj;
- bashkëpunon me autoritetet publike kompetente për hartimin, harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
- përfaqësohet në takime ndërkombëtare që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe merr pjesë në procesin e negociatave për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale apo miratimin e instrumenteve ligjore ndërkombëtare kundër korrupsionit;
- bashkëpunon me institucionet kompetente të Republikës së Kosovës për realizimin e detyrimeve që dalin nga aktet ndërkombëtare kundër korrupsionit dhe ofron rekomandime për përmbushjen e detyrimeve të tyre;
- merr pjesë dhe ofron këshilla për hartimin e kodit të etikës në sektorin publik dhe privat;
- ofron opinione në lidhje me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare;
- ofron sqarime në lidhje me mënyrën e deklarimit të pasurisë dhe çështje tjera nga fushëveprimi i Agjencisë;
- mbledh, analizon dhe publikon të dhënat statistikore ose të dhëna të tjera në lidhje me gjendjen e korrupsionit në Kosovë;
- bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile për ngritjen e vetëdijes së publikut lidhur me korrupsionin;
- i raporton Kuvendit një herë në vit dhe Komisionit çdo gjashtë (6) muaj për punën e Agjencisë. Komisioni mund të kërkojë raporte edhe më të shpeshta nga Agjencia.
- përgatit dhe propozon buxhetin vjetor të Agjencisë.

**Strategjia e punës së AKK-së mbështetet në tre shtylla kryesore të cilat ndihmojnë realizimin e detyrave dhe përgjegjësive që rrjedhin nga Ligji kundër Korrupsionit si dhe në arritjen e:**[160]

- Zbatimit të ligjit ku përfshihet përcjellja e informatave për korrupsion në Prokurorinë Publike të Kosovës si dhe hartimi i ligjeve te reja për plotësimin e kornizës ligjore ne këtë fushe;

- Parandalimit ose eliminimit të shkaqeve të korrupsionit përmes kryerjes se deklarimit te pasurisë se zyrtareve te larte, parandalimit te konfliktit te interesave dhe regjistrimit te dhuratave ne organet qendrore;

- Edukimit të administratës publike dhe qytetarëve mbi kornizën ligjore dhe mekanizmat aktuale anti-korrupsion, si dhe ngritjen profesionale të stafit.

Model më përkatës për luftimin e korrupsionit dhe llojeve tjera te kriminalitetit mund të jetë ai anglez. Në vitin 1995 Anglia e miratoi "Aktin për përfitimet nga kriminaliteti" dhe sipas këtij ligji, po qe se ndaj një subjekti kriminal do të zhvillohej procedurë gjyqësore dhe po qe se ai do të shpallej fajtor për dy aktakuza, prej të cilave të paktën njëra do të paraqiste krim të rëndë ekonomik, gjykata ka të drejtë dhe për detyrë ta përcaktojë pasurinë që e ka fituar i akuzuari në gjashtë vitet e fundit, duke kërkuar prej tij të japë sqarime se kur, si dhe ku e ka fituar pasurinë.[161] Masa të tilla mbase do të duhej të zbatonin edhe organet e pushtetit në Kosovë, për arsye se nga gjendja ekzistuese në Kosovë mund të konstatohet se kemi të bëjmë me një "shoqëri kriminale recidiviste". Nga sa më sipër del se "është momenti i fundit të

[160] https://akk-ks.org/agjencia/43/strategjia/43
[161] Bejko, Sh., Krimi i organizuar dhe disa aspekte të tij, revista "E drejta", Prishtinë, 2002, fq. 147.

reagohet shpejt, të merren masa përkatëse dhe të krijohen kushte të domosdoshme në mënyrë që të veprojë shteti ligjor dhe që askush të mos jetë mbi ligjin".[162]

Nga kjo që u tha më lart del se pa një legjislacion përkatës dhe bashkëkohor nuk mund të luftohet me sukses kriminaliteti në përgjithësi, e sidomos korrupsioni që çdo ditë e më tepër i merr karakteristikat e një lloj kriminaliteti "sui generis".

### 6.1.3. Niveli profesional i kuadrit udhëheqës në lëmin e sistemit juridik

Sistemi gjyqësor dhe ai i prokurorisë në Kosovë has në kritika lidhur me zgjedhjen e kuadrit udhëheqës, të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të cilët, përkundër faktit se, për të qenë në pozita të tilla, nuk i plotësojnë kushtet themelore të parashikuara me ligj, megjithëkëtë emërohen për gjyqtarë dhe prokurorë.[163]

Shkollimi dhe specializimi i kuadrit ka një rëndësi të veçantë për sistemin juridik dhe me të duhet të përfshihen: gjyqtarët, prokurorët, policët, punëtorët e shërbimit të inteligjencës, etj. Nuk mund të paramendohet një luftë efektive kundër kriminalitetit në përgjithësi, e sidomos kundër formave të ndryshme të korrupsionit pa shkollimin dhe specializimin përkatës të këtij kuadri.

Sot, teknika dhe taktika e luftimit të kriminalitetit ndryshon paralelisht me ndryshimin e teknikave dhe të taktikave që zbatohen nga kryerësit e krimeve. Një specializim i tillë i kuadrit udhëheqës, për parandalimin dhe luftimin efektiv të formave të ndryshme të korrupsionit është

[162] Halili, R., Disa veçori kriminologjike të kriminalitetit ekonomik në shoqërinë bashkëkohore, Revista "E drejta", Prishtinë, 2002, fq. 17.

[163] Në gjykatat e Kosovës për gjyqtarë janë zgjedhur edhe personat emrat e të cilëve në masmediume paraprakisht janë përmendur për marrje të ryshfetit, abuzime seksuale, joprofesionalizëm, për qëndrime të njëanshme, pandershmëri, përfshirje në projekte të ndryshme politike dhe ekonomike si dhe në grupe të tjera interesi.

më se i nevojshëm. Për këtë arsye nevojitet që kuadri udhëheqës vazhdimisht të aftësohet për luftimin e korrupsionit në vend, duke përfshirë edhe atë ndërkombëtar.[164]

Harmonizimi i legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar që do të bënte të mundur "heqjen e kufijve shtetërorë" për të kryer hetime dhe për të mbledhur prova, është një prej objektivave të politikës bashkëkohore kundër korrupsionit gjegjësisht kriminalitetit në përgjithësi.

Në Kosovë ekzistojnë shumë organe për luftimin e korrupsionit, duke filluar nga Policia e Kosovës, Shërbimi i Inteligjencës Financiare e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Agjencia Kundër Korrupsionit, etj. Por, kjo çështje ka të bëjë me cilësinë e drejtimit të këtyre institucioneve, me ç'rast në vend të parë ndodhet aspekti profesional dhe guximi intelektual për t'u ballafaquar me forma të ndryshme të korrupsionit dhe krimit në Kosovë.

### 6.1.4. Masat sekrete dhe ato teknike për hetim dhe syrvejim

Një prej formave më karakteristike të aktivitetit të grupeve kriminale është *konspiracioni.* Duke u nisur nga parimi se "*kriminaliteti gjithmonë është një hap para ligjit*", është më se e domosdoshme të aplikohen masa teknike sekrete të hetimit, duke përfshirë sidomos: përgjimin e telefonave,[165] kontrollimin e korrespondencës etj. por pa u cenuar privatësia e garantuar me ligj. Përkundër kësaj, në praktikë me të madhe bëhen keqpërdorime me metoda të tilla të cilat në shumë raste e cenojnë jetën private të personave që janë nën hetim, si pasojë e mospërkufizimit "të vijës së kuqe" ndërmjet jetës private dhe asaj publike.

Zhvillimi tekniko-teknologjik në lëmin e telekomunikacioneve u mundëson subjekteve që luftojnë korrupsionin dhe kriminalitetit në përgjithësi, por edhe atyre që organizojnë dhe që kryejnë vepra kriminale, të pajisen dhe të përdorin mjete tejet të sofistikuara.

Për parandalimin dhe për luftimin efektiv të korrupsionit dhe kriminalitetit në përgjithësi, me Ligjin për Procedurë Penale të Republikës së Kosovës, në pjesën që ka të bëjë me procedurën e marrjes në pyetje parashikohen ndryshime të caktuara, përkatësisht masa sekrete që mund të ndërmerren nga gjyqtari në procedurën paraprake apo nga prokurori publik, siç janë:

- Fotografimi i fshehtë ose vëzhgimi me kamerë i vendeve publike;
- Monitorimi i fshehtë i bisedave në vende publike;
- Hetimi i fshehtë;
- Përgjimi dhe regjistrimi i bisedave telefonike;
- Kontrollimi i dërgesave postare;
- Përgjimi i komunikimeve në rrjetin kompjuterik;
- Dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare;
- Simulimi i blerjes së ndonjë sendi;
- Simulimi i ndonjë vepre korrupsioni;
- Zbulimi i të dhënave financiare, etj.[166]

### 6.1.5. Bashkëpunimi ndërkombëtarë

Për ta shkatërruar krimin e organizuar ndërkombëtar është më se e domosdoshme që institucionet kompetente të shteteve të bashkëpunojnë ndër vete, veçanërisht në fushën e shkëmbimit të informatave që paraqesin rëndësi për parandalimin e korrupsionit dhe për luftimin e kriminalitetit në përgjithësi.

Në vitin 2000, në Palermo të Italisë u nënshkrua Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, e cila ndryshe quhet edhe *"Konventa e Palermos"*. Në këtë konventë bashkësia ndërkombëtare tregoi një vullnet të madh politik që t'i përgjigjet

kësaj sfide globale. Po qe se kriminaliteti i kapërcen kufijtë, është i domosdoshëm zbatimi i së drejtës.

Studime të ndryshme tregojnë se në lëmin e bashkëpunimit ndërkombëtar për luftimin e korrupsionit ende mbizotëron një "pasivitet i heshtur", sidomos në disa shtete të cilat akoma ndodhen në fazën e tranzicionit. Në anën tjetër, për të parandaluar dhe për të luftuar korrupsionin duhet të vlerësohet pozitivisht bashkëpunimi i shteteve të ndryshme demokratike me disa organizata ndërkombëtare siç janë Interpoli dhe Europoli.

Bashkëpunimi policor me Interpolin dhe me Europolin, por edhe me organizatat e tjera rajonale dhe ndërkombëtare, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me rrjetet ndërkombëtare të nëpunësve të policisë duhet të zhvillohet edhe më tutje në funksion të rritjes së efikasitetit të aktiviteteve të policive kombëtare dhe rajonale duke përfshirë edhe bashkëpunimin global në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi, e posaçërisht edhe kundër korrupsionit.[167]

Kosova e miratoi Strategjinë kombëtare për luftimin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar, në mënyrë që të plotësohen disa kritere të domosdoshme për t'u integruar në Bashkimin Evropian. Format e reja të kriminalitetit theksojnë nevojën për një politikë kombëtare të veçantë që në thelb nënkupton studimin dhe implementimin e akteve ndërkombëtare për luftimin e korrupsionit.

Institucionet e Republikës së Kosovës duhet t'i shtojnë përpjekjet për të zhvilluar një bashkëpunim ndërkombëtar sa më efektiv në sferën e shkëmbimit të informatave të shërbimeve të inteligjencës për parandalimin dhe për luftimin e të gjitha formave të korrupsionit dhe të krimit të organizuar. Intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar duhet t'i ketë parasysh edhe synimet e institucioneve të Republikës së Kosovës për t'u anëtarësuar në organizatat ndërkombëtare relevante dhe për të qenë pjesë aktive e përpjekjeve dhe e angazhimeve ndërkombëtare për parandalimin dhe për luftimin e kriminalitetit. Zhvillimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe bashkërendimi i veprimeve për të luftuar korrupsionin dhe kriminalitetin në përgjithësi, përfshin disa masa që kanë për qëllim:

[167] Milovanoviq. Z., *Организираниот криминал – дали ќе постои?,* Tetovë, 2009, fq. 127-135

- Forcimin e bashkëpunimit dhe të bashkërendimit rajonal,
- Forcimin e bashkëpunimit dhe të bashkërendimit ndërkombëtar.

Për të parandaluar dhe për të luftuar krimin e organizuar duhet të ndërmerren masa konkrete për zhvillimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me rritjen e efikasitetit të institucioneve përkatëse si dhe me ndërgjegjësimin e mbarë shoqërisë, lidhur me pasojat që shkaktohen nga korrupsioni.

Njëzet vite pas mbarimit të luftës, Kosova vazhdon të ketë një nivel të lartë të korrupsionit dhe të dukurive të tjera negative, ku "numri i errët" dhe *"numri i përhimë"* ndodhen në një shkallë tejet të lartë. Zhvillimi ekonomik i pamjaftueshëm, përqindja e lartë e papunësisë, pasojat e luftës, përmasat shqetësuese të varfërisë, kushtet e rënda sociale, gjendja politike jo mjaft stabile, etj. janë faktorë që ndikojnë në ndërtimin dhe në forcimin e një infrastrukture kriminale të fuqishme në këtë pjesë të Ballkanit.[168]

Pikërisht për këtë masmediat shpeshherë njoftojnë për një numër të madh aferash që ndodhin në institucionet shtetërore, siç është rasti i korrupsionit në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës lidhur me aferën e tenderit disa milionësh për pasaporta biometrike, ku nënkontraktorja N.V, me shtetësi gjermane, u ka dhënë 1.4 milionë pesë funksionarëve të lartë të ministrisë së lartpërmendur, pjesa më e madhe e së cilës, sipas pohimeve të saj, është transferuar nëpërmjet xhirollogarive bankare, ndërsa një rast është realizuar pikërisht në ndërtesën e ministrisë.[169] Nuk janë të rralla as raportet në masmediumet kosovare lidhur me aferat e disa politikanëve dhe funksionarëve shtetërorë, siç është rasti me privatizimin e disa objekteve dikur në pronësi shoqërore, tani të privatizuara në Kosovë.

[168] Sipas Bankës Botërore niveli i varfërisë së përgjithshme në Kosovë është 32%. Varfëria e skajshme ndërkaq arrin në 18%, ndërsa në vitin 2000 ka qenë 12%. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, Kosova radhitet në vendin e 158 nga numri i përgjithshëm prej 186 shteteve për nga lartësia e produktit bruto të vendit, përkatësisht PVV. Doganat tregojnë se në vitin 2010 Kosova ka eksportuar mallra në vlerë prej 300 milionë eurosh, ndërsa ka importuar mallra në vlerë prej 2.3 miliardë euro, që paraqet një deficit tregtar prej: 2 miliardë eurosh. Banka Botërore e radhit Kosovën në vendin e 174 për mbrojtjen e investuesve të huaj, ndërsa Banka Qendrore e Kosovës tregon se interesi bankar, me rastin e marrjes së kredive është 14%.

Lufta kundër korrupsionit ka nevojë për një politikë kundër krimit të tillë që do të bënte të mundur zbulimin, hetimin, procedimin dhe dënimin e formave të ndryshme të korrupsionit, duke përfshirë edhe dënimin e kryerësve të tyre. Lufta kundër korrupsionit ndikon në përcaktimin e politikës kundër krimit dhe në zbatimin e rregullave dhe të koncepteve të reja kundër korrupsionit. Duke e hulumtuar dhe duke e analizuar dukurinë e korrupsionit, sidomos zbulimin dhe luftimin e tij në përgjithësi dhe veçanërisht në vendet që ndodhen në tranzicion, mund të konstatohet lehtë se korrupsioni në vende të ndryshme të botës, sa është një dukuri e vjetër, po aq është edhe e re. Për këtë arsye, kur flitet për korrupsionin dhe për sigurinë e qytetarëve të vendeve që ndodhen në fazën e tranzicionit, rëndësi të posaçme ka mënyra e trajtimit dhe e organizimit të subjekteve shtetërore në mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut nga korrupsioni dhe nga dukuritë e tjera kriminale.[170]

Duhet theksuar se prania e korrupsionit në Kosovë ndikon që qytetarët ta humbin shpresën e tyre për një të ardhme më të mirë. Mosefikasiteti i duhur i institucioneve shtetërore në parandalimin dhe në luftimin e dukurive kriminale ndikon që te popullata gjithnjë më tepër të forcohet ndjenja e mosbesimit ndaj tyre.[171]

[170] Latifi, V. & Elezi, I.& Hysi, V., Politika e luftimit të kriminalitetit, Prishtinë, 2012, fq. 193-195
[171] Beka, A., vepër e cituar, fq.

# PËRFUNDIMI

Dukuria e korrupsionit në Kosovë mbetet një ndër sfidat kryesore të saj. Korrupsioni si dukuri e cila dita ditës po ngulfat shoqërinë kosovare, paraqet rrezik permanent për ekonominë dhe shoqërinë demokratike në përgjithësi.

Sa është e shprehur dukuria e korrupsionit në një shoqëri, pasqyron gjendjen shoqërore, politike dhe sigurinë nacionale të një shteti. Si e tillë ajo paraqet kërcënim edhe për sigurinë ndërkombëtare të një regjioni të caktuar të shteteve. Prandaj në të gjitha shtete bashkëkohore -demokratike ku mirëqenia e qytetarit është prioritet i politikës shtetërore, parandalimi dhe luftimi i dukurisë së korrupsionit është pjesë e strategjisë zhvillimore të çdo qeverie.

Korrupsioni është një nga format specifike të krimit të organizuar që rrezikon vlerat ekonomike, politike, juridike, kulturore dhe vlerat tjera të rëndësishme të shoqërisë. Krahas zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare ekonomike, korrupsioni merr forma të reja të paraqitjes, duke i përsosur dhe shfrytëzuar mjetet dhe metodat e ndryshme të cilat i përdorin kryesit e krimeve. Korrupsioni, i paraqitur, në format bashkëkohore, nuk e ka anashkaluar Kosovën e brishtë ekonomikisht e në procesin e shtet formimit të ri, e ka ngadalësuar dhe dobësuar zhvillimin e saj.

Pasojat e korrupsionit janë të rrezikshme, sa ekonomike aq edhe politike dhe shoqërore. Korrupsioni, në çfarëdo forme dhe në çfarëdo rrafshi që paraqitet cenon kështu rëndë vlerat themelore të shoqërisë dhe të demokracisë. Ndër shkaqet kryesore të korrupsionit renditet shpesh përqendrimi i etshëm i pushtetit, i pasurisë dhe i privilegjeve, ngathtësia burokratike, kontrollet e tepërta administrative, kufizimet tregtare, monopolet, favorizimi, lëshimet nga ana e autoriteteve, pagat e ulëta të funksionarëve dhe veprimtarëve publik, dobësitë e sistemit gjyqësor, dhe në përgjithësi koncepti materialist për arritjen e përfitimit të pandershëm dhe të suksesit me anë pushteti, paraje, pozite shoqërore etj.

Duke pas parasysh që veprat penale të korrupsionit kanë të bëjnë me shkelje të dispozitave ligjore, kodit të etikës profesionale nga kryesit e veprës, me qëllim të përfitimit të paligjshëm të pasurisë apo të krijimit të benefiteve të caktuara për veti apo për personat e tjerë, dukuria e korrupsionit paraqet shkelje të rendit kushtetues dhe të drejtat dhe lirive themelore të njeriut. Korrupsioni manifestohet në forma te ndryshme në një shoqëri, si: dhënie dhe marrje e ryshfetit, shantazhi, mitoja direkte e zyrtarëve publik, mitoja indirekte, etj. Prandaj, dukuria e korrupsionit shkakton pasoja të mëdha sociale, politike, ekonomike dhe të sigurisë. Korrupsioni dëmton rëndë kredibilitetin e një shteti si brenda ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Një sfidë në vete paraqet edhe identifikimi i shkaqeve të korrupsionit me qëllim të parandalimit dhe luftimit sa më efikas të saj. Në luftimin e kësaj dukurie rol të rëndësishëm luajnë institucionet gjyqësore, prokuroriale dhe mediat e lira, sidomos gazetaria hulumtuese. Të gjitha këta faktorë ndikojnë në parandalimin dhe luftimin sa më efikas të dukurisë së korrupsionit në shoqërinë kosovare.

Infrastruktura ligjore e Republikës së Kosovarë respektivisht dispozitat e Kodit Penal parashohin veprat penale të korrupsionit, mirëpo implementimi i tyre nuk është i kënaqshëm dhe i mjaftueshëm për parandalimin e kësaj dukurie kriminale nga ana e institucioneve te gjyqësisë dhe prokurorisë. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim duhet të luajnë edhe disa institucione me kompetenca administrative, siç është Agjencioni kundër Korrupsionit, i cili përkundër përpjekjeve të vazhdueshme, rezultatet e arritura janë për tu dëshiruar.

Të dhënat statistikore, të hulumtuara në fushat e caktuara të kësaj dukurie, në periudhën përkatëse, në mënyrë të bollshme, tregojnë për vëllimin e korrupsionit në Kosovë dhe orientimin e politikës ndëshkimore kundër kryerësve të veprave penale të korrupsionit. Të gjithë treguesit statistikor, lejojnë konkluzionin, që korrupsioni është në rritje dhe që politika ndëshkimore duhet ashpërsuar. Kur bëhet fjalë për dukurinë e korrupsionit, duke u nisur nga vështirësitë e zbulimit, luftimit dhe të gjykimit, ajo vështirë, saktësisht evidentohet, por treguesit orientues, mundësojnë, krahasuar edhe me të dhënave të këtyre krimeve të rajonit, planifikimin e masave të luftimit të tyre në Kosovë.

Shoqëria kosovare, institucionet shtetërore, shoqëria civile gjinden para një sfide të quajtur korrupsion. Kjo sfidë duhet të tejkalohet me qëllim që shteti i Kosovës ti plotësojë kriteret e kërkuara nga bashkësia ndërkombëtare për lëvizjen e lirë të popullatës kosovare në shtetet e Bashkësisë Evropiane, kusht i cili edhe më tej do të ashpërsohet në periudhën kur Kosova seriozisht do të pretendoj për tu integruar në Bashkësinë Evropiane.

## REKOMANDIMET

Duke analizuar shkaqet e një situate të tillë, për t'i identifikuar në mënyrë efektive dukuritë që janë objekt i këtij hulumtimi dhe për t'i parandaluar e ndëshkuar ligjërisht mbartësit e tyre, theksohet nevoja e përkufizimit të rekomandimeve të mëposhtme, si:

- Shoqëria kosovare ende është shumë larg njohjes së faktorëve relevantë që e determinojnë paraqitjen e këtij lloj kriminaliteti. Për këtë arsye, është e domosdoshme që të intensifikohet puna kërkimore-shkencore në këtë fushë, gjë që do të kontribuonte në ngritjen e vetëdijes kolektive, në rritjen e kapaciteteve të institucioneve që janë të ngarkuara për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie si dhe në zhvillimin e bashkëpunimit të subjekteve juridike me institucionet shtetërore të Kosovës;

- Nga kërkimet e kryera në institucionet gjyqësore të Kosovës, rezulton se kemi pak raste te dënimit të *personave zyrtar t*ë *rangut t*ë *lart*ë *p*ër *korrupsion*. Kjo në asnjë mënyrë nuk e paraqet pasqyrën reale të gjendjes faktike, ndërsa prania e *"numrit të errët"* ndodhet në nivel maksimal dhe alarmant. Së këndejmi, zbulimi dhe ndjekja e kryerësve të këtyre veprave duhet të jetë detyrë prioritare e policisë, e organeve administrative në lëmin e financave dhe të tatimeve si dhe e prokurorisë publike.

- Mjetet e informimit në Kosovë që marrin pjesë në luftën për parandalimin e kësaj dukurie kriminale, në përcaktimin programor të tyre duhet ta përfshijnë informimin objektiv të publikut për të gjitha pasojat negative të saj ndaj sistemit politik, juridik dhe ekonomik;

- Përkundër faktit se në kuadër të Policisë së Kosovës ekziston sektori për luftimin e korrupsionit, struktura udhëheqëse dhe personeli i saj ende kanë nevojë për ngritje profesionale dhe për marrjen e njohurive më të thella lidhur me korrupsionin dhe format tjera të kriminalitetit;

- Është i domosdoshëm një bashkëpunim më i ngushtë dhe më i rregullt ndërmjet Policisë së Kosovës, Prokurorisë, Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shërbimit të Inteligjencës Financiare, etj. me institucionet kompetente vendore dhe ndërkombëtare për dhënien e ndihmës dhe për shkëmbimin e përvojave në këtë fushë;

- Gjykatat kompetente të Kosovës duhet ta ashpërsojnë politikën ndëshkimore ndaj kryerësve të veprave penale te korrupsionit;

- Prokuroria duhet të jetë më efikase në fushën e luftimit të korrupsionit dhe në ngritjen e aktakuzave sidomos ndaj personave në pozita të larta shtetërore, që janë të përfshirë në afera të ndryshme korruptive;

- Institucionet kompetente shtetërore të Kosovës duhet *"t'i vizitojnë më shpesh"* subjektet të cilat drejtpërsëdrejti apo tërthorazi merren me procesin e tenderimeve – prokurimeve publike, si dhe të ndërmarrin masa për forcimin e disiplinës në proceset e prokurimit publik dhe të ligjshmërisë në punën e tyre;

- Të rritet akoma më shumë shkalla e efikasitetit dhe e përgjegjësisë së organeve të zbulimit dhe të hetimit, me rastin e identifikimit dhe të zbulimit të rrjeteve të ndryshme korruptive në organet shtetërore dhe tek subjektet tjera publike, në kompetencën e të cilave ndodhen punët e prokurimit publik.

- Hetimet dhe aktakuzat për korrupsion duhet të trajtohen nga gjyqtarët dhe prokurorët e specializuar nga fusha e njohjes së korrupsionit dhe shkaqeve që ndikojnë në shfaqjen e saj.

- Duhet rritur fondin financiar të institucioneve që merren me lëndët e luftimit dhe parandalimit te korrupsionit.

- Prokurorët, gjyqtarët dhe policët që merren me lëndët e korrupsionit duhet të gëzojnë një reputacion të lartë, në mënyrë që ta plotësojnë kushtin e përzgjedhjes në pozita të tilla.

- Duhet zbatuar mekanizmat kushtetues dhe ligjor që me rastin e përzgjedhjes dhe emërimeve të zyrtarëve të pengohen ndikimet politike dhe biznesore.

**BIBLIOGRAFIA**

**a) Libra:**


1. Abadinsky, H., Organized Crime, Belmont, 2009.
2. Arnaudovski, Lj., Kriminologija, Shkup, 2007.
3. Beka, A., Abuzimet në lëmin e qarkullimit të paluajtshmërive në Kosovë, Prishtinë, 2007.
4. Beka, A., Krimi i Organizuar në Urbanizëm dhe Qarkullim të Pasurive të Paluajtshme, Prishtinë, 2015.
5. Danilet, C., Korrupsioni dhe Antikorrupsioni në Sistemin e Drejtësisë, Tiranë, 2011.
6. Dervisholli, L., Krimi Financiar – pengesë për zhvillim ekonomiko-social në vende të Evropës Juglindore, Prishtinë, 2017.
7. Ejupi, E., Konflikti i Interesit – Doracak, Prishtinë, 2014.
8. Elezi, E., Efektiviteti i Legjislacionit dhe Sistemit të Drejtësisë Penale kundër Kriminalitetit në Procesin e Intergrimit Evropian, Tiranë, 2015.
9. Elezi, I., E Drejta Penale – Pjesa e Posaçme, Tiranë, 2018.
10. Gashi, R., Krimi i Organizuar, Prishtinë, 2014.
11. Grup autoresh, Korupcija u Srbiji, Beograd, 2001.
12. Gjinovci, A., Krimi Ekonomik dhe Etika në Organizatat Bashkohore, Prishtinë, 2016.
13. Hajdari, A., Veprat Penale me natyrë korrupsioni me një vështrim të posaçëm në Kosovë, Prishtinë, 2013.
14. Halili, R., Kriminologjia, Prishtinë, 2016.
15. Hetemi J. M. & Jashari S. N., Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit - me komentim, Prishtinë, 2013.
16. Horvatic, Z., Djelovanje medjunarodnih organizacija u suzbijanju kriminala, Zagreb, 2002.
17. Horvatić, Z., Politika suzbijanja kriminaliteta, Zagreb, 1999.
18. Hysi, V., Kriminologjia, Tiranë, 2010.

19. Jovasevic, D., Zloupotreba sluzbenog polozaja i korupcija, Beograd, 2005.
20. Kambovski, V. & Zeneli, I., E Drejta Penale – Pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018.
21. Krasniqi, A., Korrupsioni – Format e shprehjes dhe parandalimit, Prishtinë, 2013.
22. Lajman, M. & Poter, G., Organiziran Kriminal, Shkup, 2009.
23. Lascoumes, P., Korrupsion, Tiranë, 2002.
24. Latifi, V. & Beka, A., Taktika Kriminalistike, Prishtinë, 2017.
25. Latifi, V. & Beka, A., Vrasjet, Krimi i Organizuar, Terrorizmi – Zbulimi dhe të Provuarit, Prishtinë, 2013.
26. Latifi, V. & Elezi, I. & Hysi, V., Politika e Luftimit të Kriminalitetit, Prishtinë, 2012.
27. Latifi, V., Kriminalistika – Zbulimi dhe të Provuarit e krimit, Prishtinë, 2014.
28. Latifi, V., Politika Kriminale, Prishtinë, 2011.
29. Milutinovic, M., Politika kriminale, Prishtinë, 1987.
30. Ndrejaj, Gj., Mashtrimi, Korrupsioni dhe Auditimi, Tiranë, 2014.
31. Poda, Z., Krimi i organizuar transnacional – Sitem dhune dhe pushteti, Tirane
32. Rakipi, A., Korrupsioni dhe Evazioni Fiskal, Tiranë, 2003.
33. Rose - Ackerman, S., Korupcija i Vlada – Uzroci, posljedice i reforma, Zagreb, 2002.
34. Sacić, Z., Organizirani kriminal – Metode suzbijanja, Zagreb, 2001.
35. Sahiti, E. & Murati, R., E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2016.
36. Sahiti, E. & Zejneli, I., E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017.
37. Saković, A., Osnovi privrednog kriminaliteta, Sarajevë, 1998.
38. Salihu, I., E Drejta Penale – Pjesa e Posaçme, Prishtinë, 2014.
39. Salihu, I., Krimi Ekonomik – Sfidat e sigurisë kombëtare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, përballë krimit ekonomik, Shkup, 2012.
40. Suceska, M., Bazat e Kriminalitetit Ekonomik, Prishtinë, 2006, FSK/S 06/07.
41. Teofilovic, N., & Jelacic, M., Sprecavanje, otrkrivanje i dokazivanje krivicnim dela korupcije i pranja noca, Beograd, 2006.
42. Vodinelic, V., Kriminalistika, Beograd, 1996.
43. Vukovic, S., Korupcija i vladavina prava, Beograd, 2003.

44. Zejneli, I., E Drejta Penale, - Pjesa e posaçme, Tetove, 2007.
45. Kambovski, V. & Zejneli, I., E Drejta Penale – Pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018.
46. Horvatić, Ž., Elementarna kriminologija, Rijekë, 1981.

**b) Aktet ligjore:**

1. Kodi (Ligji) Penal dhe Kodi (Ligji) i Procedurës Penale të: Republikës së Shqipërisë; Maqedonisë; Serbisë; Kroacisë, me përditësimet e fundit të bëra me reformat ligjore, vitit 2017.
2. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Prishtine, 2013.
3. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2013.
4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
5. Ligji Nr. 03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
6. Ligji Nr. 03/L-151 "Për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik", Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 66, Prishtinë, 2010.
7. Ligji Nr. 03/L-196 "Për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizimit", Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 85, Prishtinë, 2010.
8. Ligji Nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
9. Ligji Nr. 04/L-043 për mbrojtjen e informatorëve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
10. Ligji Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
11. Ligji Nr. 2004/34 kundër korrupsionit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

### c) Burime tjera:


1. Deklarata e Vjenës për Krimin dhe Drejtësinë, Rezoluta 55/9 – 2000 –OKB-së.
2. Konventa e Ligjit Civil për Korrupsionin, Strasburg, 4 nëntor 1999.
3. Raporti mbi gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën Juglindore, Projekti rajonal CARPO, version shqip, Këshilli i Evropës, Strasburg, 2006.
4. Raportet e OJQ – IKD, Prishtinë.